
BULETIN INFORMATIV

PRILL 2026

AKADEMIA E SHKENCAVE
E SHQIPËRISË



**Buletin mujor i aktiviteteve të
Akademisë së Shkencave të
Shqipërisë**

Prill, 2026

Përmbajtje

Aktivitet	8
Panairi V mbarëkombëtar i librit akademik dhe shkencor çel edicionin e tij në Tiranë	9
Panairi i 5-të mbarëkombëtar i librit akademik dhe shkencor	13
Akademiku i asociuar Rrapo Ormëni shpallet fitues i çmimit “Vepra më e mirë studimore” në Panairin e 5-të mbarëkombëtar të librit akademik e shkencor	16
Panel diskutimi mbi të drejtën e autorit në Ditën Botërore të Librit dhe të së Drejtës së Autorit.....	20
U zhvillua mbledhja e redaksisë qendrore për “Enciklopedinë shqiptare”	21
Redaksia qendrore e “Enciklopedisë shqiptare” miratoi madhësinë e artikujve enciklopedikë dhe autorët për hartimin e tyre	22
Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë takoi përfaqësuesit e Këshillit Koordinues të Diasporës	23
Kongresi i Dytë i Manastirit në shërbim të arsimit dhe kulturës kombëtare	27
Dita Botërore e Shëndetit	29
Dita Botërore e Artit: Vlera e krijimtarisë në zhvillimin shoqëror	31
Dita Ndërkombëtare e Monumenteve të Kulturës dhe Siteve Arkeologjike.....	32
Urim në Ditën Ndërkombëtare të Librit dhe të së Drejtës së Autorit.....	34
Konsulta Gjuhësore e Prishtinës, një hap vendimtar drejt njësimimit të gjuhës shqipe ..	36
Promovime	37
U prezantua vepra “Studime albanologjike në indoeuropianistikë, filologji dhe gjuhësi kontakti” kushtuar prof. dr. Bardhyl Demiraj.....	38
Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike prezantoi tri vepra të autorëve Kozeta Sevrani, Kujtim Onuzi dhe Hajri Haska	40
Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës dhe seksionet e saj prezantojnë botimet dhe zhvillimet shkencore në Panair	42

Instituti i Historisë prezantoi botimet më të fundit në Panairin V mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor	45
U prezantua vepra studimore “Sistemi monetar shqiptar dhe institucioni i bankës qendrore në Shqipëri 1912–2025”, me autor prof. dr. Aristotel Pano.....	47
Promovohen dy botime të Universitetit të Tetovës në Panairin V mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor	49
Instituti Albanologjik i Prishtinës prezantoi botimet në Panairin V mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor	50
Instituti Pedagogjik i Kosovës në Panairin V mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor.....	51
U prezantua libri “Lëvizja revolucionare-kombëtare shqiptare dhe maqedonase në rrjetet e diplomacisë sovjetike” me autor Mehmet Prishtinën	52
Instituti i Antropologjisë prezanton botimet më të fundit në Panairin V mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor.....	53
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" prezantoi librat më të rinj të autorëve Tefë Topalli, Artan Haxhi e Roland Guli.....	54
Botimet e reja të Institutit të Arkeologjisë në Panairin V mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor.....	56
Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” prezanton dy botime shkencore	58
Shoqata Kulturore Shqiptare “ILIRIA” e Sllovenisë prezantoi veprën “Shqiptarët e lashtë dhe krijimi i Istrias” me autor dr. Peter Štoka	59
Kolegji AAB prezanton kërkimin shkencor dhe veprën “Eternale”	61
Instituti i Historisë “Ali Hadri” prezantoi veprat “Diaspora shqiptare dhe çështja e Kosovës 1912–2008” dhe “Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës”	63
Promovohet vepra “Arti i Naimit” në Panairin V mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor	65
AKKSHI prezanton mbështetjen për kërkimin shkencor në Panairin V mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor.....	66
Promovimi i botimeve të reja akademike nga Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë	68
Promovohet libri “Portreti i një shkencëtari” kushtuar prof. dr. Lekë Gjikhurit.....	70
Prezantime të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë në Panairin e V mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor	72

Universiteti i Tiranës përmyll prezantimet në Panairin e V mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor.....	74
Prezantime të Universitetit “Fan Noli” të Korçës në Panairin V mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor	76
Universiteti i Mjekësisë prezanton një studim mbi asfiksionë mekanike	77
Roli i bibliografive online në promovimin e botimeve dhe kërkimit shkencor	78
Qendra e Studimit të Arteve promovoi botimet e saj në Panairin e V mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor	80
Komisionet dhe institutet.....	82
Workshop ndërkombëtar në Tiranë mbi trajtimet biofizike në bujqësi dhe akuakulturë.....	83
Instituti Kombëtar i Fizikës zhvilloi për katër ditë rresht veprimtarinë “Shkolla e Pranverës Ballkanike: Aplikime të Shkencës së të Dhënave në Fizikë”	86
U mbajt tryezë shkencore për anglicizmat e pastabilizuar në gjuhën shqipe	88
Leksion shkencor mbi veprimtarinë dhe kontributin e akademikut Zeqirja Ballata ...	90
U mbajt konferenca shkencore për Komitetin “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”	92
U hap Shkolla e Pranverës Ballkanike: Aplikime të Shkencës së të Dhënave në Fizikë.....	93
Të tjera.....	95
Studentët e Kolegjit Profesional Gjerman të Teknologjisë vizituan Panairin e 5-të mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor.....	96
Panairi V mbarëkombëtar i librit akademik dhe shkencor: Pasqyrimi në mediat shqiptare	97
Nxënësit e shkollës së mesme “Sami Frashëri” vizitojnë NanoAlb.....	99
U mbajt ceremonia e dorëzimit të diplomës “Anëtar i jashtëm” për prof. dr. Burim Ametaj .	101
Akademia e Shkencave mbështet protestat e studentëve shqiptarë në Maqedoninë e Veriut që kërkojnë respektimin e të drejtës së tyre themelore: arsimimin në gjuhën amtare	105
Banda “Vatra” në kontekstin e marrëdhënieve shqiptaro-amerikane dhe ndërtimit të identitetit kombëtar shqiptar	106
Themelimi i orkestrës së parë në Shqipëri.....	108

Akademia e Shkencave dhe Kryesia e saj i urojnë akademikut Dhimitër Haxhimihali 85-vjetorin e lindjes: Gëzuar ditëlindjen!	110
Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Kryesia e saj i urojnë akademik Ali Aliut: Gëzuar ditën e lindjes!	112
Akademia e Shkencave e Shqipërisë i uron ditën e lindjes dirigjentit dhe muzikologut shqiptar Eno Koço	114
Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Kryesia e saj i urojnë akademikut emeritus Gjovalin Shkurtaj: Gëzuar ditën e lindjes!	116
Akademia e Shkencave dhe Kryesia e saj i urojnë akademikes Aurela Anastasi: Gëzuar ditën e lindjes!	118
Akademia e Shkencave dhe Kryesia e saj i urojnë akademikut Shaban Sinani: Gëzuar ditëlindjen!.....	120
In memoriam.....	122
Ngushëllim publik për ndarjen nga jeta të akademikut Rexhep Qosja.....	123
Ndahet nga jeta rapsodi lahutar Jonuz Delaj	125
Kujtojmë në ditën e lindjes Aleksandër Moisiun, aktorin shqiptar me famë botërore.....	127
Përkujtojmë në ditën e lindjes juristin dhe historianin akademik Arben Puto	129
Përkujtojmë në ditën e tij të lindjes Hoxhë Hasan Tahsinin, një ndër personalitetet më të shquara të Rilindjes Kombëtare	131
Kujtojmë në përvjetorin e ndarjes nga jeta matematikanin e shquar akademik Petraq Pilika.....	133
Përkujtojmë në përvjetorin e lindjes një nga figurat e Rilindjes Kombëtare, Aleksandër Stavre Drenova	135
Kujtojmë në përvjetorin e ndarjes nga jeta shkrimtarin e shquar akademik Bedri Dedja.....	137
Përkujtojmë sot në ditën e lindjes poetin arbëresh Jul Variboba.....	139
Përkujtojmë në ditën e lindjes shkencëtarin e shquar, akademik Artan Boriçi.....	141
Kujtojmë me nderim arkeologun dhe studiuesin e shquar Skënder Anamali	143
Akademia e Shkencave e Shqipërisë përkujton, në ditën e lindjes, albanologun dhe bibliografin Gjergj Pekmezi	145
Përkujtojmë sot në ditën e lindjes filozofin dhe akademikun Zija Xholi	147

Kujtojmë në datën e ndarjes nga jeta poetin dhe përkthyesin e njohur Robert Shvarc.....	148
Kujtojmë sot, në ditën e lindjes, akademikun, filologun dhe historianin e letërsisë, Jorgo Bulo (1939–2015)	150
Kujtojmë në datën e ndarjes nga jeta shkrimtarin dhe përkthyesin e shquar Skënder Luarasi.....	151

Aktivitet

Panairi V mbarëkombëtar i librit akademik dhe shkencor çel edicionin e tij në Tiranë



Panairi i 5-të mbarëkombëtar i librit akademik dhe shkencor u çel sot në Tiranë, duke shënuar nisjen e tri ditëve të dedikuara librit dhe dijes shkencore, në datat 22-24 prill.

Ky aktivitet i rëndësishëm organizohet si një nismë e përbashkët e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Librit dhe Leximit.

I kthyer tashmë në traditë, edhe në këtë edicion të pestë, panairi mbledh së bashku botime shkencore, autorë, ente botuese, universitete, institute dhe qendra kërkimore nga e gjithë hapësira shqiptare, duke krijuar një platformë të rëndësishme për promovimin e librit akademik dhe afrimin e tij me lexuesin.

Në ceremoninë e hapjes zëvendëskryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Vasil Tole në fjalën e tij theksoi se tashmë është bërë traditë që zhvillimi i këtij panairi të kulmojë me një ditë të rëndësishme për autorët dhe botuesit, Ditën Botërore të Librit dhe të së Drejtës së Autorit. Ai e cilësoi këtë manifestim si më të madhin e deritanishëm në këtë fushë të veçantë botimesh, duke nënvizuar se panairi nuk është vetëm një pasqyrë e

librit shkencor apo një festë e botimeve me treg të vështirë, por edhe një moment reflektimi mbi rolin e shkencës dhe të shkencëtarëve në zhvillimin e shoqërisë shqiptare. Sipas tij, ky organizim i jep vëmendjen e merituar figurës së kërkuesit shkencor dhe produktit të tij, duke përfshirë botimet, projektet dhe arritjet e tjera.



Akad. Toke theksoi gjithashtu rëndësinë e rritjes së aksesit të botimeve akademike dhe shkencore për publikun, duke veçuar rolin e bibliotekave dhe të publikimeve digjitale. Në këtë kuadër, ai njoftoi edhe një zhvillim të rëndësishëm: përrurimin e shtypshkronjës digjitale dhe entit botues “Akademia”, të mundësuar falë mbështetjes financiare të TIKAs. Duke shprehur mirënjohje për këtë bashkëpunim, ai vlerësoi kontributin e TIKAs dhe praninë e përfaqësuesve të saj si një dëshmi të partneritetit të suksesshëm.



Në fjalën e saj, kryetarja e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, akad. Justina Shiroka-Pula, e cilësoi panairin si një traditë tashmë të konsoliduar, që përfaqëson më shumë se një ekspozitë botimesh: një dëshmi të vitalitetit të mendimit shkencor shqiptar, një urë bashkëpunimi ndërinstitutional dhe një hapësirë ku dijet, idetë dhe kërkimi shkencor bashkohen përtej kufijve administrativë.

Ajo theksoi se, në një kohë sfidash globale, roli i shkencës dhe dijes bëhet edhe më thelbësor, ndërsa promovimi i librit akademik përbën një investim strategjik për të ardhmen.

Në ceremoninë e hapjes mbajtën fjalën e tyre edhe drejtoresha e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit, znj. Arta Marku, zëvendës-presidenti i TIKA-s, z. Yahya Coşkun, si dhe ambasadori i Republikës së Turqisë në Shqipëri, z. Barış Ceyhun Erciyes.

Znj. Arta Marku u shpreh se ky panair nuk është thjesht një mjedis i dijes, por një hapësirë që evidenton punën e studiuesve, e cila shpesh mbetet larg vëmendjes publike. Ajo e

krahasoi kontributin e tyre me themelet që mbajnë në këmbë struktura të mëdha, duke theksuar rëndësinë e padukshme, por thelbësore të kërkimit shkencor.

Nga ana e tij, zëvendës-presidenti i TIKA-s, z. Yahya Coşkun, theksoi se institucioni që ai përfaqëson, i themeluar në vitin 1992, ka realizuar rreth 800 projekte në Shqipëri, duke përfshirë edhe bashkëpunimin me Akademinë e Shkencave. Ai vlerësoi prodhimin e lartë shkencor dhe shprehu dëshirën që ky prodhim të vijojë të rritet.

Ambasadori i Republikës së Turqisë në Shqipëri, z. Barış Ceyhun Erciyas, u shpreh i kënaqur për pjesëmarrjen në këtë aktivitet dhe në përrurimin e shtypshkronjës “Akademia”. Ai vlerësoi kontributin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, që prej themelimit të saj në vitin 1972, në zhvillimin e kërkimit shkencor, rritjen e kapaciteteve intelektuale dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore, duke shprehur bindjen se ky kontribut do të vijojë të forcohet edhe më tej.

Në ditën e parë të panairit u bë edhe përrurimi i Shtypshkronjës “Akademia”, një hap i rëndësishëm në forcimin e infrastrukturës botuese akademike dhe shkencore në hapësirën mbarëkombëtare. Kjo shtypshkronjë synon të shërbejë si një mbështetje e rëndësishme për prodhimin dhe shpërndarjen e botimeve shkencore dhe akademike.

Gjatë tri ditëve të zhvillimit, panairi do të ofrojë ekspozimin e botimeve në stenda të dedikuara për institucionet pjesëmarrëse, si dhe një sërë aktivitetesh promovuese përmes prezantimit të botimeve të reja dhe diskutimeve shkencore.

Panairi i 5-të mbarëkombëtar i librit akademik dhe shkencor



-Fjala përshëndetëse e zëvendëskryetarit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Vasil Tole-

Akad. Tole: Ky Panair nuk është vetëm një pasqyrë e librit shkencor, as thjesht festë e një botimi të veçantë me treg të vështirë, po një moment reflektimi e promovimi i faktit se në Shqipëri, Kosovë dhe kudo ku jetojnë shqiptarët, shkenca dhe shkencëtarët janë pjesë integrale e zhvillimit.

Fjala e plotë:

E nderuar akad. Justina Shiroka Pula, Kryetare e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës,

I nderuar zv/president i TIKA-s z. Jahja Xhoshkun,

I nderuar Ambasador i Turqisë në Shqipëri, Barësh Xhejhun Erxhijes,

E nderuar Znj. Arta Marku, Drejtore e QKLL,

Të nderuar pjesëmarrës, drejtues, rektorë, përfaqësues të universiteteve dhe institucioneve të tjera të arsimit të lartë e të kërkimit shkencor në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni të Veriut e Mal të Zi;

Të nderuar autorë e botues të librit shkencor; akademikë dhe profesorë, studiues, studentë e lexues, dashamirës të librit e shkencës;

Është bërë traditë tashmë që zhvillimi i Panairit mbarëkombëtar të librit akademik e shkencor, që këtë vit shënon edicionin e tij të pestë, kulmon me një ditë të rëndësishme për autorët e botuesit, Ditën Botërore të Librit dhe të së Drejtës së Autorit.

Ky manifestim, më i madhi i deritashëm për këtë fushë të gjerë dhe unike botimesh, organizohet me shumë përkushtim nga dy akademitë tona, në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Librit dhe Leximit.

Ky Panair nuk është vetëm një pasqyrë e librit shkencor, as thjesht festë e një botimi të veçantë me treg të vështirë, po një moment reflektimi e promovimi i faktit se në Shqipëri, Kosovë dhe kudo ku jetojnë shqiptarët, shkenca dhe shkencëtarët janë pjesë integrale e zhvillimit.



Si rrallë organizim tjetër, ky panair i jep vëmendjen e merituar figurës së kërkuesit dhe produktit shkencor, botimeve, projekteve e të tjerë.

Librat dhe botimet që prezantohen këtu, jo vetëm nëpër stenda, por edhe me seanca maratonë promovimesh në sallat e akademisë, nuk janë thjesht rezultate pune; ato janë kontribute konkrete në ndërtimin e një shoqërie të hapur për të përballuar sfidat në rrugën integruese në Bashkimin Europian.

Botimet akademike e shkencore duhet ta gjejnë më lehtë rrugën drejt lexuesit, para së gjithash atje ku kërkimi është institucional, në bibliotekat shkencore, universitare,

publike, brenda e përtej kufijve, edhe në diasporë. Prandaj akademitë tona ofrojnë edhe publikime digjitale dhe e-book, duke mundësuar akses të hapur për lexuesin.

Sot, ky panair, na gjen me një zhvillim shumë të rëndësishëm. Falë mbështetjes financiare të TIKA-s u bë e mundur që Akademia e Shkencave e Shqipërisë të ketë sot shtypshkronjën e saj digjitale dhe entin e saj botues me emrin AKADEMIA të cilën e përurojmë po sot, në ditën e parë të Panairit. Nuk është hera e parë që TIKA bashkëpunon me Akademinë në të mirë të kërkuesve dhe produktit shkencor në Shqipëri.

Për këtë i jemi shumë mirënjohës TIKA-s, zyrës në Tiranë dhe qendrës në Ankara. Vetë fakti që zëvendës-presidenti i TIKA-s na nderon me pjesëmarrjen e tij është shenja më e qartë e këtij bashkëpunimi dhe mirëkuptimi maksimal.

Ky aktivitet le të shërbejë si një mundësi e mirë për të krijuar ura lidhjeje midis kërkuesve, botuesve e lexuesve, në përputhje me strategjinë tonë të hapjes ndaj sistemit të kërkimit shkencor, madje edhe si një hapësirë dialogu e ndërveprimi: mes brezave të studiuesve, mes disiplinave e institucioneve, mes kërkuesve në vend dhe diasporës shkencore. Pasi, pikërisht në këtë dialog lind përparimi i vërtetë shkencor.

Me besimin që këto tri ditë panairi do të shndërrohen në festë të librit shkencor dhe akademik, ju uroj mbarësi të gjithë pjesëmarrësve, sukses të plotë botuesve e autorëve, posaçërisht atyre që do të përurojnë veprat e tyre, dhe sa më shumë lexues ta gjejnë veten në stendat e pasura të tij.

Mirë u takofshim vitin tjetër në Prishtinë!

Faleminderit.

Akademiku i asociuar Rrapo Ormëni shpallet fitues i çmimit “Vepra më e mirë studimore” në Panairin e 5-të mbarëkombëtar të librit akademik e shkencor



-Akad. asoc. Ormëni u vlerësua për librin “Vepra të zgjedhura në fushën e sizmologjisë” për kontributin dhe punën shkencore të akad. Eduard Sulstarova (1934–2014)-

Panairi i 5-të mbarëkombëtar i librit akademik e shkencor ditën e tretë të promovimeve e nisi me një minutë heshtje në nderim të personalitetit të madh të letërsisë dhe albanologjisë, akademik Rexhep Qosja, që u nda nga jeta më 23 prill 2026.

Zëvendëskryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Vasil Tole në emër të Kryesisë shprehu vlerësimin për akademikun Rexhep Qosja, anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe anëtar nderi i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Ai tha se akademik Rexhep Qosja është një personalitet unik i kulturës sonë dhe duke qenë se kjo ngjarje e rëndë na gjeti në aktivitet kujtimin e tij në ditën e tretë të panairit do ta nisim me një minutë heshtje.

Panairi i 5-të mbarëkombëtar i librit akademik e shkencor, i organizuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, në

bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Librit dhe Leximit, për tri ditë rresht u shndërrua në një festë të dijes, ku u prezantuan botime të reja dhe u vlerësuan arritjet më të spikatura në fushën e shkencës dhe kulturës.

Zv. Kryetari i Akademisë, akad Toke në hapjen e aktiviteteve të ditës së tretë shprehu vlerësimin për Qendrën Kombëtare të Librit dhe Leximit si partneri kryesor në organizimin e këtij panairi. Ai tha se në kuadër të misionit të saj për promovimin e librit në Republikën e Shqipërisë dhe të figurës së autorit të librit që është figura e shkencëtarit qendra në bashkëpunim me dy akademitë ka ideuar dhënien e këtij çmimi që do të vazhdojë për gjithë kohën që ky panair do të vazhdojë.



Çmimi prestigjioz “Vepra më e mirë studimore” e akorduar nga QKLL iu akordua akademikut të asociuar Rrapo Ormeni, për përgatitjen e kolanës madhore me katër volume “Akademik Eduard Sulstarova – Vepra të zgjedhura në fushën e sizmologjisë”. Drejtorja e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit znj. Arta Marku vlerësoi mbajtjen e panairit në kuadër të Ditës Kombëtare të Librit dhe bashkëpunimin e QKLL-së me Akademinë e Shkencave. Ajo u shpreh se bashkëpunim me një institucion si Akademia i jep dinjitet institucional qendrës së librit.

Duke lexuar motivacionin e jurisë, znj. Marku theksoi se kjo vepër është një monument shkencor, që jo vetëm ruan trashëgiminë e një figure të shquar, por edhe hap horizonte të reja për kërkime në fushën e sizmologjisë dhe gjeoshkencave. Përmes këtij botimi përmbliohen e dokumentohen kontributet më përfaqësuese të tij në fushën e sizmologjisë, duke i paraqitur ato si dëshmi e zhvillimit shkencor në vend dhe si burim frymëzimi për brezat e rinj të kërkuesve shkencorë.



Botimi përfaqëson një arkiv shkencor dhe kulturor të pazëvendësueshëm, ku dokumentohet evolucioni shkencor dhe institucional i sizmologjisë shqiptare nga fundi i viteve '60 deri në vitin 2011. Në këtë vepër evidentohet rolin themeltar i Akademikut Eduard Sulstarova (1934–2014) si pionier i monitorimit sistematik sizmik në Shqipëri. Kontributet e tij vizionare u zhvilluan në bashkëpunim me profesorët Shyqyri Aliaj, Siasi Koçiaj, Betim Muço dhe shumë kolegë të tjerë, duke themeluar shkollën shqiptare të sizmologjisë.

Znj. Marku ftoi Kryetarin e Akademisë së Shkencave akad. Skënder Gjinushin për t'i dhënë çmimin akad. Rrapo Ormënit.

Akad. Ormëni u shpreh se është nder dhe privilegj për mua që kontribuova në përgatitjen e këtij volumi të akademik Sulstarovës dhe ky çmim që jepet sot nga akademia e Shkencave të Shqipërisë është një vlerësim jo vetëm institucional, por për mua është edhe personal pasi tregon se puna e bërë kontributi i përkushtimit ndaj shkencës dhe mësuesit asnjëherë nuk humbet. Akademik Sulstarova ka dhe një kontribut të jashtëzakonshëm për sizmologjinë shqiptare.

Ai ka kontribuar si në rang lokal, por edhe rajonal evropian edhe më gjerë, për arsye se ai ka qenë Kryetar Komisioni i Zvogëlimit të Riskut Sizmik për Ballkanin Perëndimor, anëtar i asamblesë të sizmologjisë, dhe këto tituj ai i përdori për të zhvilluar shkencën e sizmologjisë shqiptare që e ngriti atë në një nivel evropian. Në fund ai shprehu falënderime për Kryesinë për këtë nderim ceremonial që i bëhet veprës së tij

Panel diskutimi mbi të drejtën e autorit në Ditën Botërore të Librit dhe të së Drejtës së Autorit



Në kuadër të Ditës Botërore të Librit dhe të së Drejtës së Autorit, në Panarin e V mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor u zhvillua një panel diskutimi me përfaqësuesit e Albautorit z.Oltion Spiro dhe z.Blendi Çirko.

Zëvendëskryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Vasil Tole, e cilësoi këtë ditë si një moment të veçantë që lidh Akademinë me autorët dhe kërkuesit shkencorë, si prodhuesit kryesorë të studimeve shkencore.

Përfaqësuesit e Albautorit theksuan se e drejta e autorit është një e drejtë individuale që lind me krijimin e veprës dhe mbetet thelbësore për mbrojtjen e krijimtarisë, duke nënvizuar edhe rolin e tyre në administrimin dhe mbështetjen e autorëve.

Ky aktivitet solli në vëmendje domosdoshmërinë e forcimit të kulturës së respektimit të së drejtës së autorit dhe rritjes së ndërgjegjësimit në mjedisin akademik dhe botues.

U zhvillua mbledhja e redaksisë qendrore për “Enciklopedinë shqiptare”



Sot, më 7 prill 2026, në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë është zhvilluar dita e parë e mbledhjes me anëtarët e redaksisë qendrore për projektin madhor “Enciklopedia shqiptare”.

Takimi u drejtua nga kryeredaktori i veprës akad. Skënder Gjinushi, kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe zëvendëskryeredaktori akad. Mehmet Kraja, Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës.

Në këtë mbledhje do të trajtohen një sërë çështjesh të rëndësishme që lidhen me ecurinë e mëtejshme të projektit si udhëzuesi mbi statusin e artikullit përmbledhës e madhësitë e artikujve për personalitetet, për teknikalitetet redaksionale për përgatitjen e artikujve.

Çështja kryesore e këtij takimi është miratimi i madhësive të artikujve, monografike e të mëdhenj duke synuar respektimin e kriterëve për personalitetet dhe figurat historike të ndryshme.

Në punimet e sotme u miratuan artikujt monografikë dhe artikujt e mëdhenj me natyrë monografike, si dhe u përcaktuan madhësitë përfundimtare të artikujve të mëdhenj dhe të mesëm për personalitetet dhe figurat historike.

Redaksia qendrore e “Enciklopedisë shqiptare” miratoi madhësinë e artikujve enciklopedikë dhe autorët për hartimin e tyre



Pas miratimit përfundimtar të përbërjes së fjalësit për “Enciklopedinë shqiptare”, në datat 7-8 prill në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë u zhvillua mbledhja dyditore e redaksisë qendrore për përcaktimin dhe miratimin e artikujve monografikë, të atyre të mesëm dhe të mëdhenj për personalitetet, si dhe për autorët e shkrimit të tyre.

Punimet u drejtuan nga kryeredaktori i veprës, akad. Skënder Gjinushi, kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, dhe zëvendëskryeredaktori akad. Mehmet Kraja, anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës.

Me miratimin e madhësisë së artikujve dhe autorëve u hap rruga për fillimin e shkrimit të tyre, numri i të cilëve ka arritur mbi 12 500.

Për lehtësimin dhe disiplinimin e kësaj faze përfundimtare dhe të rëndësishme, redaksia qendrore miratoi ngritjen e platformës online për hartimin dhe publikimin e enciklopedisë pranë Qendrës së Botimeve Enciklopedike dhe Albanologjike, sipas përvojës së “Fjalorit të madh të gjuhës shqipe”, si dhe disa udhëzues në ndihmë të redaksive të fushave dhe autorëve.

Një vend të veçantë në këto udhëzime zënë roli dhe detyrat e përgjegjësve të redaksive në koordinimin e punës. Mbështetur në volumin e punës, organizimin e saj dhe përparësitë që jep platforma e redaksisë qendrore, synohet që projekti madhor “Enciklopedia shqiptare”, më i madhi deri më tani, të përfundojë brenda afateve dhe me cilësi të lartë.

Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë takoi përfaqësuesit e Këshillit Koordinues të Diasporës



Më 16 prill 2026, në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë u prit në takim nga kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Skënder Gjinushi kryetari i Këshillit Koordinues të Diasporës z. Lazim Destani, së bashku me anëtarët e tjerë të këshillit. Ky takim kishte për qëllim njohjen dhe krijimin e urave të bashkëpunimit me komunitetin shkencor dhe intelektual shqiptar jashtë vendit përmes Këshillit Koordinues të Diasporës dhe rolit që mund të luajë Akademia e Shkencave në këtë drejtim.

Kryetari i Akademisë së Shkencave akad. Gjinushi e vlerësoi si shumë të rëndësishme vizitën e përfaqësuesve të Këshillit Koordinues të Diasporës dhe theksoi se zgjerimi i bashkëpunimit me diasporën shkencore mbetet një nga prioritetet strategjike të institucionit. Më tej, ai u shpreh se qëllimi i Akademisë është hapja e saj, jo vetëm brenda vendit, por edhe jashtë tij, duke pasur parasysh potencialin në rritje dhe kushtet e reja që mundësojnë bashkëpunimin në distancë.

Ai nënvizoi se reformimi i Akademisë së Shkencave ndër vite, ka mundësuar ngritjen e strukturave të reja pranë ASHSH-së si komisionet e përhershme, njësitë kërkimore e

institutet virtuale pranë të cilave janë të atashuar si bashkëpunorë, anëtarë e deri drejtues mbi 110 specialistë e kërkues nga diaspora.



Këto përbëjnë një mundësi të rëndësishme për shfrytëzimin e potencialit që ndodhet jashtë vendit. Akad. Gjinushi theksoi se, në fakt, ka më shumë kërkues shqiptarë jashtë vendit sesa brenda tij dhe kërkoi mbështetje e bashkëveprim për të krijuar kushte reale bashkëpunimi siç janë nevoja për ngritjen e qendrave të reja kërkimore në përputhje me kërkesat e kohës, siç është transformimi i NanoAlb në një qendër rajonale. Ai sqaroi se kjo qendër model drejtohet nga një përfaqësues i diasporës dhe ka shumë bashkëpunorë nga diaspora përveç atyre në Kosovë dhe në Maqedoninë e Veriut. Për të njëjtin qëllim duhen mbështetur nismat për fuqizimin e qendrës së biogjenetikës, e të njëjstëve të përkohshme të ngritura në fushat e energjisë, ujërave dhe inteligjencës artificiale.

Në takim u theksua edhe angazhimi e bashkëpunimi në realizimin e tri projekteve madhore: “Enciklopedia shqiptare”, “Fjalori i madh i gjuhës shqipe” dhe “Historia e shqiptarëve”, inisiativa te ndërmarra me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Akad. Gjinushi u shpreh se nga publikimi e deri më tani, fjalori numëron mbi 10 milion klikime, ndërsa për sa i përket enciklopedisë, puna ndodhet në fazën e hartimit të fjalësit, ku një ndër më të diskutuarit ka qenë ai i diasporës.



Nga ana e tij, z. Lazim Destani vlerësoi rëndësinë e thellimit të bashkëpunimit institucional dhe nënvizoi nisma në fushën e ruajtjes së trashëgimisë kombëtare, përfshirë përpjekjet për identifikimin dhe mbrojtjen e objekteve me vlera historike, si ndërtesa ku u mbajt Kongresi i Manastirit, e njohur ndryshe si “Shtëpia e Alfabetit”.

Në takim u diskutuan mundësitë për ndërtimin e një bashkëpunimi të qëndrueshëm ndërmjet Akademisë dhe studiuesve shqiptarë që kontribuojnë në universitete dhe qendra kërkimore ndërkombëtare. U theksua rëndësia e përfshirjes së diasporës në projekte kërkimore afatshkurtra dhe afatgjata, si dhe nxitja e botimeve të përbashkëta në revista shkencore ndërkombëtare.

Në përfundim, palët shprehën gatishmërinë për vijimin e bashkëpunimit përmes nismave konkrete dhe projekteve të përbashkëta, duke e konsideruar diasporën si një aset të rëndësishëm për zhvillimin e shkencës dhe reformimin e sistemit kërkimor në Shqipëri.

Kongresi i Dytë i Manastirit në shërbim të arsimit dhe kulturës kombëtare



Kuvendi më i madh i mbrojtjes së gjuhës dhe kulturës kombëtare u thirr me nismën e klubit “Bashkimi” të Manastirit dhe u mbajt në datat 2-3 prill 1910. Në kongres morën pjesë 20 delegatë, që përfaqësonin 34 klube e shoqëri të vilajeteve të Shkodrës, të Kosovës, të Manastirit e të Janinës, si edhe klubet shqiptare të Stambollit, të Selanikut e të qendrave të tjera.

Në këtë kuvend pati një numër mjaft të madh delegatësh nga qytetet e vilajeteve të Kosovës dhe të Manastirit, nga Peja, Gjakova, Gjlani, Mitrovica, Vuçiterna, Shkupi, Tetova, Dibra, Struga, Ohri etj. Midis delegatëve ishin Dervish Hima, Fehim Zavalani, Petro Nini Luarasi, Hysni Curri, Ferit Ypi, Bedri Pejani, Qamil Shkupi, Gjergj Qiriaz, Bejtullah Gjilani, Themistokli Germenji, Tefik Panariti, Hajdar Blloshmi, Abdullah Efendiu (nga Struga), Qazim Iliaz Dibra, Rexhep Mitrovica, Xhafer Kolonja etj. Kryetar i Kongresit u zgjodh Bedri Pejani, ndërsa sekretarë: Ferit Ypi dhe Petro Nini Luarasi.

Qëllimi i këtij Kongresi ishte të diskutonte çështjet që kishin të bënin me mbrojtjen e shkollës, të shkrimit me alfabetin latin, të kulturës kombëtare kundër reaksionit xhonturk dhe kundër politikës asimiluese të xhonturqve. Kongresi do të merrte masa të

mëtejshme për zgjerimin e rrjetit të shkollave shqipe dhe për zhvillimin e kulturës shqiptare në tërësi.

Në Kongresin e Dytë të Manastirit, ashtu si në ato të mëparshmet, u mbajtën edhe mbledhje të fshehta, në të cilat u diskutuan çështje të tilla politike, siç ishin forcimi i komiteteve të fshehta dhe masat që duheshin marrë për përgatitjen e një kryengritjeje të përgjithshme. Por, ndërsa për komitetet e fshehta u mor vendim që të zgjeroheshin e forcoheshin më tej, për përgatitjen e kryengritjes së përgjithshme nuk u mor ndonjë masë. Kjo çështje u la të diskutohej e të vendosej në kongresin e ardhshëm. Sipas të dhënave të bashkëkohësve, në mbledhjet e fshehta u hartua edhe një program politik, të cilin ata e quanin platformë “të autonomisë së Shqipërisë”, ku, përveç të tjerave, parashikohej njohja zyrtare e kombit shqiptar, mësimi i gjuhës shqipe në të gjitha shkollat e Shqipërisë dhe njohja e saj si gjuhë zyrtare. Megjithatë, ky program nuk u përfshi në asnjërin nga dy aktet e shpallura botërisht të Kongresit.

Kongresi i Dytë i Manastirit, ashtu si mitingjet, protestat dhe manifestimet e tjera që u zhvilluan në Shqipëri në pragun e këtij kuvendi, në shkurt-mars të vitit 1910, shprehën vendosmërinë e shqiptarëve për mbrojtjen e shkrimit shqip, të shkollës dhe të kulturës kombëtare në tërësi. Ato ishin, njëherazi, një paralajmërim për kryengritjen e armatosur që do të shpërthente në pranverën e vitit 1910.

Dita Botërore e Shëndetit



Dita Botërore e Shëndetit është një ngjarje ndërkombëtare nën kujdesin e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) dhe organizatave të lidhura me të. Kjo ditë shënon themelimin e OBSH-së dhe ofron një mundësi për të rritur ndërgjegjësimin global mbi çështjet e shëndetit publik.

Historia e Ditës Botërore të Shëndetit daton që nga viti 1948, kur OBSH-ja mbajti Asambleenë e Parë Botërore të Shëndetit, në përfundim të saj, u vendos që 7 prilli të festohej çdo vit si Dita Botërore e Shëndetit, me fillim nga viti 1950.

Çdo vit, OBSH-ja zgjedh një temë specifike për Ditën Botërore të Shëndetit dhe organizon ngjarje ndërkombëtare, rajonale dhe lokale për të theksuar rëndësinë e saj. Qeveritë, organizatat joqeveritare dhe aktorët e tjerë të shëndetit publik bashkohen në këtë përpjekje, duke zhvilluar aktivitete dhe nisma për të promovuar shëndetin dhe mirëqenien e komuniteteve. Dita Botërore e Shëndetit është një përkujtues i rëndësishëm i përkushtimit global për një shëndet më të mirë për të gjithë.

Në këtë kuadër, edhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë me njësitë dhe qendrat e ngritura pranë saj ka dhënë dhe vijon të japë kontribut të rëndësishëm në fushën e shëndetit publik, përmes kërkimit shkencor, studimeve ndërdisiplinore dhe promovimit të dijes. Nëpërmjet veprimtarive shkencore ASHSH ka nxitur trajtimin shkencor të çështjeve që lidhen me shëndetin e popullsisë, duke ofruar ekspertizë dhe rekomandime

për institucionet vendimmarrëse.

Gjithashtu, Akademia ka mbështetur botime dhe aktivitete shkencore që synojnë rritjen e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e parandalimit, edukimit shëndetësor dhe përmirësimit të cilësisë së jetës. Në bashkëpunim me institucione vendase dhe ndërkombëtare, përfshirë Organizatën Botërore të Shëndetësisë, ajo kontribuon në shkëmbimin e përvojave dhe në avancimin e standardeve të kërkimit në shërbim të shëndetit.

Dita Botërore e Artit: Vlera e krijimtarisë në zhvillimin shoqëror



Më 15 prill shënohet Dita Botërore e Artit, një ditë që synon të promovojë zhvillimin, përhapjen dhe vlerësimin e artit në të gjitha format e tij. Kjo ditë u shpall nga UNESCO në vitin 2019. Dita Botërore e Artit u shpall në nder të lindjes së Leonardo da Vinçit, si një ftesë për të reflektuar mbi rolin e krijimtarisë në jetën tonë dhe në zhvillimin e shoqërisë. Arti nuk është vetëm shprehje estetike, është kujtesë, identitet, dialog dhe shpeshherë rezistencë. Në çdo vepër, në çdo ngjyrë e formë, qëndron një histori njerëzore që meriton të dëgjohet. Kjo ditë le të jetë një nxitje për të mbështetur artistët, për të vizituar galeri, për të lexuar, për të dëgjuar dhe mbi të gjitha, për të ndjerë.

Arti përbën një shtyllë themelore të zhvillimit kulturor dhe shoqëror, duke ushqyer kreativitetin, inovacionin dhe diversitetin kulturor.

Ai luan një rol të rëndësishëm në forcimin e mirëkuptimit ndërmjet komuniteteve, në nxitjen e mendimit kritik dhe në pasurimin e jetës shpirtërore të individit dhe të shoqërisë. Kjo ditë shërben gjithashtu për të theksuar rëndësinë e edukimit artistik si një komponent thelbësor i një arsimit gjithëpërfshirës dhe cilësor, si dhe për të vlerësuar kontributin e artistëve në zhvillimin e qëndrueshëm.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë inkurajon promovimin e vlerave të krijimtarisë artistike si pjesë e pandashme e trashëgimisë sonë kombëtare dhe universale, duke i shërbyer dialogut kulturor dhe bashkëpunimit ndërdisiplinor, me synim emancipimin dhe zhvillimin e shoqërisë.

Dita Ndërkombëtare e Monumenteve të Kulturës dhe Siteve Arkeologjike



Në vitin 1982, Këshilli Ndërkombëtar i Monumenteve dhe Siteve (ICOMOS) shpalli datën 18 prill si Ditën Ndërkombëtare të Monumenteve dhe Siteve. Që prej asaj kohe, kjo datë përkujtohet çdo vit si një moment i rëndësishëm për promovimin dhe vlerësimin e trashëgimisë kulturore, si dhe për rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi diversitetin, rëndësinë dhe domosdoshmërinë e mbrojtjes dhe konservimit të saj.

Dita e 18 prillit përfaqëson një mundësi të rëndësishme për të theksuar vlerat e trashëgimisë kulturore dhe për të inkurajuar angazhimin institucional dhe qytetar në ruajtjen e saj. Kjo nismë, e ndërmarrë fillimisht nga ICOMOS-i, një organizatë joqeveritare me veprimtari ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së monumenteve dhe siteve, u miratua më pas edhe nga UNESCO, duke marrë një dimension të gjerë global.

Në këtë kuadër, kjo ditë shërben si një platformë për promovimin e trashëgimisë kulturore dhe për ndërgjegjësimin e publikut mbi rëndësinë e saj. Çdo vit, ICOMOS propozon një temë të veçantë, e cila udhëheq organizimin e aktiviteteve dhe nismave përkatëse në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.


Në territorin e Republikës së Shqipërisë numërohen mbi 1700 monumente të mbrojtura nga shteti, ndër të cilat përfshihen kala, kështjella, site arkeologjike, qytete antike, qendra historike, banesa tradicionale, objekte kulti, ura dhe ndërtime të tjera hidraulike. Këto

përbëjnë një pjesë të rëndësishme të trashëgimisë sonë kulturore dhe identitetit kombëtar, duke kërkuar vëmendje dhe përkushtim të vazhdueshëm për ruajtjen dhe promovimin e tyre.

Në këtë drejtim, Akademia e Shkencave e Shqipërisë ka luajtur një rol të rëndësishëm në studimin, dokumentimin dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe arkeologjike të vendit.

Përmes projekteve shkencore, botimeve akademike, hartimit të katalogëve të monumenteve dhe bashkëpunimeve ndërinstytucionale e ndërkombëtare, Akademia ka kontribuar në evidentimin dhe mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë materiale dhe shpirtërore shqiptare. Këto përpjekje synojnë jo vetëm ruajtjen e pasurisë kulturore, por edhe integrimin e saj në hapësirën shkencore europiane dhe më gjerë.

Urim në Ditën Ndërkombëtare të Librit dhe të së Drejtës së Autorit



Kryesia e Akademisë së Shkencave uron sot, në Ditën Ndërkombëtare të Librit dhe të së Drejtës së Autorit, të gjithë njerëzit e punës mendore, studiuesit, shkrimtarët, përkthyesit dhe botuesit, si dhe të gjithë ata që kanë privilegjin fisnik të krijimit dhe të krijimtarisë.

E caktuar në nderim të ditës së ndarjes nga jeta të dy gjenive të letërsisë botërore, Shekspirit dhe Servantesit, 23 Prilli festohet në mbarë botën si dita e librit, e dijes dhe e mendimit krijues, si një homazh për fuqinë e fjalës së shkruar dhe për rolin e saj të pazëvendësueshëm në përparimin e shoqërisë njerëzore.

Libri mbetet një nga shtyllat themelore të qytetërimit, një urë lidhëse mes brezave dhe kulturave, si dhe një dëshmi e gjallë e zhvillimit intelektual e shpirtëror të njerëzimit. Në këtë ditë të shënuar, vlerësohet veçanërisht kontributi i autorëve dhe studiuesve, të cilët, përmes punës së tyre këmbëngulëse, pasurojnë dijen, ruajnë identitetin kulturor dhe nxisin mendimin kritik.

Në përputhje me kuptimin simbolik që mbart kjo ditë, në Tiranë ka hapur siparin Panairi i V mbarëkombëtar i librit akademik dhe shkencor, një ngjarje e rëndësishme që promovon botimin shkencor dhe bashkëpunimin ndërinstytucional në hapësirën shqiptare.

Kjo veprimtari, e organizuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, ka arritur në edicionin e pestë, duke dëshmuar vazhdimësinë dhe rëndësinë e saj në jetën akademike dhe kulturore.

Panairi ka mbledhur së bashku, në ambientet e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, botues të librit shkencor, kërkues, studiues, autorë dhe lexues, duke krijuar një hapësirë të vyer për shkëmbim idesh, prezantim botimesh dhe nxitje të dialogut shkencor.

Në këtë ditë të veçantë, Akademia e Shkencave rikonfirmon përkushtimin e saj për mbështetjen e librit, të kërkimit shkencor dhe të së drejtës së autorit, si vlera themelore për zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë dhe përparimin e saj kulturor.

Konsulta Gjuhësore e Prishtinës, një hap vendimtar drejt njësimit të gjuhës shqipe



Në datat 27 - 28 prill 1968, në Prishtinë u mbajt Konsulta Gjuhësore e Prishtinës, një tubim shkencor mbarëkombëtar që hodhi themelet për njësimin e gjuhës letrare shqipe. Në takim u mbledhën studiues, gjuhëtarë dhe intelektualë nga të gjitha trevat shqiptare me një qëllim të përbashkët: krijimin e një gjuhe të përbashkët standarde, si bazë e arsimit, kulturës dhe identitetit kombëtar.

Kjo konsultë shënoi një hap të rëndësishëm drejt standardizimit të shqipes, proces që do të kurorëzohej më vonë me Kongresin e Drejtshkrimit të vitit 1972. Në vitet '60, shqipja përdorej në forma të ndryshme letrare, kryesisht në dy variante kryesore dialektore: gegërishtja dhe toskërishtja. Kjo situatë krijonte vështirësi në komunikimin kulturor, arsimor dhe institucional ndër shqiptarët. Konsulta e Prishtinës erdhi si një përpjekje e përbashkët për të kapërcyer këto dallime dhe për të vendosur baza të përbashkëta për një gjuhë standarde.

Gjatë kësaj konsulte u theksua nevoja për një gjuhë letrare të njësuar për të gjithë shqiptarët, detyrimi për përdorimin më të gjerë të normave të përbashkëta në arsim dhe botime, si dhe afrimi i praktikave gjuhësore në të gjitha trevat shqiptare.

Konsulta e Prishtinës kishte një rëndësi të veçantë, pasi për herë të parë në kushtet e kohës, u arrit një bashkëpunim i gjerë mbarëkombëtar në fushën e gjuhësisë. Ajo shërbeu si një urë lidhëse mes studiuesve nga Shqipëria dhe trevat shqiptare jashtë saj.

Sot, duke kujtuar Konsultën Gjuhësore të Prishtinës, nderojmë vizionin dhe përkushtimin e studiuesve që punuan për një gjuhë të përbashkët, si themel i identitetit dhe unitetit kombëtar. Trashëgimia e tyre mbetet një gur themeli në zhvillimin e kulturës dhe arsimit shqiptar.

Promovime

U prezantua vepra “Studime albanologjike në indoeuropianistikë, filologji dhe gjuhësi kontakti” kushtuar prof. dr. Bardhyl Demiraj



Prezantimet në kuadër të Panairit të 5-të mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor u çelën nga akad. Gëzim Hoxha, kryetar i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike (SSHSHA) me veprën “Studime albanologjike në indoeuropianistikë, filologji dhe gjuhësi kontakti”, botim i konceptuar si Festschrift në nderim të prof. dr. Bardhyl Demiraj. Përgatitësit e vëllimit janë prof. dr. Anila Omari, akad. Shaban Sinani dhe Ledio Hala.

Akad. Hoxha vlerësoi kontributet e prof. dr. Demiraj në etimologji, gjuhësi krahasimtare indoeuropiane, historinë e gjuhës shqipe, filologji dhe dialektologji historike, si dhe rolin e tij në albanologjinë ndërkombëtare.

Ai theksoi se bilanci i kësaj veprimtarie është mbresëlënëses me 17 studime monografike dhe përmbledhje artikujsh shkencorë në gjuhësi, mbi 220 artikuj të botuar në revista të specializuara ndërkombëtare, dhjetëra përkujdesje editoriale dhe recensione kritike, si dhe me organizimin e disa konferencave ndërkombëtare të rëndësishme kushtuar albanologjisë në kontekstin ballkanik, europian dhe indoeuropian.

Më tej ai theksoi se vepra përbën një dëshmi të gjallë të respektit shkencor dhe njerëzor që gëzon prof. Demiraj në komunitetin ndërkombëtar të studiuesve, por edhe një dëshmi të ndikimit të thellë, që një personalitet shkencor ka ushtruar në zhvillimin e kësaj fushe identitare të studimit.

Në përfundim të fjalës së tij, teksa vlerësoi karrierën 45-vjeçare të prof. Demiraj, duke e përcaktuar atë si një nga përfaqësuesit më të spikatur të studimeve albanologjike në hapësirën akademike europiane, akad. Hoxha çmoi edhe punën e tij si autor i vëllimit kushtuar shqipes në Fjalorin e madh të indoeuropianes dhe gjuhëve indogjermane të botuar nga Universiteti i Mynihut dhe kontribute të tjera të rëndësishme në përgatitjen dhe botimin kritik të veprave të autorëve të vjetër të letërsisë shqipe dhe në studimin e dëshmimeve të rralla leksikore të shqipes në kontekste aloglote dhe në dorëshkrime arkivore.

Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike prezantoi tri vepra të autorëve Kozeta Sevrani, Kujtim Onuzi dhe Hajri Haska



Në ditën e parë të Panairit të 5-të mbarëkombëtar të librit akademik, Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike, pjesë e Akademisë Shkencave, prezantoi tri vepra: Monografia shkencore “Ofiolitet e Shqipërisë së Jugut” me autor prof. dr. Kujtim Onuzi trajton masivet ofiolitike në jug të Shqipërisë, duke analizuar përbërjen gjeologjike, strukturën tektonike dhe rolin e tyre në historinë e mbylljes së baseneve oqeanike. Autori i vendos këto studime në kontekstin e evolucionit të litosferës oqeanike dhe zhvillimit të maleve në rajon, duke ofruar një bazë të rëndësishme për studiuesit e gjeologjisë. Vepra përfaqëson një nga studimet më të plota mbi ofiolitet në Shqipëri, duke e paraqitur vendin si një “laborator natyror” për studimin e litosferës oqeanike dhe duke krijuar bazë për krahasime ndërkufitare në rajonin ballkanik. Libri shërben gjithashtu si literaturë referuese për studentët dhe studiuesit në fusha si petrologjia dhe tektonika.

Libri “Teknologjitë inteligjente në industrinë e mikpritjes në Shqipëri: Një kornizë zbatimi për turizëm të qëndrueshëm / Smart Technologies in the Hospitality in Albania”, me bashkëautorë prof. asoc. Dr. Majlinda Godolja, Dr. Romina Muka, dr. Denisa Millo, MSc. Matilda Naco dhe MSc. Tea Tavanxhiu, u prezantua nga akad. Kozeta Sevrani. Ky botim përfaqëson një nga studimet më të plota mbi gatishmërinë digjitale të sektorit të hotelierisë në Shqipëri. Duke analizuar 1,821 struktura akomodimi, ai tregon se teknologjitë inteligjente janë thelbësore për rritjen e efikasitetit, kursimin e energjisë dhe përmirësimin e përvojës së klientit, ndërsa sfidat kryesore mbeten financimi dhe kapacitetet teknike. Studimi synon të vlerësojë gatishmërinë digjitale të

industrisë dhe të propozojë një kornizë zbatimi për turizëm të qëndrueshëm, duke integruar inteligjencën artificiale (IA) dhe teknologjitë smart.

Monografia “Urban Environment: Binomial Construction – Urban Greening” me autor prof. dr. Hajri Haska, botuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë në vitin 2025, u prezantua nga akad. Neki Frashëri, kryetar i Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike. Libri analizon ndikimin e gjelbërimit urban në cilësinë e jetës, propozon modele ndërtimi që integrojnë elemente natyrore dhe ofron perspektiva mbi politikat e zhvillimit urban në Shqipëri dhe rajon. Ai thekson rëndësinë e përfshirjes së gjelbërimit në projektet urbane për reduktimin e ndotjes dhe përmirësimin e mikroklimës.

Monografia përbën gjithashtu një referencë të rëndësishme për studentët e arkitekturës, urbanistikës dhe mjedisit.

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës dhe seksionet e saj prezantojnë botimet dhe zhvillimet shkencore në Panair



Në ditën e dytë të Panairit të 5-të mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor, të organizuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, u zhvillua një sesion i veçantë me prezantime dhe diskutime me peshë të lartë shkencore dhe akademike. Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë zhvilloi një sesion të veçantë me prezantime dhe diskutime me peshë të lartë shkencore dhe akademike. Tri vepra të rëndësishme në fushën e gjuhësisë dhe letërsisë shqipe:

“Leksikoni i termave të gramatikës”, për të cilin folën recensenti akademik Shkumbin Munishi dhe autorët akademikë Rexhep Ismajli dhe Bardh Rugova, me moderimin e anëtarit korrespondent Nysret Krasniqi; “Kanoni – ese për letërsinë shqipe”, ku diskutuan recensenti Nysret Krasniqi dhe autori akademik Sabri Hamiti, ndërsa moderimin e udhëhoqi akademik Bardh Rugova; si dhe “Metonimia”, për të cilën folën recensenti Nysret Krasniqi dhe autori akademik Kujtim Shala, nën moderimin e akademik Bardh Rugovës.

Në vijim, Seksioni i Shkencave Shoqërore organizoi një sesion promovimesh me përmbajtje të rëndësishme shkencore dhe akademike, ku u trajtuan tri botime me tematikë aktuale dhe peshë të veçantë në fushën e studimeve shoqërore.

U prezantua vepra “Konvergjenca ekonomike e Kosovës me Bashkimin Evropian”, për të cilën folën recensentja akademike Justina Sh. Pula dhe autori akademik Isa Mustafa. Më pas u paraqit vepra “Rimendimi i filozofisë së Nietzsche-s”, ku diskutuan recensenti prof. dr. Astrit Salihu dhe autori akademik Muhamedin Kullashi. Po ashtu u promovua edhe vepra “Konferenca e Rambujesë dhe intervenimi i NATO-s në Kosovë”, me pjesëmarrjen e recensentit akademik Jusuf Bajraktari dhe autorit akademik Arsim Bajrami.



Në ditën e dytë të Panairit V mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor, Seksioni i Shkencave të Natyrës solli një prezantim me rëndësi të veçantë shkencore. U paraqit vepra “Eksergjia”, për të cilën foli anëtari korrespondent Fetah Podvorica, ndërsa autori i saj, akademik Fejzullah Krasniqi, ndau qasjet dhe rezultatet kryesore të punimit. Prezantimi u zhvillua nën moderimin e anëtarit korrespondent Enver Hamiti, i cili udhëhoqi diskutimin duke i dhënë hapësirë trajtimit shkencor dhe sqarimit të aspekteve kyçe të veprës.

Ky sesion u karakterizua nga një diskutim i fokusuar akademik, duke theksuar rëndësinë e kërkimeve në fushën e shkencave të natyrës dhe kontributin e tyre në zhvillimin e mëtejshëm të dijes shkencore.

Diskutimet në tërësi u karakterizuan nga një qasje e thelluar analitike dhe kritike, duke sjellë vlerësime të rëndësishme mbi kontributin e këtyre botimeve në zhvillimin e studimeve bashkëkohore. Me këtë sesion u vijua dita e dytë e panairit, duke përforcuar rolin e tij si një platformë e rëndësishme e debatit akademik dhe shkencor në hapësirën mbarëkombëtare.

Instituti i Historisë prezantoi botimet më të fundit në Panairin V mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor



Në kuadër të Panairit V mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor, Instituti i Historisë pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (ASHSH), përmbylli me sukses prezantimin e botimeve të tij më të fundit, duke sjellë në vëmendje të publikut dhe komunitetit shkencor studime të rëndësishme mbi historinë moderne dhe bashkëkohore shqiptare.

Studiuesi prof. asoc. Afrim Krasniqi paraqiti veprën “Marrëdhëniet shqiptaro-britanike gjatë shek. XX (akte konference)”, duke hedhur dritë mbi raportet diplomatike dhe politike mes Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar në një periudhë të rëndësishme historike.

Gjatë këtij prezantimi u paraqitën tri vepra me karakter studimor dhe dokumentar. Studiueset Ledia Dushku dhe Sonila Boçi prezantuan botimin “Rruga e shqiptarëve drejt pavarësisë dhe sfidat e procesit të shtetndërtimit (akte konference)”.

I pranishëm në promovim ishte edhe ambasadori i Britanisë së Madhe në Shqipëri, z. Nick Abbott, i cili falënderoi për ftesën dhe vlerësoi punën e stafit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë për botimin e librit të ri. Ai theksoi se kjo është hera e parë që Foreign Office ndërmerr një lëvizje të tillë (nga Kosova drejtpërdrejt në Shqipëri), çka e bën të ndihet i nderuar që përfaqëson Britaninë në të dyja shtetet kryesore shqiptare në

rajon. Në fjalën e tij, ambasadori u ndal edhe te marrëdhëniet Britani–Shqipëri, duke vënë në dukje se për shumë britanikë Shqipëria nuk ka qenë pjesë e ndërgjegjes historike, për shkak të fokusit tradicional te rajone të tjera si India apo kanali i Suezit, por theksoi se kjo situatë po ndryshon me shpejtësi.



Veprimtaria u mbyll me prezantimin e studimit “Vendosja e regjimit komunist në Shqipëri 1944–1949” me autor prof. asoc. Gjon Boriçin. Ai bëri një analizë të detajuar mbi konsolidimin e regjimit komunist dhe zhvillimet politike të viteve të para pas Luftës së Dytë Botërore.

U prezantua vepra studimore “Sistemi monetar shqiptar dhe institucioni i bankës qendrore në Shqipëri 1912–2025”, me autor prof. dr. Aristotel Pano



Në kuadër të Panairit të 5-të të librit akademik dhe shkencor, të zhvilluar në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, u prezantua një botim me vlerë të veçantë studimore dhe historike: “Sistemi monetar shqiptar dhe institucioni i bankës qendrore në Shqipëri 1912–2025”, botuar nga Banka e Shqipërisë.

Zëvendëskryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Vasil Tole e vlerësoi bashkëpunimin e qëndrueshëm dhe të rëndësishëm ndërmjet Akademisë dhe Bankës së Shqipërisë, duke theksuar rolin e kësaj të fundit jo vetëm si institucioni më i rëndësishëm financiar në vend, por edhe si promovuese e vlerave të trashëgimisë kulturore kombëtare. Ai nënvizoi veçanërisht rëndësinë e Muzeut të Bankës së Shqipërisë, të cilin e cilësoi si një ndër institucionet muzeore më të spikatura në vend, si dhe kontributin e bankës në botimin e veprave të rëndësishme shkencore ndër vite, përfshirë edhe këtë studim madhor të prof. dr. Aristotel Panos.

Ish-zëvendësguvernatorja e parë e Bankës së Shqipërisë, znj. Elisabeta Gjoni, theksoi se botimi i kësaj vepre përkon me dy përvjetorë të rëndësishëm: 100-vjetorin e themelimit të Bankës së Shqipërisë dhe 100-vjetorin e hedhjes në qarkullim të monedhës së parë

kombëtare. Ajo shprehu mirënjohje për autorin dhe familjen e tij për besimin e dhënë, duke e cilësuar këtë botim si një zgjedhje të denjë për të shënuar këto momente historike. Duke ndarë edhe një vlerësim personal, znj. Gjoni e përshkroi prof. dr. Aristotel Panon jo vetëm si një studiues të shquar, por edhe si një mentor frymëzues, pjesë e një plejade dijetarësh të rrallë që nuk reshtin së kërkuari dijen. Sipas saj, ai ka arritur ta përcjellë ekonominë jo thjesht si një disiplinë formulash, por si një mënyrë për të kuptuar më thellë botën dhe dijen.



Znj. Besa Prela, përgjegjëse e Muzeut dhe botimeve të Bankës së Shqipërisë, e mbylli prezantimin e veprës duke theksuar rolin e Bankës së Shqipërisë si institucion botues dhe rëndësinë e publikimeve të saj në fushën e edukimit financiar jo vetëm në kuadër të konferencave shkencore. Ajo u shpreh se nuk ka njohuri të plota mbi botimet e mëparshme të Bankës së Shtetit Shqiptar, pasi fondi i tyre nuk është dorëzuar pranë Bankës së Shqipërisë, por ndodhet në Arkivin e Shtetit. Sipas saj, pas vitit 1992 Banka e Shqipërisë ka nisur një veprimtari të rregullt botuese me raportin vjetor dhe raportin e politikës monetare, ndërsa nga vitet 2006–2007 vihet re një zgjerim i vazhdueshëm si në numrin, ashtu edhe në llojshmërinë e botimeve të institucionit.

Promovohen dy botime të Universitetit të Tetovës në Panairin V mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor



Në kuadër të Panairit V mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor, i vlerësuar për rëndësinë e veçantë për promovimin e botimeve shkencore dhe akademike në hapësirën mbarëkombëtare, mori pjesë edhe Universiteti i Tetovës. Ky institucion u prezantua me dy kontribute të rëndësishme në fushën e studimeve shkencore dhe kërkimit akademik. Në këtë aktivitet u bë promovimi i librit me recensent prof. dr. Vullnet Ahmeti, me titull “Shqiptarët ortodoksë në Republikën e Maqedonisë”, një vepër që trajton aspekte të rëndësishme historike, identitare dhe shoqërore të shqiptarëve ortodoksë në Maqedoninë e Veriut. Po ashtu, në të njëjtin kuadër u promovua edhe revista shkencore “Filologjia”, nga prof. dr. Emine Shabani, dekane e Fakultetit të Filologjisë në Universitetin e Tetovës. Revista përfaqëson një platformë të rëndësishme për publikimin e punimeve shkencore në fushën e gjuhësisë, letërsisë dhe studimeve filologjike në përgjithësi. Pjesëmarrja e Universitetit të Tetovës në këtë panair dëshmon për angazhimin e tij të vazhdueshëm në zhvillimin e kërkimit shkencor, si dhe në promovimin e botimeve akademike me vlerë kombëtare dhe ndërkombëtare.

Instituti Albanologjik i Prishtinës prezantoi botimet në Panairin V mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor



Prezantimi i botimeve të Institutit Albanologjik të Prishtinës në Panairin V mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor solli në vëmendje kërkimet më të reja me karakter studimor dhe shkencor.

Gjatë këtij prezantimi u paraqit monografia e Nuridin Ahmetit “Albanologjia në Jugosllavi sipas dokumenteve të arkivave në Shqipëri”, në dy vëllime.

Vepra trajton zhvillimin e albanologjisë në një kontekst të gjerë historik dhe mbështetet në materiale arkivore të rëndësishme.

Po ashtu u prezantua edhe Vepra e Adeline Selmanit “Onomatopetë dhe pasthirrmat në gjuhën shqipe”, e cila ofron një analizë të hollësishme gjuhësore mbi shprehjet tingullore dhe elementet ekspresive të shqipes.

Gjatë këtij aktiviteti referuan dhe komentuan disa studiues të fushës, të cilët theksuan rëndësinë e këtyre botimeve për albanologjinë dhe studimet gjuhësore, duke vlerësuar kontributin e tyre në pasurimin e kërkimit shkencor dhe literaturës akademike.

Instituti Pedagogjik i Kosovës në Panairin V mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor



Instituti Pedagogjik i Kosovës mori pjesë në Panairin V mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor, duke prezantuar numrat 1 dhe 2 të revistës shkencore “Kërkime Pedagogjike”, një botim i rëndësishëm në fushën e studimeve arsimore dhe kërkimit pedagogjik.

Gjatë këtij prezantimi prof. Murteza Osdautaj dhe prof. Osman Buleshkaj trajtuan rëndësinë e kërkimit shkencor në arsim, rolin e revistës në pasurimin e literaturës profesionale si dhe ndikimin e studimeve pedagogjike në përmirësimin e praktikave mësimore dhe zhvillimin e procesit edukativ.

Revista “Kërkime Pedagogjike” përfaqëson një platformë të rëndësishme për studiuesit dhe profesionistët e arsimit, duke sjellë analiza, studime dhe reflektime mbi çështje bashkëkohore të edukimit, si dhe duke kontribuar në avancimin e mendimit pedagogjik në vend.

U prezantua libri “Lëvizja revolucionare-kombëtare shqiptare dhe maqedonase në rrjetet e diplomacisë sovjetike” me autor Mehmet Prishtinën

Prezantimi u organizua në kuadër të pjesëmarrjes së Instituti të Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut në edicionin e 5-të të Panairit mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, i cili organizohet në bashkëpunim me Akademinë e Arteve dhe Shkencave e Kosovës (ASHAK) dhe Qendrën Kombëtare të Librit dhe Leximit në Tiranë.

Studimi monografik “Lëvizja revolucionare-kombëtare shqiptare dhe maqedonase në rrjetet e diplomacisë sovjetike (1922-1928)” trajton tema me rëndësi historike, duke u fokusuar tek ndikimet e diplomacisë ilegale sovjetike me lëvizjet revolucionare shqiptare dhe maqedonase midis viteve 1922- 1928.

Studimi përfshin çështjet e diplomacisë ilegale sovjetike, të qendrës së saj që ndodhej në Vjenë (Austri) dhe që ishte përgjegjëse për vendet ballkanike; lidhjet midis subjekteve të lëvizjeve revolucionare shqiptare dhe maqedonase në të ashtuquajturën qendra vjeneze e diplomacisë ilegale sovjetike; si dhe çështjet rreth krijimit të KONARE-s (Komiteti Revolucionar Kombëtar Shqiptar) dhe VMRO-së, etj. Sipas Prishtinës, pa e kuptuar atë që ka ndodhur në një periudhë prej 6 vitesh – nga viti 1922 deri në vitin 1928 në lëvizjen revolucionare shqiptare dhe maqedonase, nuk është e mundur të kuptohen zhvillimet e më mëvonshme.

Mehmet Prishtina me vite është angazhuar për promovimin e vlerave të Hasan Prishtinës. Ai rrëfen episodet më kontroverse në historinë e Komitetit të Kosovës Pas Luftës së Parë Botërore, kur lëvizjet revolucionare shqiptare dhe maqedonase u përballën me të njëjtat probleme, të cilat shpalosen përmes këtij studimi. Libri përmban edhe dokumente që publikohen për herë të parë, sikurse ato për veprimtarinë e agjentit sovjetik “Blerio” apo dokumente për pjesëmarrjen e Ahmet Zogut në iniciativën për krijimin e Partisë Komuniste Shqiptare, etj.

Instituti i Antropologjisë prezanton botimet më të fundit në Panairin V mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor



Instituti i Antropologjisë, pjesë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, në ditën e dytë të Panairit V mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor vijoi prezantimin e botimeve më të fundit, duke sjellë në vëmendje zhvillimet më të reja në fushën e kërkimit shkencor.

Studiuesi dr. Edmir Ballgjati prezantoi punimin me titull “Në fillesat e muzikologjisë shqiptare – shkrimet e profesor Albert Papparistos në periodikun shqiptar”, ku vuri në dukje kontributet e hershme në fushën e muzikologjisë shqiptare, si dhe rolin e rëndësishëm që ka luajtur shtypi shqiptar në formësimin dhe zhvillimin e kësaj disipline shkencore.

Ndërkohë, një tjetër botim i prezantuar në kuadër të panairit ishte edhe ai i studiuesit dr. Ervin Kaçi, me titull “Një antropologji mbi varfërinë dhe të skajuarit: rasti i romëve në Shqipëri”, i cili trajton në mënyrë analitike dhe kritike një nga çështjet më të ndjeshme sociale në shoqërinë shqiptare bashkëkohore.

Prezantimet e Institutit të Antropologjisë u vlerësuan për qasjen e tyre analitike, si dhe për tematika të rëndësishme që trajtojnë, duke kontribuar në thellimin e debatit shkencor mbi çështje kulturore, sociale dhe historike në kontekstin e shoqërisë shqiptare.

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" prezantoi librat më të rinj të autorëve Tefë Topalli, Artan Haxhi e Roland Guli



Në panairin e 5-të mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor, Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" promovoi librin me dy vëllime "Krestomaci e albanologjisë" të autorëve Tefë Topalli e Artan Haxhi dhe librin "Metodikë e edukimit muzikor" me autor pedagogun Roland Guli.

Vepra "Krestomaci e Albanologjisë" e autorëve Tefë Topalli e Artan Haxhi e botuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, përfshin kritikë gjuhësore (morfologji, sintaksë, dialektologji, leksikografi) dhe shoqërohet me një parathënie të përkthyer në anglisht nga dr. David Hosaflook dhe prof. dr. Nuri Gokaj. Libri u vlerësua për përmbledhjen e kontributeve të 126 gjuhëtarëve shqiptarë dhe dhjetëra albanologëve të huaj, nga Konstandin Kristoforidhi deri në ditët e sotme, të cilët kanë hartuar vepra themelore me rëndësi të veçantë për studimet albanologjike, duke sjellë fragmente, bibliografi dhe analiza që pasqyrojnë rrugëtimin e gjuhës shqipe dhe studimeve albanologjike ndër shekuj.

Gjithashtu, vepra u vlerësua si një burim bibliografik madhor për studiuesit e gjuhës shqipe, letërsisë dhe kulturës shqiptare dhe si një prurje e veçantë metodologjike, duke marrë formën e një krestomacie, me lexime të shkurtra, që zbulojnë natyrën dhe fushën e kërkimeve gjuhësore të zërave të paraqitur dhe si një referencë e pazëvendësueshme për

albanologjinë.

Libri “Metodikë e edukimit muzikor” me autor pedagogun Roland Guli u vlerësua si kontribut i rëndësishëm në fushën e didaktikës muzikore. Ky studim i vjen në ndihmë mesimdhënies së muzikës në arsimin parashkollor dhe fillor, duke sjellë një qasje praktike mbi edukimin muzikor, nëpërmjet metodave, teknikave dhe materialeve konkrete për mësuesit.

Autori u shpreh se e përgatiti këtë libër me synimin për ta bërë procesin mesimor më krijues dhe më të përshtatshëm për fëmijët dhe studentët e pedagogjisë muzikore. Studimi përqendrohet në zhvillimin e ndjeshmërisë muzikore dhe aftësive krijuese që në moshë të hershme, duke nënvizuar rolin e pazëvendësueshëm të muzikës në edukimin e hershëm dhe në përgatitjen cilësore të mësuesve të ardhshëm.

Botimet e reja të Institutit të Arkeologjisë në Panairin V mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor



Në ditën e dytë të Panairit V mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor u përmbyll prezantimi i botimeve të Institutit të Arkeologjisë, pjesë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, të cilat përmbledhin kërkimin shkencor dhe studimet në fushën e arkeologjisë, duke sjellë në vëmendje punime me vlera të veçanta historike dhe kulturore. Gjatë këtij aktiviteti, më parë u prezantua vepra e studiuesit akad. Adem Bunguri “Përkrenare ilire në Shqipëri dhe Kosovë” (album), që përfaqëson për herë të parë një katalog dhe databazë të përkrenareve në territorin e Shqipërisë dhe Kosovës. Në këtë libër autori sjell risi duke trajtuar për herë të parë çështjen e origjinës së përkrenareve në Shqipëri. Libri përmbledh 40 përkrenare ilire të zbuluara deri më sot në territorin shqiptar dhe kosovar, duke i analizuar tipologjikisht, kronologjikisht dhe historiko-kulturorisht, ku përfshihen edhe 5 përkrenare të tipologjive të tjera të gjetura në Shqipëri. Punimi studimor monografik i akad. Bungurit u vlerësua si një arritje e arkeologjisë shqiptare, duke vlerësuar qasjen analitike dhe katalogimin e plotë të përkrenareve ilire, të cilat datohen nga shekulli VII p.K. deri në mesin e shekullit II p.K., periodha e Mbretërisë së Gentit.

Më pas prof. dr. Lavdosh Jaupaj prezantoi studimin “Populations et Interactions Culturelles en Aire Illyro-Epirote du VIIe au IIIe siècle”, i cili trajton ndërveprimet kulturore dhe dinamikat e popullsive në hapësirën iliro-epirote. Libri u vlerësua për mënyrën e interpretimit të historisë së popullsive ilire pa qasje hellenocentrike, duke nxjerrë në pah vektorët e ndërkulturalitetit.

Ndërsa prof. dr. Lida Miraj prezantoi librin “Orpheus. The evolution of the myth and Orpheus mosaic of Dyrrachium”, i cili analizon zhvillimin e mitit të Orfeut dhe pasqyrimin e tij në mozaikun e Dyrrahut, duke kontribuar në thellimin e studimeve mbi trashëgiminë kulturore dhe artistike të rajonit. Libri u vlerësua si një kontribut i rëndësishëm në kuptimin e ndërthurjes së mitologjisë me artin monumental të qytetit antik.

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” prezanton dy botime shkencore



Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, në kuadër të Panarit të V mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor prezantoi botime me vlera të veçanta shkencore në fushën e studimeve historike dhe gjuhësore.

Në këtë aktivitet u paraqit vepra e prof. dr. Roland Gjinit, “Pavarësia e Kosovës, Federata Panshqiptare Vatra dhe gazeta Dielli e SHBA-së 1981–2008”, një studim që sjell në vëmendje një periudhë të rëndësishme historike të zhvillimeve politike dhe diasporës shqiptare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, duke analizuar rolin e organizatave dhe mediave shqiptare në mbështetje të çështjes së Kosovës.

Po ashtu, u prezantua edhe studimi i prof. Resul Telhaj, “Fjalja pyetëse në gjuhën shqipe”, një trajtesë shkencore me karakter gjuhësor, e cila ofron një analizë të detajuar të strukturës, funksioneve dhe përdorimit të fjalisë pyetëse në shqipen standarde dhe dialektore.

Me këto prezantime, Universiteti i Elbasanit përmbylli pjesëmarrjen e tij në këtë panair, duke dëshmuar angazhimin e vazhdueshëm në promovimin e kërkimit shkencor dhe botimeve akademike me vlera kombëtare dhe ndërkombëtare.

Shoqata Kulturore Shqiptare “ILIRIA” e Sllovenisë prezantoi veprën “Shqiptarët e lashtë dhe krijimi i Istrias” me autor dr. Peter Štoka



Shoqata Kulturore Shqiptare “ILIRIA” në Koper–Kapodistria, në bashkëpunim me Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Slloveni, në kuadër të Panairit V mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor, prezantoi një nga veprat e “Opusit albanologjik të studiuesit shkencor dr. Peter Štoka: “Shqiptarët e lashtë dhe krijimi i Istrias” me recensent prof. dr. Irakli Koçollari.

Në këtë aktivitet morën pjesë personalitete të rëndësishme të fushës akademike dhe diplomatike, ndër ta zëvendëskryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Vasil Tole, si dhe ambasadori i Republikës së Sllovenisë në Republikën e Shqipërisë, z. Jakob Štunf.

Botimi është pjesë e një opusi më të gjerë, i cili evidenton kërkimet e dr. Peter Štoka-s mbi rrënjët ilire dhe trashëgiminë kulturore shqiptare. Vepra e prezantuar, “Shqiptarët e lashtë dhe krijimi i Istrias”, u vlerësua për rolin e shqiptarëve të lashtë në formësimin historik të Istrias, duke e vendosur këtë rajon në një kontekst më të gjerë kulturor e historik. Vepra i trajton lidhjet historike dhe kulturore ndërmjet hapësirës sllovene dhe asaj ilire, duke i interpretuar ato përmes një qasjeje shkencore ndërdisiplinore. Edhe pse nuk është gjuhëtar i gjuhës shqipe, ai thekson rëndësinë e lidhjeve ilire si një element qendror në ndërtimin e narrativave historike dhe albanologjike në rajon.

Zv. kryetari i ASHSH-së akad. Vasil Tole vlerësoi përfshirjen e kësaj vepre në programin e Panairit të V mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor, duke theksuar se prezantimi i studimit “Shqiptarët e lashtë dhe krijimi i Istrias” nga dr. Peter Štoka përbën një kontribut të rëndësishëm në zgjerimin e perspektivave shkencore mbi çështjet albanologjike dhe historinë e lashtë të rajonit.

Ky prezantim vuri në fokus kontributin albanologjik të autorit dhe studimet mbi origjinën ilire, duke sjellë një qasje ndërkombëtare dhe ndërdisiplinore në interpretimin e trashëgimisë historike shqiptare.

Kolegji AAB prezanton kërkimin shkencor dhe veprën “Eternale”



Aktivitetet në kuadër të Panairit V Mbarëkombëtar të Librit Akademik dhe Shkencor vijuan me prezantimet e realizuara nga Kolegji AAB, duke sjellë para publikut një pasqyrë të gjerë të angazhimit të tij në fushën e kërkimit shkencor dhe botimeve akademike.

Gjatë këtij prezantimi u theksua veprimtaria e pasur kërkimore e Kolegjit AAB, e cila përfshin një gamë të gjerë disiplinash studimore dhe reflekton përkushtimin e institucionit për të kontribuar në zhvillimin e dijes, avancimin e shkencës dhe promovimin e mendimit kritik në shoqërinë bashkëkohore. Po ashtu, u nënvizua roli i rëndësishëm i këtij institucioni në nxitjen e kërkimit cilësor dhe në përgatitjen e kuadrove të reja akademike.

Në të njëjtën kohë, pjesë e aktivitetit ishte edhe prezantimi i veprës së autorit Rrahman Paçarizi, me titull “Eternale”, e cila u vlerësua si një kontribut i rëndësishëm në krijimtarinë letrare dhe mendimin bashkëkohor shqiptar. Kjo vepër pasuron më tej fondin e botimeve që trajtojnë tema aktuale dhe reflektojnë zhvillimet kulturore e shoqërore në hapësirën shqiptare.

Panairi i Librit Akademik dhe Shkencor mbetet një platformë e rëndësishme për promovimin e botimeve cilësore, shkëmbimin e ideve dhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve akademike në mbarë hapësirën shqiptare.

Instituti i Historisë “Ali Hadri” prezantoi veprat “Diaspora shqiptare dhe çështja e Kosovës 1912–2008” dhe “Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës”



Aktivitetet në kuadër të Panairit V Mbarëkombëtar të Librit Akademik dhe Shkencor vijuan me prezantimet e realizuara nga Kolegji AAB, duke sjellë para publikut një pasqyrë të gjerë të angazhimit të tij në fushën e kërkimit shkencor dhe botimeve akademike.

Gjatë këtij prezantimi u theksua veprimtaria e pasur kërkimore e Kolegjit AAB, e cila përfshin një gamë të gjerë disiplinash studimore dhe reflekton përkushtimin e institucionit për të kontribuar në zhvillimin e dijes, avancimin e shkencës dhe promovimin e mendimit kritik në shoqërinë bashkëkohore. Po ashtu, u nënvizua roli i rëndësishëm i këtij institucioni në nxitjen e kërkimit cilësor dhe në përgatitjen e kuadrove të reja akademike.

Në të njëjtën kohë, pjesë e aktivitetit ishte edhe prezantimi i veprës së autorit Rrahman Paçarizi, me titull “Eternale”, e cila u vlerësua si një kontribut i rëndësishëm në krijimtarinë letrare dhe mendimin bashkëkohor shqiptar. Kjo vepër pasuron më tej fondin e botimeve që trajtojnë tema aktuale dhe reflektojnë zhvillimet kulturore e shoqërore në hapësirën shqiptare.

Panairi i Librit Akademik dhe Shkencor mbetet një platformë e rëndësishme për

promovimin e botimeve cilësore, shkëmbimin e ideve dhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve akademike në mbarë hapësirën shqiptare.

Promovohet vepra “Arti i Naimit” në Panairin V mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor



Në kuadër të Panairit të V mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor, “Argeta” LMG prezantoi në ambientet e Akademisë së Shkencave veprën e studiuesit M. Gëzhilli me titull “Arti i Naimit”.

Ky botim përfaqëson një kontribut të rëndësishëm në fushën e studimeve letrare, duke trajtuar në mënyrë të thelluar dimensionet artistike, estetike dhe filozofike të krijimtarisë së Naim Frashërit. Përmes një analize të strukturuar dhe interpretimi bashkëkohor, autori sjell një këndvështrim të ri mbi figurën dhe veprën e një prej përfaqësuesve më të shquar të Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

Studimi evidenton rolin e Naim Frashërit në formësimin e identitetit kulturor dhe gjuhësor shqiptar, si dhe ndriçon elementët patriotikë e humanistë që përshkojnë krijimtarinë e tij. Ky botim i shtohet fondit të studimeve albanologjike si një vlerë e mirëfilltë për komunitetin akademik dhe më gjerë.

AKKSHI prezanton mbështetjen për kërkimin shkencor në Panairin V mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor



Në ditën e tretë të Panairit V Mbarëkombëtar të Librit Akademik dhe Shkencor u prezantua kontributi dhe mbështetja e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI) për zhvillimin e kërkimit shkencor në vend.

Drejtoresha e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit znj. Daniel Pirushi, mbajti një fjalë përshëndetëse, duke e vlerësuar panairin si një platformë të vlefshme për ekspozimin e botimeve akademike e shkencore, për shkëmbimin e ideve dhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet studiuesve dhe institucioneve. Ajo nënvizoi se aktivitete të tilla kontribuojnë në ndërtimin e një komuniteti të qëndrueshëm shkencor, ku bashkëpunimi dhe ndërveprimi ndërmjet aktorëve të dijes krijojnë mundësi më të

médha për zhvillim dhe projekte me ndikim shoqëror.

Në emër të Ministrisë së Arsimit, znj. Pirushi premtoi angazhimin e vazhdueshëm institucional dhe financiar për mbështetjen e kërkimit shkencor, duke e konsideruar këtë një instrument kyç për zhvillimin e kapaciteteve akademike dhe përmirësimin e cilësisë së kërkimit në vend.

Gjatë pesë viteve të fundit, AKKSHI ka rritur ndjeshëm numrin e projekteve kombëtare të financuara - rreth 5.5 herë më shumë krahasuar me periudhat e mëparshme. Ky progres reflekton një angazhim konkret të mbështetur në të dhëna dhe në ndërtimin e një baze të qëndrueshme kërkuesish shkencorë. Ndër iniciativat e veçanta u përmendën programet kombëtare për doktorantët, të cilat synojnë të inkurajojnë hapat e parë në kërkimin shkencor dhe të integrojnë studiuesit e rinj në hapësirën evropiane të kërkimit. Në përfundim, znj. Pirushi theksoi se përmes këtyre iniciativave krijohen mundësi për projekte konkurruese dhe inovative, që kontribuojnë jo vetëm në avancimin e shkencës, por edhe në shërbim të shoqërisë dhe të ardhmes së saj.

Promovimi i botimeve të reja akademike nga Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë



Në kuadër të Panairit V mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor, u prezantua botimi dhe aktiviteti akademik i Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë përmes disa titujve të rinj në fushën e ekonomisë dhe të shkencave të lidhura.

Gjatë prezantimit u veçuan disa vepra me rëndësi të veçantë për zhvillimin e mendimit ekonomik dhe akademik në vend.

Prof. dr. Vladimir Mici prezantoi librin “Ekonomiksi i aplikuar i punës”, një studim i thelluar mbi tregun e punës, produktivitetin dhe mënyrën se si teoritë ekonomike gjejnë zbatim në praktikën reale të punësimit dhe të zhvillimit ekonomik. Autori u shpreh se vepra është konceptuar në kapituj që trajtojnë çështje, si: përgatitja profesionale, politikat e punësimit dhe emigracioni, si dhe problematika të rëndësishme, si paga minimale dhe pensionet. Libri u drejtohet profesionistëve dhe vendimmarrësve, duke theksuar rëndësinë e rritjes së rendimentit të punonjësve dhe përzgjedhjes së tyre bazuar në performancë.

Prof.dr. Emilio Çika paraqiti librin “Diplomacia ekonomike”, një vepër që trajton marrëdhëniet ekonomike ndërkombëtare dhe rolin e shteteve në ndërtimin e politikave tregtare dhe diplomatike. Në fjalën e tij, autori theksoi se kjo vepër përfaqëson një

rrugëtim të gjatë në fushën e diplomacisë ndërkombëtare dhe synon të ndërtojë një urë lidhëse mes akademisë, ekonomisë dhe jetës institucionale në Shqipëri.

Prof.dr. Florjan Bombaj prezantoi librin “Ekonomia e imagjinatës”, një qasje ndërdisiplinore që trajton lidhjen mes ekonomisë, kreativitetit dhe rolit të ideve në zhvillimin ekonomik. Vepra sjell një reflektim teorik mbi realitetin bashkëkohor, duke analizuar mënyrën se si imagjinata dhe inovacioni ndikojnë në transformimet ekonomike dhe shoqërore.

Ky prezantim shërbeu si një moment i rëndësishëm promovimi për kërkimin shkencor të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, duke vënë në dukje përkushtimin e tij ndaj zhvillimit të ekonomisë bashkëkohore dhe qasjeve inovative në studimet akademike.

Promovohet libri “Portreti i një shkencëtari” kushtuar prof. dr. Lekë Gjicknurit



Në kuadër të Panairit V mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor, shtëpia botuese “Toena” prezantoi botimin më të ri kushtuar figurës akademike dhe shkencore të prof. dr. Lekë Gjicknurit.

Libri “Portreti i një shkencëtari” me autor Eris Rusin, paraqet një qasje monografike mbi jetën, veprën dhe kontributin shkencor të profesorit Gjicknuri, duke ndriçuar dimensionin e tij profesional, njerëzor dhe intelektual.

Në fjalën e tij, Damian Gjicknuri, djali i profesorit, solli kujtime personale dhe reflektime mbi figurën e të atit, duke e cilësuar si një model qytetar dhe personalitet me karakter të fortë. Ai theksoi se profesori i dha vlerë praktike kërkimit shkencor, veçanërisht në studimet mbi botën nënujore dhe çështjet mjedisore, duke ruajtur integritetin edhe në periudha kur shkenca nuk gëzonte vlerësimin e duhur.

Akad. Skënder Gjinushi, kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, e vlerësoi prof.

Gjikhurin si një personalitet të shquar në shkencë dhe jetën publike, duke nënvizuar rigorozitetin dhe integritetin e tij. Ai solli kujtime personale nga njohja me profesorin, duke e konsideruar një model frymëzimi për brezat e rinj studiuesish.

Autori i librit, Eris Rusi, shprehu mirënjohje për familjen Gjikhuri, veçanërisht për znj. Liri Gjikhuri, për kontributin në ruajtjen e trashëgimisë së profesorit. Ai theksoi se libri është fryt i një pune kërkimore dhe bashkëpunimi, me synim pasqyrimin e plotë të jetës profesionale dhe shpirtërore të prof. dr. Gjikhuri.

Prof. dr. Ethem Ruka nënvizoi rëndësinë e figurës së prof. Gjikhuri në shkencën dhe jetën akademike shqiptare. Miq dhe njohës të tij, mes të cilëve akad. Rexhep Meidani, znj. Monika Kryemadhi dhe akad. Besnik Bare, sollën kujtime dhe vlerësime mbi kontributin e tij shumëdimensional, duke e cilësuar si një figurë të spikatur në shkencë, arsim dhe jetën publike.

Aktiviteti u mbyll me diskutime dhe vlerësime nga të pranishmit, të cilët theksuan rëndësinë e botimeve të tilla në dokumentimin e trashëgimisë shkencore dhe promovimin e figurave që kanë lënë gjurmë të qëndrueshme në zhvillimin e shkencës shqiptare. Prof. dr. Lekë Gjikhuri u vendos edhe një herë në vendin e merituar në kujtesën akademike dhe publike.

Prezantime të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë në Panairin e V mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor



Në ditën e tretë të edicionit të pestë të këtij panairi, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë (IGJL) prezantoi tri vepra: Shkencat e ligjërimit dhe diskursi letrar (Variacione mbi një temë) të prof. dr. Plangaricës; Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe. Vëllimi IV, botim i ASHSH-së (përgatitur për botim nga prof. asoc. Adelina Çerpja, akad. Valter Memisha, prof. dr. Artur Lama) dhe studimin “Letërsi e vjetër shqipe në kontekst ballkanik e evropian (shekujt XVI-XVII) të prof. asoc. dr. Evalda Pacit.

Prezantimin e hapi akad. Valter Memisha, drejtor i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë. “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe. Vëllimi IV”, u prezantua nga prof. asoc. Adelina Çerpja. Në vlerësimin e saj, ajo theksoi se punimet e përfshira analizojnë jo vetëm aspektin leksikor, por edhe atë terminologjik e leksikografik, duke i dhënë rëndësi të veçantë njësimimit dhe zbatimit të normës së shqipes. Sipas saj, “leksiku i shqipes është në ndryshim të vazhdueshëm, çka e bën studimin e tij thelbësor për të kuptuar zhvillimin e gjuhës në tërësi”. Ky vëllim dëshmon potencialin krijues të shqipes dhe nevojën për kërkime të pandërprera në këtë fushë të albanologjisë. Studimet e përfshira shërbejnë si mbështetje e vlefshme për pasurimin e gjuhës dhe për përpunimin e mëtejshëm të normës standarde, duke e parë këtë botim si pikënisje të rëndësishme për kërkime të reja shkencore.

Vepra ndërthur trashëgiminë e ndërtuar më herët me qasjet bashkëkohore të kërkimit gjuhësor dhe, si e tillë, shërben njëkohësisht si mbështetje dhe si pikënisje për hulumtime të mëtejshme në fushën e gjuhësisë shqiptare. Realizimi i saj është bërë i mundur falë kontributit të studiuesve nga IGJL, Universiteti i Tiranës, Universiteti i Shkodrës, Universiteti i Durrësit, si edhe nga institucione kërkimore e akademike në Prizren, Prishtinë, Shkup, Vjenë, Munihi dhe Shën Petersburg.

Prof. dr. Artur Lama prezantoi librin e prof. dr. Plangaricës, “Shkencat e ligjërimit dhe diskursi letrar (Variacione mbi një temë)”, duke e vlerësuar si rezultat të një reflektimi të gjatë mbi kërkime dhjetëvjeçare. Ai theksoi se vepra përmbledh materiale nga konferenca, ligjërata dhe botime të rëndësishme shkencore, duke dëshmuar një dialog të vazhdueshëm me traditën akademike europiane. Sipas tij, libri shpall një program të dyfishhtë: nga njëra anë synon të konsolidojë shkencat e ligjërimit si fushë të mirëpërcaktuar studimi, dhe nga ana tjetër nxit lirinë konceptore dhe variacionin në trajtimin e temave. Autori nuk ndjek një qasje të ngurtë doktrinare, por një mendim të hapur e krijues.

Në përmbyllje, Lama e konsideroi librin një pikë orientimi për albanologjinë bashkëkohore, sepse formulon saktë problemet dhe hap rrugë për diskutime të reja. Vepra mbush një boshllëk në studimet shqiptare mbi shkencat e ligjërimit dhe rekomandohet si literaturë e rëndësishme për studiuesit e gjuhësisë dhe letërsisë.

Librin e prof. asoc. dr. Evalda Pacit, “Letërsi e vjetër shqipe në kontekst ballkanik e evropian (shekujt XVI-XVII)” e prezantoi prof. dr. Merita Sauku Bruçi. Ajo e vlerësoi për vëzhgimet e thelluara mbi rrethanat e realizimit të veprave më të rëndësishme të letërsisë së vjetër shqipe, të vendosura në kontekstin e zhvillimeve kulturore të kohës, sidomos në raport me kulturën librore dhe shtypshkrimin. Vëllimi trajton çështje të censurës librore, ndikimin e Koncilit të Trentit (1545–1563), rolin e enteve botuese të shekullit XVII, si edhe elemente të identitetit kombëtar dhe trashëgimisë komplekse të ruajtur përmes akteve kishtarë. Gjithashtu, përfshin kontributet e studiuesve të albanologjisë mbi këtë periudhë të rëndësishme të kulturës së shkrimit dhe letërsisë humaniste. Recensentë shkencorë të veprës janë prof. dr. Monica Genesi (Universiteti i Salentos) dhe prof. asoc. dr. Merita Bruçi (Departamenti i Studimeve Letrare, IGJL, ASHSH), ndërsa redaktor shkencor është akad. Valter Memisha.

Universiteti i Tiranës përmyll prezantimet në Panairin e V mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor



Universiteti i Tiranës, pjesëmarrës në Panairin V mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor, përmylli prezantimin e tij me një sërë botimesh akademike në fusha të ndryshme të shkencës dhe studimit.

Gjatë aktivitetit u prezantuan disa vepra të rëndësishme. Ndër to spikati libri i Brikena Kadzadej, “prof. Eqrem Çabej në albanologji dhe në gjuhësinë europiane”, i cili trajton në mënyrë të thelluar kontributin shkencor të Eqrem Çabejt në studimet gjuhësore dhe rëndësinë e tij në albanologji dhe gjuhësinë europiane. Po ashtu, u prezantua “Nje varrim për çdo regjim”, studim historik dhe antropologjik i Klejdi Këllicit, që sjell një vështrim mbi historinë e Shqipërisë, si dhe botimi i Adriana Anxhakut, “E drejta dhe shoqëria”, i cili analizon marrëdhënien ndërmjet sistemit juridik dhe zhvillimeve shoqërore.

Ky prezantim shënoi mbylljen e pjesëmarrjes së Universitetit të Tiranës në panair, duke reflektuar gamën e gjerë të kërkimit dhe botimeve akademike që zhvillohen në këtë institucion.

Pas prezantimeve, Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Skënder Gjinushi, shprehu kënaqësinë për bashkëpunimin me Universitetin e Tiranës dhe për organizimin e panairit, i cili shërben si një platformë e rëndësishme për promovimin e botimeve shkencore dhe akademike.

Duke u ndalur te figura e Eqrem Çabejt, ai vlerësoi rëndësinë e veprës së paraqitur, duke

theksuar se kjo monografi sjell një qasje të domosdoshme për studiuesit dhe studentët. Sipas tij, nuk mund të ndërmerret një studim serioz në fushën e albanologjisë, pa u mbështetur në veprën e Çabejt, i cili e ka vendosur shkollën shqiptare të albanologjisë në një nivel të barasvlefshëm me traditat më të mira europiane.

Akad. Gjinushi e vuri theksin në rëndësinë e njohjes së tezave albanologjike mbi origjinën e gjuhës shqipe dhe lidhjet e saj me ilirishten, duke nënvizuar nevojën për mbrojtjen e këtyre tezave nga deformimet dhe interpretimet e pasakta, të cilat shpesh nxiten në hapësirën mediatike nga individë të paformuar ose dashakeqë.

Në vijim, duke iu referuar botimit “E drejta dhe shoqëria”, u nënvizua rëndësia e edukimit qytetar mbi rolin e ligjit në shoqëri. Ligji nuk duhet parë si pengesë, por si një domosdoshmëri që garanton rregullin dhe funksionimin normal të jetës shoqërore. U theksua se zbatimi i ligjit është përgjegjësi, jo vetëm e juristëve, por e çdo qytetari.

Prezantime të Universitetit “Fan Noli” të Korçës në Panairin V mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor



Universiteti “Fan Noli” i Korçës mori pjesë në edicionin e pestë të Panairit mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor, zhvilluar në ambientet e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, ku prezantoi botimet e tij më të fundit. Mes tyre spikati studimi “Themeluesit e komedisë shqiptare” i autorëve Eris Rusi dhe Jonela Spaho që sjell në vëmendje figurat korçare që hodhën themelet e komedisë shqiptare në fillim të shekullit XX. Libri u prezantua nga Jorina Kryeziu (Shkreta), e cila e vlerësoi librin edhe për lidhjen e mesazheve që përcjell vepra me aktualitetin.

Po ashtu, Jonela Spaho prezantoi veprën “Kristo Floqi, koha dhe vepra e tij letrare”, një analizë e thelluar mbi krijimtarinë e një prej personaliteteve të kulturës kombëtare. Një tjetër botim i rëndësishëm ishte “Bibliografi e arsyetuar për veprën e Lasgush Poradecit” nga Ilir Shyta, që përmbledh trashëgiminë e poetit të madh, ndërsa “Sociologji edukimi” e Irena Nikajt trajton dimensionet sociologjike të edukimit në shoqërinë shqiptare.

Vepra e prezantuara dëshmojnë përkushtimin e Universitetit “Fan Noli” në promovimin e dijes, kulturës dhe trashëgimisë letrare shqiptare, duke e vendosur Korçën në një rol të spikatur në hartën akademike kombëtare.

Universiteti i Mjekësisë prezanton një studim mbi asfiksionë mekanike



Në kuadër të Panairit të V mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, prezantoi botimin shkencor në fushën mjeko-ligjore “Asfiksia mekanike, mbytja në ujë” të autorit dr. Admir Sinamati.

Gjatë prezantimit, autori paraqiti një monografi që përfshin të dhëna statistikore mbi asfiksionë mekanike, duke trajtuar tema të ndjeshme dhe me rëndësi të veçantë për praktikën mjeko-ligjore. Monografia nuk kufizohet vetëm në analizën e vdekjes si fenomen, por ofron një qasje të gjerë e të thelluar mbi proceset që lidhen me të.

Në pjesën e parë, punimi fokusohet në trajtimin teorik të mekanizmave të asfiksionë dhe ndikimin e tyre në organizëm. Më tej, analiza përqendrohet në klasifikimin dhe cilësimin e llojeve të ndryshme të asfiksionë, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë rasteve të mbytjes në ujë.

Studimi trajton në mënyrë të detajuar aspektet mjeko-ligjore të asfiksionë mekanike, duke analizuar mekanizmat fiziologjikë të vdekjes, shenjat diagnostike, si dhe rolin e ekspertizës mjeko-ligjore në hetimin e këtyre rasteve.

Prezantimi u vlerësua si një kontribut i rëndësishëm në literaturën akademike të mjekësisë ligjore, si dhe në formimin profesional të studentëve dhe specialistëve të fushës.

Roli i bibliografive online në promovimin e botimeve dhe kërkimit shkencor



Në Panairin e 5-të mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor (22-24 prill 2026, Tiranë), Qendra për Koordinimin dhe Përhapjen e Informacionit Shkencor (QKPISH) njësi pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, organizoi dhe drejtoi një panel të dedikuar një prej temave më aktuale në fushën e botimeve shkencore.

Paneli u moderua nga Mirlona Buzo, drejtuese e QKPISH, e cila gjithashtu mbajti kumtesën: “QKPISH dhe roli i saj në zhvillimin dhe koordinimin e bibliografive online” Në këtë panel kontribuan gjithashtu: Teuta Sula – Drejtore e Bibliotekës së Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës: “Bibliografite online në mbështetje të stafit akademik dhe studentëve”, Renata Bardhi – Drejtore e Bibliotekës Shkencore, Universiteti Bujqësor i Tiranës, “Bibliografia online kushtuar akad. Mentor Përmetit”, Teuta Dhima – Specialiste në Departamentin e Albanologjisë, Biblioteka Publike Durrës, “Bibliografite tematike online si mbështetje për studimet albanologjike: rasti i bibliografisë së Skënderbeut”.

Diskutimet nxorën në pah rolin thelbësor të bibliografive online në evidentimin dhe promovimin e botimeve shkencore, në rritjen e dukshmërisë së kërkuesve dhe në lehtësimin e aksesit në informacion për komunitetin akademik.

Në kumtesën e saj, Msc. Mirlona Buzo theksoi rolin koordinues të QKPISH në ndërtimin dhe zhvillimin e bibliografive online në nivel kombëtar, si një infrastrukturë e rëndësishme për organizimin dhe shpërndarjen e informacionit shkencor.

Msc. Teuta Sula solli në vëmendje përdorimin konkret të këtyre bibliografive në mbështetje të stafit akademik dhe studentëve në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë,

duke evidentuar ndikimin e tyre në procesin mësimor dhe kërkimor.

Msc. Renata Bardhi prezantoi një rast të veçantë përmes bibliografisë online kushtuar akad. Mentor Përmetit, duke dëshmuar rëndësinë e këtyre platformave në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë shkencore.

Ndërsa Msc. Teuta Dhima u ndal te bibliografitë tematike online, duke sjellë shembullin e bibliografisë së Skënderbeut si një mjet i vlefshëm për studimet albanologjike dhe për thellimin e kërkimit shkencor në fusha të specializuara.

Pjesëmarrja e QKPISH në këtë panair thekson angazhimin e vazhdueshëm për zhvillimin e infrastrukturës së informacionit shkencor dhe për forcimin e bashkëpunimit ndër-institucional në nivel mbarëkombëtar.

Falënderojmë të gjithë kontribuesit për prezantimet dhe shkëmbimin e vlefshëm të përvojave.

Qendra e Studimit të Arteve promovoi botimet e saj në Panairin e V mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor



Në mbyllje të Panairit të V mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor, Qendra e Studimit të Arteve u prezantua me një program të pasur që solli në vëmendje katër botime të rëndësishme për artin dhe muzikologjinë shqiptare: “Vjetari artistik shqiptar”; 100 vjet teatër në Shkodër” e autorit Andrea Skanjeti; “Historia e artit shqiptar: nga prehistoria te shek. XX” e autorit Ermir Hoxha; “Zërat e parë të isopolifonisë shqiptare (E. Dones, O. Vorpsi, A. Ibrahim)” e autorit Fabio Rocchi dhe “Studimi për muzikologjinë psikoanalitike” i Qamil Gjyrëzit.

“Vjetari artistik shqiptar”, i moderuar nga Anxhela Cikopano, u paraqit si një botim unik që dokumenton ngjarjet kryesore të artit pamor, muzikës, teatrit dhe kinemasë në vend, duke krijuar një panoramë të plotë të zhvillimeve kulturore. Vepra e përgatitur nga punonjësit shkencorë të QSA-së shërben si një arkiv për historinë dhe kulturën e artistëve shqiptarë, duke përfshirë edhe ata në diasporë. Ky botim ndahet në disa kategori si fotografi, pikturë, skulpturë, kinema, opera dhe balet.

Anxhela Cikopano prezantoi edhe veprën “100 vjet teatër në Shkodër” të autorit Andrea Skanjeti. Ky botim sjell një panoramë historike të zhvillimit të teatrit në qytetin e Shkodrës, duke ndriçuar figurat, ngjarjet dhe institucionet që kanë formësuar traditën teatrore në një shekull të tërë. Vepra u vlerësua si një kontribut i çmuar për dokumentimin e historisë së teatrit shqiptar dhe rolin e Shkodrës si një qendër e rëndësishme kulturore.

Ndërkohë, studiuesi Ermir Hoxha solli veprën e tij “Historia e artit shqiptar: nga

prehistoria te shek. XX", të moderuar nga Agron Mesi, një studim i plotë mbi 150 vite të artit pamor shqiptar, i ndarë në pesë periudha historike, rezultat i një pune kërkimore 10-vjeçare. Libri përshkruan kontekstin politik, ekonomik dhe kulturor të kohës, duke trajtuar pikturën, skulpturën, fotografinë dhe artet e aplikuara, që nga fotografia e parë e Pjetër Marubit në vitin 1858 deri në fundin e shekullit XX. Ai u vlerësua për mënyrën sesi unifikon dhe periodizon trashëgiminë kulturore të arteve pamore, duke dhënë për herë të parë një kontekst të plotë për shumë periudha dhe artistë, të vendosur në një rrëfim historik të integruar.

Interes të veçantë ngjalli edhe monografia e Fabio Rocchit "Zërat e parë të italoфонisë shqiptare", ku autorët Elvira Dones, Ornella Vorpsi dhe Anilda Ibrahimimi vendosen në qendër të analizës si zëra të parë që formësuan këtë drejtim letrar. Sipas studimit, gjatë viteve të para pas rënies së regjimit të Enver Hoxhës, këto autore sollën rrëfime të fuqishme dhe shpesh të dhimbshme, që pasqyrojnë realitetin e tranzicionit dhe përvojën e migrimit. Libri analizon veprat e tyre përmes një qasjeje të drejtpërdrejtë me tekstin, duke ndriçuar një moment kyç të zhvillimit të letërsisë shqipe përtej kufijve gjuhësorë dhe kulturorë.

Në fund, Qamil Gjyrezi solli librin "Studimi për muzikologjinë psikoanalitike", të moderuar nga Kreshnik Duqi, një qasje e re që ndërthur psikoanalizën me muzikologjinë, duke hapur horizonte të reja për studimet mbi muzikën dhe ndikimin e saj në psikikën njerëzore. Gjyrezi jep një kontribut shkencor dhe artistik për lidhjen ndërmjet psikoanalizës tradicionale dhe psikoanalizës së muzikës. Terapia muzikore, semiotika, muzikologjia kognitive dhe psikoanaliza e muzikës janë nëndisiplina shkencore që ndihmojnë studimin e muzikës dhe interpretimin e saj në planin psikologjik, filozofik, social, ekologjik dhe shkencor.

Komisionet dhe institutet

Workshop ndërkombëtar në Tiranë mbi trajtimet biofizike në bujqësi dhe akuakulturë



Më 16 prill 2026, në Tiranë, u zhvillua workshop-i ndërkombëtar me temën: “Efekti i trajtimeve biofizike në performancën e rritjes së materialit biologjik te bimët dhe kafshët”. Veprimtaria u organizua nga Komisioni i Biologjisë, Bujqësisë dhe Veterinarisë pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë në bashkëpunim me: Akademinë e Shkencave Bujqësore dhe Pyjore Gheorghe Ionescu-Şişeşti”; Qendrën e Kërkim-Zhvillimit për Peshkimin Nucet; Institutin e Kërkim-Zhvillimit për Ekologji Ujore, Peshkim dhe Akuakulturë Galaţi (ICDEAPA Galaţi); Departamentin e Bioteknologjisë në Fakultetin e Shkencave të Natyrës të Universitetit të Tiranës, si dhe partnerë nga Rumania dhe sektori privat.

Koordinimi i aktivitetit u realizua nga prof. dr. Ariola Bacu, anëtare e Komisionit të përhershëm të Biologjisë, Bujqësisë dhe Veterinarisë dhe përgjegjëse e Grupit të Bioteknologjisë Molekulare në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës, si dhe nga z. Radu Mihailov, president i Bio Top Romania Agriculture Cooperative.

Workshop-i u vlerësua si një hap i rëndësishëm drejt ndërtimit të një kuadri rajonal të strukturuar për kërkime të aplikuara biofizike në bujqësi dhe akuakulturë, duke synuar kalimin nga bashkëpunime eksploruese drejt partneriteteve strategjike dhe të qëndrueshme.

Sekretarja Shkencore e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Anila Hodo, përshëndeti të pranishmit dhe e vlerësoi workshop-in si një moment të rëndësishëm për forcimin e bashkëpunimit shkencor ndërkombëtar dhe për thellimin e dialogut akademik ndërmjet institucioneve kërkimore dhe universitare.

Ajo theksoi se është një kënaqësi e veçantë për ASHSH-në të mirëpritën në Tiranë kolegë nga Akademia e Shkencave Bujqësore dhe Pyjore e Rumanisë, si dhe përfaqësues nga universitete, qendra kërkimore dhe sektori privat, duke vënë në dukje se prania e tyre dëshmon rëndësinë në rritje të bashkëpunimit shkencor ndërkombëtar dhe shkëmbimit të njohurive ndërmjet vendeve dhe disiplinave të ndryshme.

Nga pala rumune, znj. Costache Mioara vlerësoi rëndësinë e vazhdimësisë së bashkëpunimit ndërinstucional dhe zhvillimit të partneriteteve afatgjata në funksion të kërkimit dhe inovacionit, ndërsa z. Radu Mihailov foli për rolin e kërkimit të aplikuar në adresimin e sfidave globale, si ndryshimet klimatike dhe siguria ushqimore. Ai u shpreh se ishte një nder të merrte pjesë në këtë ngjarje që bashkon përpjekjet ndërkombëtare për zhvillimin e bujqësisë dhe akuakulturës, duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit instucional dhe të kërkimit të aplikuar në përballimin e sfidave globale, si ndryshimet klimatike, rritja e kërkesës për ushqim dhe nevoja për sisteme prodhimi më të qëndrueshme.

Gjatë sesioneve u trajtuan çështje që lidhen me legjislacionin europian dhe kombëtar, prioritetet e kërkimit shkencor dhe aplikimet konkrete të metodave biofizike në bujqësi dhe akuakulturë.

Znj. Valdete Buca, përfaqësuese e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, dhe z. Radu Mihailov drejtuan sesionin e parë për legjislacionin europian dhe atë vendor, lidhur me mundësitë e kërkimit shkencor të aplikuar në bujqësi. Gjatë prezantimeve u trajtuan kuadri ligjor dhe mundësitë për zhvillimin e kërkimit të aplikuar në sektorin bujqësor.

Në sesionin e dytë me temën “Efekti i trajtimeve biofizike mbi performancën e rritjes së materialit biologjik bimor”, që u moderua nga prof. dr. Ariola Bacu dhe dr. Roxana Ciceoi u mbajtën shtatë prezantime shkencore. Punimet shkencore u përqendruan në aplikimin e teknikave biofizike për përmirësimin e rritjes dhe zhvillimit të bimëve.

Sesioni i tretë me temën “Efekti i trajtimeve biofizike mbi performancën e rritjes së materialit biologjik shtazor” u moderua nga akad. Anila Hodo dhe z. Ion Jiha. Prezantimet e këtij sesioni sollën rezultate dhe diskutime mbi ndikimin e trajtimeve biofizike në shëndetin dhe performancën e organizmave shtazorë.

U prezantuan rezultate kërkimore mbi përdorimin e bio-rezonancës, priming-ut të farave, diagnostikës molekulare dhe teknikave të tjera inovative, me fokus në rritjen e rendimentit, përmirësimin e shëndetit të bimëve dhe kafshëve, si dhe në përballimin e stresit biotik dhe abiotik.

Workshop-i shërbeu si një platformë konkrete për thellimin e bashkëpunimit ndërkufitar

Shqipëri-Rumani, duke synuar harmonizimin e metodologjive, zhvillimin e projekteve pilot, publikime të përbashkëta shkencore dhe identifikimin e mundësive të financimit në kuadër të programeve evropiane. Ambicia e përbashkët e partnerëve mbetet krijimi i një qendre rajonale reference për teknologjitë biofizike të aplikuara në sistemet bimore dhe shtazore, të bazuara në evidencë shkencore dhe të zbatueshme në nivel evropian.

Instítuti Kombëtar i Fizikës zhvilloi për katër ditë rresht veprimtarinë “Shkolla e Pranverës Ballkanike: Aplikime të Shkencës së të Dhënave në Fizikë”



Për katër ditë me radhë, nga 22 deri më 25 prill 2026, Instituti Kombëtar i Fizikës pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, në bashkëpunim me Departamentin e Fizikës të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës, organizoi veprimtarinë ndërkombëtare “Shkolla e Pranverës Ballkanike: Aplikime të Shkencës së të Dhënave në Fizikë”. Aktiviteti u mbështet nga Politekniku i Barit, INFN Bari, Universiteti i Prishtinës dhe ECAP-FAU, Gjermani, duke bashkuar lektorë dhe studentë nga rajoni dhe Europa. Ceremonia e hapjes u përshëndet nga akad. Mimoza Hafizi, drejtoreshë ekzekutive e IKF-së, dhe prof. asoc. dr. Gerti Xhixha, përgjegjës i Departamentit të Fizikës në FSHN. Seancat plenare sollën tema të aktualitetit, si pasiguria e matjes dhe gjurmueshmëria në fizikën e drejtuar nga të dhënat (prof. dr. Sefer Avdiaj), analiza e të dhënave në fizikën e grimcave (dr. Mirald Tuzi) dhe roli i inteligjencës artificiale në trajtimin e kancerit me radioterapi (MSc. Xhulia Dosti).

Ditët në vijim u shënjuan nga ligjërata dhe sesione praktike mbi fizikën e grimcave dhe bozonin Higgs (prof. Nicola De Filippis), vlerësimin e efikasitetit me dhoma RPC (prof.

asoc. dr. Klaudio Peqini dhe PhD Ilirjan Margjeka), fizikën e astrogrimeve dhe analizën e të dhënave të rrezeve gama (prof. Elisabetta Bissaldi dhe dr. Riccardo Di Tria), si dhe aplikimet e machine learning në shkencë (prof. Nicola De Filippis). Veprimtaria u mbyll me leksionin e PhD Alba Domi mbi fizikën fundamentale të drejtuar nga të dhënat dhe konkluzionet statistikore me teleskopët e neutrinove.

Shkolla e Pranverës Ballkanike u përmbyll me shpërndarjen e çertifikatave për pjesëmarrësit, duke shënuar katër ditë intensive me tema bashkëkohore që ndërthurën fizikën me shkencën e të dhënave dhe inteligjencën artificiale. Ky aktivitet u vlerësua si një kontribut i rëndësishëm për zhvillimin e kërkimit shkencor dhe për përgatitjen e brezit të ri të studiuesve në rajon.

U mbajt tryezë shkencore për anglicizmat e pastabilizuar në gjuhën shqipe



Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, zhvilloi tryezën shkencore me temën “Anglicizmat e pastabilizuar në gjuhën shqipe: çështje të drejtshkrimit dhe të integritimit në “Fjalorin e madh të gjuhës shqipe”.

Veprimtaria u drejtua nga akad. Valter Memisha, prof. dr. Anila Omari dhe prof. dr. Anila Kananaj. Në fjalën e hapjes, akad. Valter Memisha theksoi disa çështje kryesore që lidhen me trajtimin e anglicizmave në fjalor, duke përfshirë huazimet e stabilizuara, çerdhet fjalëformuese, shkurtesat dhe huazimet e paasimiluara, si dhe nevojën për standardizim të mëtejshëm leksikografik të tyre. Ai u shpreh se “Fjalori i madh i gjuhës shqipe” (FMGJSH) është një strukturë e hapur për pasurim dhe rishikim të vazhdueshëm. Kryetari i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, akad. Gëzim Hoxha, në fjalën e tij përshëndetëse vlerësoi rëndësinë e këtij takimi, duke theksuar sfidat që sjell ndikimi i anglishtes në shqipen bashkëkohore dhe nevojën për normëzim dhe përshtatje të huazimeve të reja.

Ai nënvizoi se gjuha shqipe, në kushtet e globalizimit dhe të ndikimit të anglishtes si gjuhë ndërkombëtare, përballet me nevojën për përthithje, përshtatje dhe normëzim të huazimeve të reja, duke ruajtur njëkohësisht identitetin e saj strukturor dhe kulturor.

Sipas tij, tryeza përbën një forum të rëndësishëm shkencor për debat dhe reflektim, i cili do të kontribuojë në orientimin e praktikave leksikografike dhe drejtshkrimore në të ardhmen.

Prof. dr. Anila Kananaj paraqiti fjalorthin me përzgjedhjen e 215 anglicizmave të rinj që u bënë objekt diskutimi në lidhje me drejtshkrimin dhe integrimin e tyre në “Fjalorin e madh të gjuhës shqipe” (2026), duke nxjerrë në pah problematikat që ato paraqesin.

Akad. emeritus Gjovalin Shkurtaj u shpreh se studimi i anglicizmave për t’u përfshirë në FMGJSH duhet bërë fjalë për fjalë dhe duhet marrë vendim për secilën fjalë, nëse duhet përfshirë apo përjashtuar. Gjithashtu, akad. Emil Lafe dhe prof. dr. Memushaj vunë theksin te kujdesi për përdorimin e anglicizmave, duke i pranuar vetëm në rastet kur shënojnë një koncept të ri dhe nuk kanë ekuivalent në shqip.

Në vijim të aktivitetit u paraqitën referime nga studiues të njohur si prof. dr. Rami Memushaj, prof. dr. Aristotel Spiro, prof. dr. Rrahman Paçarizi dhe prof. asoc. Adelina Çerpja, të cilët trajtuan vendin e anglicizmave në fjalor, parimet drejtshkrimore, zhvillimet historike të shkrimit të tyre dhe procesin e kalimit nga përdorimi i lirë në normë.

Pas diskutimeve me të pranishmit, në përfundim u theksua se “Fjalori i madh i gjuhës shqipe” mbetet një projekt i hapur për pasurim dhe rishikim të vazhdueshëm, në përputhje me zhvillimet bashkëkohore të gjuhës.

Leksion shkencor mbi veprimtarinë dhe kontributin e akademikut Zeqirja Ballata



Në kuadër të veprimtarive shkencore dhe artistike, Komisioni i Përhershëm i Arteve pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë organizoi një leksion shkencor kushtuar veprimtarisë dhe kontributit të akademikut Zeqirja Ballata, nën moderimin e dr. Denis Bizhgës.

Zëvendësdekanja e Fakultetit të Muzikës në Universitetin e Arteve, prof. asoc. Silvana Skënderi në fjalën e hapjes të veprimtarisë shprehu kënaqësinë dhe mirënjohjen për organizatorët e leksionit akademik kushtuar një figure të shquar të muzikës dhe mendimit muzikologjik shqiptar. Ajo vlerësoi veçanërisht Akademinë e Shkencave të Shqipërisë për mbështetjen dhe për krijimin e vazhdueshëm të hapësirave për diskutime dhe veprimtari shkencore në fushën e arteve.

Në kuadër të Lectio Magistralis kushtuar akademikut Zeqirja Ballata, kompozitori Jetmir Zaganjori theksoi se qëllimi i kumtesës ishte trajtimi analitik i jetës, veprës dhe kontributit të tij në muzikologjinë dhe krijimtarinë muzikore shqiptare. Ai e cilësoi Ballatën si një figurë qendrore të mendimit muzikor në Kosovë, i cili ka ndërthurur rolin e kompozitorit me atë të muzikologut, duke ndërtuar ura lidhëse ndërmjet traditës muzikore dhe zhvillimeve bashkëkohore evropiane.

Zaganjori nënvizoi gjithashtu rëndësinë e kontekstit historik dhe kulturor të Kosovës në formësimin e kësaj figure, duke e paraqitur zhvillimin e jetës muzikore si një proces kompleks, të ndikuar nga rrethana politike dhe shoqërore. Ai theksoi kalimin nga tradita gojore dhe folklorike drejt institucionalizimit të jetës muzikore pas Luftës së Dytë Botërore, proces që ka ndikuar drejtpërdrejt në formimin e brezit të kompozitorëve, ku bën pjesë edhe Zeqirja Ballata.

Më tej, u vu në dukje evoluimi i muzikës në Kosovë nga praktikat tradicionale drejt strukturave institucionale dhe ndikimeve të muzikës bashkëkohore evropiane, duke krijuar një terren të ri për zhvillimin e gjuhës muzikore dhe të krijimtarisë artistike.

Në aktivitet mori pjesë edhe familjari i akademikut, z. Ragip Ballata, i cili përcolli përshëndetjet e familjes dhe theksoi rëndësinë e këtij aktiviteti për vlerësimin e figurës dhe trashëgimisë së tij. Ai shprehu mirënjohje ndaj Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Komisionit të Arteve, instrumentistëve dhe të pranishmëve, si dhe përshëndeti pjesëmarrjen e Ambasadorit të Kosovës në Shqipëri. Ai u shpreh më tej se ndihej i nderuar që ishte pjesë e këtij aktiviteti kushtuar një figure dhe një trashëgimie të rëndësishme për muzikën dhe kulturën shqiptare, duke uruar suksese në vijimin e punës shkencore dhe artistike.

Aktiviteti u mbyll me interpretime muzikore: Silvana Skënderi interpretoi në piano veprën “Jehonë nga Bjeshkët e Nemuna”, ndërsa, në një interpretim të përbashkët në piano dhe fizarmonikë nga Silvana Skënderi dhe Elton Balla, u soll vepra “Canticum Scodrense”, duke i dhënë aktivitetit një mbyllje artistike të denjë, në harmoni me frymën e leksionit shkencor kushtuar figurës së akademikut Zeqirja Ballata.


U mbajt konferenca shkencore për Komitetin “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”



Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, si institucioni më i lartë shkencor dhe artistik në vend, në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, organizoi konferencën shkencore me temë: “Hoxha Kadri Prishtina dhe roli i Komitetit ‘Mbrojtja Kombëtare e Kosovës’”.

Në këtë konferencë morën pjesë edhe përfaqësues nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, ndër të cilët akad. Marenglen Verli, anëtar i Këshillit Organizues, së bashku me akad. Beqir Meta. Nga Instituti i Historisë pranë ASHSH-së mori pjesë edhe prof. asoc. Dr. Sali Kadria.

U hap Shkolla e Pranverës Ballkanike: Aplikime të Shkencës së të Dhënave në Fizikë



Sot, më 22 prill 2026, u hap zyrtarisht “Data Science Applications in Physics” – Balkan Spring School (Aplikime të Shkencës së të Dhënave në Fizikë – Shkolla e Pranverës Ballkanike), një aktivitet i rëndësishëm akademik që bashkoi studentë dhe lektorë nga rajoni ballkanik dhe më gjerë.

Aktiviteti u organizua nga Instituti Kombëtar i Fizikës, pjesë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, dhe Departamenti i Fizikës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës, me mbështetjen e Politeknikut të Barit, INFN Bari, Universitetit të Prishtinës dhe ECAP-FAU, Gjermani.

Ceremonia e hapjes u përshëndet nga akad. Mimoza Hafizi, drejtoreshë ekzekutive e Institutit Kombëtar të Fizikës (IKF) pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, dhe prof. asoc. dr. Gerti Xhixha, përgjegjës i Departamentit të Fizikës në Fakultetin e Shkencave të Natyrës (FSHN).

Seanca plenare vijoi me punime shkencore mbi temat më aktuale të ndërthurjes së fizikës me shkencën e të dhënave, si: “Pasiguria e matjes dhe gjurmueshmëria në fizikën e drejtuar nga të dhënat”, nga prof. dr. Sefer Avdiaj (Universiteti i Prishtinës, Kosovë); “Analiza e të dhënave në Fizikën e Grimcave”, nga dr. Mirald Tuzi (Institut i Fizikës Korpuskulare, Valencia, Spanjë); si dhe prezantimi “Roli i fizikës, shkencës së të dhënave dhe inteligjencës artificiale në përmirësimin e trajtimit të kancerit me radioterapi”, nga

MSc. Xhulia Dosti (Spitali Royal Berkshire, Mbretëria e Bashkuar).

Në ditën e parë, punimet shkencore paraqitën zhvillime mbi ndërthurjen e fizikës me shkencën e të dhënave dhe inteligjencën artificiale, si një proces që hap horizonte të reja për kërkimin shkencor dhe aplikimet praktike.

Në vijim, deri më 24 prill 2026, Shkolla e Pranverës Ballkanike do të zhvillojë sesione të tjera me leksione dhe praktika në fushat e mësipërme, me fokus në analizën e të dhënave dhe praktikatat bashkëkohore.

Të tjera

Studentët e Kolegjit Profesional Gjerman të Teknologjisë vizituan Panairin e 5-të mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor



Sot, në ambientet e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, studentët e Kolegjit Profesional Gjerman të Teknologjisë vizituan Panairin e 5-të mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor.

Ky aktivitet u ofroi atyre mundësinë të njihen nga afër me botimet më të reja akademike dhe shkencore, si dhe të shohin rolin e librit në zhvillimin e dijes dhe kulturës.

Të shoqëruar nga rektori akad. Jorgaq Kaçani, në praninë e akad. Vasil Toles, zëvendëskryetar i Akademisë së Shkencave dhe organizator i panairit, studentët diskutuan për prurjet më të fundit shkencore në panairin e librit akademik.

Prania e tyre në panair është një dëshmi e rëndësisë që ka ndërthurja e arsimit profesional me botën akademike, duke nxitur kuriozitetin, formimin dhe frymën kërkimore tek brezi i ri.

Panairi V mbarëkombëtar i librit akademik dhe shkencor: Pasqyrimi në mediat shqiptare



Panairi V mbarëkombëtar i librit akademik dhe shkencor zuri një vend të rëndësishëm në mediat shqiptare dhe të rajonit, duke u pasqyruar gjerësisht në televizione, portale dhe gazeta. Raportimet theksuan rolin e këtij panairi si një pasqyrë e arritjeve më cilësore në fushën e kërkimit dhe universiteteve, si dhe përmasat e tij, ku u theksua fakti që panairi mblodhi rreth 40 institucione dhe organizoi mbi 100 promovime librash në tri ditë.

Gjithashtu, në qendër të lajmeve ishte figura e akademikëve dhe studiuesve shqiptarë. Mediat nënvizuan ndër të tjera bashkëpunimin mes Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, si dhe pjesëmarrjen e institucioneve nga Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi.

Kryesisht mediat televizive e paraqitën Panairin V mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor si një ngjarje me intensitet të lartë akademik, ku standat dhe seancat promovuese krijuan një atmosferë të gjallë. Zhvillimin e kësaj ngjarjeje në prag të Ditës Botërore të Librit dhe të së Drejtës së Autorit (23 prill), mediat e interpretuan si një simbolikë të fortë për vlerësimin e librit dhe autorit shqiptar.

Gjatë zhvillimit të panairit u vlerësua edhe inovacioni me inaugurimin e shtypshkronjës digjitale “Akademia”, si një hap për modernizimin e botimeve akademike. Mediat

përmendën mbështetjen e TIKa-s për këtë projekt, duke e parë si një investim në infrastrukturën e kërkimit shkencor.

Panairi ishte një mundësi e veçantë, jo vetëm për ekspozimin e botimeve të reja, por edhe për prezantimin e punës dhe arritjeve në tri veprat madhore të Akademisë së Shkencave: “Fjalori i madh i gjuhës shqipe”, “Enciklopedia Shqiptare” dhe “Historia e shqiptarëve”. Në linqet e mëposhtme paraqitet mënyra se si mediat e kanë reflektuar ngjarjen, temat që kanë veçuar dhe personalitetet akademike që kanë marrë vëmendjen e tyre:

Lajmi në RTSH:

<https://www.facebook.com/RTShqiptar/videos/1612085424250533>

Lajmi në TV Ora News:

<https://www.youtube.com/watch?si=KvCyfvkqUMGUk2rk...>

Lajmi në ATSH: <https://ata.gov.al/.../celet-panairi-i-librit.../>

Lajmi në Ora News për panairin: <https://www.oranews.tv/.../elet-panairi-i-librit-akademik...>

Lajmi në Fax News: <https://faxweb.al/celet-panairi-i-librit-akademik-ne.../>

Lajmi në MCN: <https://www.mcntv.al/.../3949b724-63e3-4f9c-b2ac...>

Lajmi në KultPlus: <https://www.kultplus.com/.../hapet-ne-tirane-panairi-i-5.../>

Lajmi në Anadolu: <https://www.aa.com.tr/.../shqip%C3%ABri-hapet.../147968>

Lajmi në gazetën Tema: <https://www.gazetatema.net/.../ngre-siparin-panairi-i...>

Lajmi në Portalb: <https://portalb.mk/panairi-mbarekombetar-i-librit.../>

Lajmi në CGTN: <https://albanian.cri.cn/2026/04/23/ARTI1776911831955199>

Lajmi në portalin Kallxo.com: <https://kallxo.com/.../panairi-i-librit-akademik.../>

Lajmi në gazeta SOT: <https://sot.com.al/.../panairi-i-5-te-i-librit-akademik.../>

Lajmi në portalin 24 Orë: <https://24-ore.com/botimet-shkencore-dhe-kerkimi-ne.../>

Lajmi për çmimin e Panairit V, ATSH: <https://ata.gov.al/.../rrapo-ormeni-fituesi-i-cmimit.../>

Lajmi për çmimin e Panairit V, TV MCN: <https://www.mcntv.al/.../c5db0bc0-112e-4896-a9ba...>

Lajmi për çmimin e Panairit V, gazeta TemA: <https://www.gazetatema.net/.../akademik-rrapo-ormeni-merr...>

Lajmi për çmimin e Panairit V, Fax. al: <https://fax.al/.../akademik-rrapo-ormeni-merr-cmimin...>

Nxënësit e shkollës së mesme “Sami Frashëri” vizitojnë NanoAlb



Nxënësit e shkollës së mesme “Sami Frashëri”, Tiranë, vizituan disa nga grupet e NanoAlb në Fakultetin e Shkencave të Natyrës.

Aktiviteti u zhvillua më 13 dhe 14 prill, ku nxënësit, të shoqëruar nga mësueset Nada dhe Anila, patën mundësinë të njihen nga afër me ambientet e NanoAlb.

Gjatë vizitave, ata u njohën me laboratorët e kërkimit shkencor në fushën e nanoteknologjisë, me aparaturat dhe infrastrukturën përkatëse, si dhe me mënyrën e përdorimit të tyre në kërkimin shkencor. Nxënësit u njohën gjithashtu me procedura të thjeshta demonstrimi dhe me rezultate konkrete të punës kërkimore, duke kuptuar më mirë rëndësinë praktike të saj.

Vizitat u zhvilluan në disa laboratorë të specializuar, ku nxënësit u pritën nga stafet akademike përkatëse: në laboratorin e Bioteknologjisë nga prof. asoc. dr. Arjola Bacu; në atë të Biologjisë Molekulare nga prof. asoc. dr. Merita Xhetani; në laboratorët e Toksikologjisë nga prof. dr. Artan Trebicka dhe prof. asoc. dr. Ledia Vasjari; në laboratorin e Mjedisit nga prof. dr. Sonila Duka; në laboratorin e Sensorëve Elektrokimikë nga prof. dr. Majlinda Vasjari; në laboratorin e Kimisë Fizike nga prof. dr. Kledi Xhaxhiu;

si dhe në laboratorin e Fizikës nga prof. asoc. Dr. Klaudio Peqini.

Gjatë takimeve u zhvilluan biseda interesante, duke promovuar kërkimin shkencor në fushat e shkencave natyrore dhe ato multidisiplinare, si nanoshkenca dhe nanoteknologjia.

U trajtuan gjithashtu çështje të rëndësishme, si orientimi i nxënësve drejt këtyre studimeve, roli i kërkimit shkencor në ndërtimin e karrierës profesionale, si dhe mundësitë që ofrojnë projektet kërkimore të financuara nga buxheti i shtetit, universitetet dhe fondet evropiane.

U mbajt ceremonia e dorëzimit të diplomës “Anëtar i jashtëm” për prof. dr. Burim Ametaj



Akademia e Shkencave e Shqipërisë ka organizuar një ceremoni nderimi për një nga studiuesit më të shquar në nivel ndërkombëtar në fushën e mjekësisë veterinarë dhe biologjisë sistematike, prof. dr. Burim Ametaj, me rastin e dorëzimit të diplomës së pranimit si anëtar i jashtëm.

Ceremonia u moderua nga sekretarja shkencore, akad. Anila Hoda, e cila në fjalën e saj të hapjes foli për kontributin e çmuar dhe përkushtimin e vazhdueshëm të prof. dr. Ametaj në fushat e kërkimit shkencor. Ajo e vlerësoi atë si një nga figurat më të spikatura dhe përfaqësuese të shkencës shqiptare në arenën ndërkombëtare, me arritje të rëndësishme në bioteknologjinë bujqësore, mjekësinë veterinarë, metabolomikë dhe kërkimin translacional.



Akad. Hoda vuri në dukje se prof. dr. Ametaj mban titullin profesor në Universitetin e Albertës, një nga institucionet më prestigjioze në fushën e shkencave bujqësore, ushqimore dhe veterinare. Ai zotëron dy doktoratura, përkatësisht në fiziologjinë e të ushqyerit dhe në imunobiologji. Me mbi 120 artikuj të botuar në revista me faktor të lartë impakti, mbi 8 mijë citime dhe një h-indeks 49, ai renditet ndër studiuesit shqiptar më të cituar në botë në fushat e shkencave bujqësore dhe veterinare.

Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Skënder Gjinushi, e cilësoi këtë ceremoni si një moment të rëndësishëm për institucionin, duke theksuar se zgjedhja e prof. dr. Ametajt si anëtar i jashtëm është një nder për ASHSH-në. Ai vuri në dukje rëndësinë e kontributit të shkencëtarëve shqiptarë që punojnë jashtë vendit dhe theksoi se një nga angazhimet e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, të institucioneve të arsimit të lartë dhe të politikës shqiptare është ulja e ritmit të ikjes së trurit dhe nxitja e rikthimit të tyre nëpërmjet përfshirjes më shumë në projekte të përbashkëta.

Akad. Gjinushi vlerësoi angazhimin e prof. dr. Ametaj për të kontribuar në

zhvillimin e kërkimit shkencor në Shqipëri, përfshirë pjesëmarrjen e tij në projekte evropiane. Ai u shpreh se tashmë jemi në fazën kur synojmë të arrijmë standardet evropiane, ku një nga drejtimet kryesore është reformimi real i sistemit të kërkimit shkencor dhe pasurimi i tij me institucione prestigjioze, siç mund të ishte një institut apo qendër për shkencat e jetës, ide kjo e mbështetur edhe nga prof. dr. Ahmetaj.

Kryetari i ASHSH-së i dorëzoi profesorit diplomën për zgjedhjen si anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave.



Në mbyllje të ceremonisë, prof. dr. Burim Ametaj falënderoi Akademinë e Shkencave për vlerësimin dhe shprehu gatishmërinë e tij për të kontribuar në zhvillimin e vendit, pavarësisht angazhimeve të tij jashtë Shqipërisë. Ai theksoi rëndësinë e krijimit të kushteve të përshtatshme për avancimin e kërkimit shkencor dhe afrimin me standardet evropiane. Gjithashtu, prof. dr. Ametaj mbajti ligjëratën me temë: "Jetojmë në një epokë ndryshimesh paradigmesh: Reduksionizmi kundrejt Biologjisë së Sistemeve", një kontribut shkencor mbi kufijtë e reduksionizmit dhe rolin e biologjisë së sistemeve si

paradigma e re e shkencës bashkëkohore biologjike.

Ceremonia përbën një hap tjetër në vlerësimin e figurave të shquara të shkencës shqiptare dhe në forcimin e lidhjeve me komunitetin shkencor shqiptar neper bote.

Akademia e Shkencave mbështet protestat e studentëve shqiptarë në Maqedoninë e Veriut që kërkojnë respektimin e të drejtës së tyre themelore: arsimimin në gjuhën amtare



Akademia e Shkencave shpreh solidaritetin e saj me studentët shqiptarë të fakulteteve të Drejtësisë, në tre universitetet e Maqedonisë së Veriut, ai i Tetovës, i Europës Jug-lindore dhe universiteti i “Nënë Terezës” në Shkup.

Ditët e fundit studentët shqiptarë në Maqedoninë e Veriut kanë zhvilluar një seri protestash në ambientet e universitetit, si edhe në hapësirat publike të qytetit të Shkupit, të mbledhur në mënyrë paqësore për të shprehur kërkesat e tyre. Përmes këtyre tubimeve, ata kërkojnë respektimin e të drejtës së tyre themelore për arsimim në gjuhën amtare, në të gjitha nivelet, si dhe përfaqësim të drejtë dhe përmirësim të kushteve të studimit.

Këto zhvillime nxjerrin në pah një çështje thelbësore për popullsinë shqiptare në Maqedoninë e Veriut: garantimin e barazisë dhe të të drejtave kushtetuese e të standardeve europiane në përdorimin e gjuhës shqipe.

Në këtë përpjekje të drejtë dhe legjitime, Akademia e Shkencave e Shqipërisë shpreh mbështetjen e saj për studentët shqiptarë, duke theksuar rëndësinë e ruajtjes dhe zhvillimit të identitetit përmes arsimit në gjuhën shqipe e përdorimit legjitim e pa pengesa të saj.

Banda "Vatra" në kontekstin e marrëdhënieve shqiptaro-amerikane dhe ndërtimit të identitetit kombëtar shqiptar



Në prill të vitit 1920, banda kombëtare "Vatra" mbërriti në Shqipëri për të marrë pjesë në zhvillimet vendimtare të kohës, në mbështetje të përpjekjeve për çlirimin e vendit, së bashku me "Trupin vullnetar" të drejtuar nga Aqif Pashë Përmeti (1884–1945). Para angazhimit të saj në Luftën e Vlorës, kjo bandë zhvilloi një sërë koncertesh në qytetet kryesore të Shqipërisë, si Korça, Elbasani, Shkodra, Gjirokastra, Tepelena, Përmeti, Berati, Durrësi dhe Tirana, gjatë muajve prill–maj 1920.

Këto veprimtari artistike përçuan një frymë të lartë optimizmi dhe gjallërie, duke ndikuar ndjeshëm si në moralin e popullsisë, ashtu edhe në vetë anëtarët e bandës. Mbështetja e federatës "Vatra" për çështjen kombëtare u shpreh jo vetëm në këtë aspekt kulturor, por edhe përmes ndihmës së vazhdueshme financiare.

Pjesëmarrja e bandës në Luftën e Vlorës nuk u kufizua vetëm në kontributin simbolik: përmes muzikës së saj, ajo u shndërrua në një instrument të fuqishëm mobilizimi dhe frymëzimi. Siç dëshmohet nga burimet e kohës, pjesëtarët e saj shkonin disa herë në ditë në front për të interpretuar për luftëtarët shqiptarë, duke mbajtur lart moralin e tyre.

Dokumentacioni fotografik dhe burime të tjera historike konfirmojnë praninë e bandës "Vatra" në Vlorë në ditën e çlirimit, së bashku me rreth 250 vullnetarë nga qarku i Korçës, ndër të cilët edhe 120 të ardhur nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Shtypi i kohës evidenton rolin e rëndësishëm të kësaj bande në zhvillimet e luftës. "Gazet' e Korçës", në numrin e datës 4 shtator 1920, përshkruan ndikimin e saj në betejën e Drashovicës, ku përmes marshimeve patriotike u rrit ndjeshëm fryma luftarake e

forcave shqiptare. Në çastet kulmore të fitores, ngritja simbolike e flamurit u shoqërua me tingujt e himnit kombëtar, interpretuar nga banda “Vatra” dhe banda “Afërdita” e Elbasanit, duke i dhënë ngjarjes një dimension të veçantë ceremonial dhe kombëtar.

Veprimtaria e bandës “Vatra” në Vlorë shënoi fillimin e një rrugëtimi të gjatë në historinë kulturore shqiptare. Përmes krijimtarisë së Thoma Nasit dhe veçanërisht kompozimit të këngës-himn “Vlora-Vlora”, me tekst të Ali Asllanit, kjo bandë kontribuoi në formësimin e identitetit simbolik të Luftës së Vlorës si një luftë kombëtare e mirëorganizuar. Anëtarët e saj nuk ishin thjesht muzikantë, por përfaqësues të një misioni të qartë kulturor dhe atdhetar, në përputhje me idealet e kohës për një Shqipëri të lirë dhe të zhvilluar.


Në vitet 1920, falë veprimtarisë së Thoma Nasit dhe bandës “Vatra”, roli i muzikës dhe artit në shoqërinë shqiptare njohu një zhvillim të ri. Një ndër arritjet më të rëndësishme ishte krijimi i orkestrës së parë simfonike në Shqipëri, me qendër në Korçë, koncerti premierë i së cilës u zhvillua në prill të vitit 1924. Ky hap u parapri nga një vizion i qartë teorik dhe organizativ, i shprehur nga Nasi në artikullin “Përmi organizimin e një orkestre simfonike” (1923), duke dëshmuar kapacitetet artistike dhe institucionale të vendit.

Banda “Vatra” ishte gjithashtu pjesë aktive në ngjarje të rëndësishme shqiptaro-amerikane. Në prill 1922, ajo mori pjesë në ceremoninë inauguruese të Shkollës Teknike Amerikane në Tiranë (Shkolla e Fultzit), si dhe në ceremonitë e vendosjes së marrëdhënieve diplomatike midis Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Në vitin 1925, banda u transferua në Tiranë dhe u shpall “Bandë Presidenciale” e shtetit shqiptar, ndërsa në vitin 1928 mori statusin “Bandë Mbretërore”. Ndikimi i saj u shtri në të gjithë vendin, duke shërbyer si katalizator i zhvillimeve kulturore dhe artistike. Ajo kontribuoi në themelimin e jetës muzikore në qytetet shqiptare, në futjen e edukimit muzikor në sistemin arsimor dhe në nxitjen e botimeve muzikore në Shqipëri.

Në vitin 2021, Akademia e Shkencave e Shqipërisë botoi veprën “Banda kombëtare ‘Vatra’: një histori unike shqiptaro-amerikane” të akademikut Vasil S. Tole. Kjo vepër i kushtohet historisë së ardhjes së vullnetarëve shqiptaro-amerikanë në vitin 1920 dhe rolit të tyre në forcimin e ndjenjës kombëtare, në një periudhë vendimtare për konsolidimin e shtetit shqiptar, pas Kongresit të Lushnjës dhe gjatë përpjekjeve për mbrojtjen e sovranitetit territorial të vendit.

Themelimi i orkestrës së parë në Shqipëri



-Nga tradita bandistike te formacioni simfonik-

Më 6 prill 1924, në Korçë, u krijua orkestra e parë simfonike në Shqipëri. Ideatori dhe dirigjenti i saj ishte Thoma Nasi. Themelimi i saj përbën një moment kyç në historinë e zhvillimit të muzikës së kultivuar shqiptare dhe të proceseve të modernizimit kulturor të vendit. Ky zhvillim lidhet drejtpërdrejt me veprimtarinë e dirigjentit dhe kompozitorit Thoma Nasi (1892–1964), i cili e konceptoi krijimin e një formacioni simfonik si një instrument të rëndësishëm për orientimin kulturor perëndimor të shoqërisë shqiptare. Nisma e tij u konkretizua në kuadër të shoqërisë “Arteve të Bukura”.

Ardhja e Thoma Nasit në Shqipëri, në prill të vitit 1920, së bashku me trupën muzikore të Bandës Kombëtare “VATRA” nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, përfaqëson një ndër ndërhyrjet më të rëndësishme të diasporës shqiptare në zhvillimin e kulturës kombëtare në periudhën e pas Pavarësisë.

Deri në fillim të shekullit XX, praktikat muzikore në Shqipëri dominoheshin nga muzika popullore qytetare dhe nga formacionet e bandave frymore. Në këtë kontekst, muzika simfonike, si një formë e avancuar e organizimit të mendimit muzikor, mbetet kryesisht jashtë përvojës estetike të publikut të gjerë, si në aspektin e receptimit, ashtu edhe në atë të njohjes së repertorit dhe autorëve përfaqësues të saj.

Në planin ndërkombëtar, zhvillimi i orkestrave simfonike si institucione të pavarura është rezultat i një procesi të gjatë historik. Deri në mesin e shekullit XIX, orkestrat

funksiononin kryesisht si pjesë përbërëse e teatrove të operës. Themelimi i Orkestrës Filarmonike të Vjenës në vitin 1842 shënon një moment të rëndësishëm në autonomizimin institucional të orkestrave simfonike dhe në konsolidimin e tyre si struktura të pavarura artistike.

Paralelisht, shfaqja dhe përhapja e konceptit të “filarmonisë” në fillim të shekullit XIX reflekton një transformim të rëndësishëm në organizimin e jetës muzikore në Evropë. Termi, me origjinë nga greqishtja e vjetër (philos dhe harmonia), nënkupton një bashkësi individësh të bashkuar nga dashuria për harmoninë dhe muzikën. Themelimi i Shoqatës Filarmonike Mbretërore në Londër në vitin 1813 përbën një ndër shembujt më të hershëm të këtij modeli organizativ, i cili u përhap më pas gjerësisht në vendet evropiane.

Para institucionalizimit të orkestrave simfonike, kompozitorët përballeshin me vështirësi të shumta në realizimin e veprave të tyre. Burimet historike dëshmojnë se figura të shquara si Wolfgang Amadeus Mozart, Joseph Haydn dhe Ludwig van Beethoven janë detyruar të mbështeten në orkestrat ekzistuese të teatrove për të organizuar premierat e veprave të tyre. Kjo praktikë nxori në pah nevojën për krijimin e formacioneve të qëndrueshme dhe të specializuara, çka çoi gradualisht në lindjen e orkestrave simfonike si institucione të mirëfillta.

Përpjekja e Thoma Nasit për themelimin e një orkestre simfonike në Shqipëri vlerësohet si një hap i rëndësishëm drejt institucionalizimit të muzikës së kultivuar dhe integritit të kulturës shqiptare në rrjedhat evropiane të zhvillimit artistik.

Akademia e Shkencave dhe Kryesia e saj i urojnë akademikut Dhimitër Haxhimihali 85-vjetorin e lindjes: Gëzuar ditëlindjen!



Akademik Dhimitër Haxhimihali është një personalitet shkencor me veprimtari akademike dhe universitare të pandërprerë për rreth gjashtë dekada. Ai ka dhënë kontributin e tij në një fushë kërkimesh dhe ekspertize pa traditë të mëhershme në vend, si kimia industriale dhe ajo mjedisore.

Lindi më 21 prill 1941 në Vlorë. Arsimin e mesëm e kreu në gjimnazin “Qemal Stafa” në Tiranë (1957). Studimet e larta i ndoqi në Institutin Kimiko-Teknologjik “Mendelejev” të Moskës (1957 - dhjetor 1961), ndërsa u diplomua në Fakultetin e Shkencave të Natyrës të Universitetit të Tiranës (1962), në degën e kimisë industriale. Po atë vit u emërua pedagog në katedrën e teknologjisë kimike inorganike në Fakultetin e Shkencave të Natyrës. Në vitet 1990–2007 ka qenë përgjegjës i Seksionit të Teknologjisë Kimike. Ka kryer kualifikime e specializime pasuniversitare në disa qendra universitare e kërkimore në Kinë, Itali, Angli dhe Gjermani.

Akad. Dhimitër Haxhimihali ka dhënë ndihmesë në zhvillimin dhe përparimin e procesit mësimor në degën e kimisë industriale të Universitetit të Tiranës, si drejtues lëndësh, hartues planesh e programesh mësimore të nivelit universitar e pasuniversitar. Ka kryer dhe drejtuar një varg studimesh në fushën e pasurimit të lëndëve të para fosfatike të vendit, të përpunimit të tyre në plehra kimike, në fushën e ruajtjes dhe mbrojtjes së mjedisit, të prodhimit të pastër etj.; ka trajtuar gjithashtu çështje të terminologjisë së kimisë në gjuhën shqipe. Në këto fusha ka drejtuar projekte e grupe kërkimore, si dhe një numër disertantësh për fitimin e gradës “doktor i shkencave”. Ka marrë titullin shkencor “Profesor” më 1994.

Më 2003 u zgjodh anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe, në periudhën 2009–2014, ka drejtuar Seksionin e Shkencave Natyrore e Teknike në ASHSH. Është autor i një numri të konsiderueshëm artikujsh, kumtesash e referatesh shkencore brenda dhe jashtë vendit, si dhe i një vargu tekstesh universitare e monografish. Ka qenë hartues zërash në fushën e kimisë në “Fjalorin Enciklopedik Shqiptar” (botim i vitit 1985), si dhe autor zërash, anëtar i redaksisë së përgjithshme dhe përgjegjës i redaksisë së matematikës, fizikës, kimisë dhe informatikës për botimin e ri të tij (2001–2009).

Veprat kryesore: Teknologjia kimike inorganike, tekst universitar (1971, 1987, 2005); Fjalor i kimisë (1984, bashkautor); Teknologjia kimike dhe mjedisore, tekst universitar (2002, bashkautor); Histori e prodhimit kimik në Shqipëri (ASHSH, 2010); Kimia Industriale I, tekst universitar (2011); Konferenca kombëtare e kimisë: “Kimia dhe zhvillimi aktual i vendit”, libri i punimeve (editor), ASHSH, 2011; Trajtimi i ujërave të shkarkimeve industriale e urbane, tekst universitar (2014, bashkautor); Njehsime dhe probleme të kimisë industriale, tekst universitar (2015); Fjalor i termave bazë të kimisë: shqip–anglisht, anglisht–shqip (ASHSH, 2019, bashkautor dhe bashkëredaktor).

Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Kryesia e saj i urojnë akademik Ali Aliut: Gëzuar ditën e lindjes!



Ali Aliu është një nga figurat më të shquara të mendimit dhe studimeve letrare shqiptare, i njohur si akademik, shkrimtar, eseist, kritik letrar dhe përkthyes. Lindi më 1 prill 1934 në Prespë (Kranjë), duke u rritur në një mjedis që do të ndikonte në formimin e tij intelektual dhe kulturor.

Arsimin fillor tetëvjeçar e përfundoi në Manastir në vitin 1951, ndërsa Shkollën Normale

në Shkup në vitin 1955. Studimet universitare në degën e albanologjisë i kreu në Universitetin e Beogradit në vitin 1960, ndërsa doktoraturën e mbrojti në Universitetin e Prishtinës më 1973. Këto etapa arsimore shënuan themelet e një karriere të gjatë dhe të suksesshme në fushën e studimeve letrare.

Veprimtaria e tij profesionale nisi në gazetarinë kulturore, si pjesë e redaksisë së gazetës “Flaka e vëllaznimit” në Shkup, ku punoi për dhjetë vite. Më pas, nga viti 1969 deri më 1972, ishte redaktor në edicionin e botimeve “Rilindja” në Prishtinë. Që nga viti 1972 ai kontribuoi në arsimin e lartë si ligjërues në Fakultetin Filozofik dhe më pas në Fakultetin e Filologjisë të Prishtinës, ku ligjëroi lëndën Teori e letërsisë, duke formuar breza të tërë studentësh dhe studiuesish.

Në vitin 1996 u zgjodh anëtar korrespondent, ndërsa në vitin 2000 anëtar i rregullt i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Është anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave të Shqi-përisë dhe i Akademisë të Shkencave dhe të Arteve të Maqedonisë. Kontributi i tij në jetën akademike shqiptare është i jashtëzakonshëm, sidomos në studimin e letërsisë bashkëkohore shqiptare, fushë në të cilën ka botuar një numër të madh veprash dhe studimesh të rëndësishme. Ai gjithashtu ka udhëhequr shumë kandidatë në nivelet e magjistraturës dhe doktoraturës.

Ali Aliu ka qenë aktiv edhe në jetën politike dhe institucionale. Ai ishte një nga themeluesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës në vitin 1989 dhe anëtar i Kryesisë së saj për dy mandate, deri në vitin 1995. Në vitin 1991 drejtoi Zyrën e Kosovës në Tiranë, duke dhënë kontribut në përfaqësimin institucional të Kosovës në një periudhë të rëndësishme historike.

Krahas angazhimeve të tij akademike dhe publike, Ali Aliu ka ndërtuar një opus të pasur krijues dhe studimor. Ai është autor i dhjetëra veprave në fushën e kritikës letrare, teorisë së letërsisë, eseistikës dhe antologjive, ndër të cilat spikasin: “Kërkime”, “Shqyrtime”, “Rrjedhave të letërsisë”, “Ese letrare”, “Reflektse letrare”, “Teoria e letërsisë”, “Don Kishoti shqiptar”, “Miti ballkanik te Kadareja”, “Shtegtimi i metaforës”, “Kënaqësia e leximit” dhe shumë studime monografike për figura të rëndësishme të letërsisë shqiptare si Ismail Kadare, Dritëro Agolli, Fatos Arapi dhe Azem Shkreli.

Veprat e tij janë përkthyer dhe botuar edhe në gjuhë të tjera, si maqedonisht, bullgarisht dhe anglisht, duke e bërë kontributin e tij të njohur edhe në rrafshin ndërkombëtar.

Për kontributin e tij të shquar në kulturë, shkencë dhe letërsi, Ali Aliu është nderuar me një sërë çmimesh dhe vlerësimesh të rëndësishme, ndër të cilat “Nderi i Kombit”, akorduar nga Bujar Nishani, Medalja e Artë e Lidhjes së Prizrenit, “Penda e Artë” nga Ministria e Kulturës në Tiranë, çmimi shtetëror “11 Tetori” në Maqedoni, çmimi “Azem Shkreli” për vepër jetësore në Kosovë dhe shumë të tjera.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë i uron ditën e lindjes dirigjentit dhe muzikologut shqiptar Eno Koço



Eno Koço anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë lindi më 1 prill 1943 në Tiranë. Ishte i biri i muzikantëve Kristo Koço dhe Tefta Tashko. Familja e të atit, Sotiri dhe Evridhiqia ishin me prejardhje nga Boboshtica. Nga e ëma, gjyshi ishte Athanas Tashko (1863-1915) dhe daja Koço Tashko, të shpërngulur në Egjiptin e dinastisë së Mehmet Ali Pashës. I ati ishte bariton, ndërsa e ëma soprano lirike e mirënjohur ndërkombëtarisht, si dhe e nderuar me titullin Artiste e Popullit.

Në moshën 7-vjeçare nisi të studjojë violinë në Liceun Artistik të Tiranës, më vonë në Leningrad, përpara se të diplomohet në Institutin e Lartë të Arteve të Tiranës në vitin 1966. Pas përfundimit të studimeve për dirigjim në vitin 1977, një vit më vonë emërohet dirigjent i Orkestrës Simfonike të RTSH-së. Me këtë orkestër, përveç numrit të madh të koncerteve simfonike e vokale, bëri regjistrime të këtij repertori, të muzikës së filmave dhe këngëve të Festivaleve në Radiotelevizion, dhe zhvilloi turne në Kosovë (1979) dhe Turqi (1983).

Drejtoi Orkestrën Simfonike të Kairos në Egjipt (1996) dhe u atashua pranë Orkestrës RAI dhe Operas Regio të Torinos (1999). Mbrojti doktoratën me temën "Kënga Lirike Qytetare Shqiptare në vitet 1930".

Ai kontriboi edhe me botimet shqip dhe anglisht, si traktati "Orkestrimi", në bashkëpunim me Gjon Simonin (1977, 1984); librat "Tefta Tashko Koço dhe koha e saj" (2000) dhe "Kënga Lirike Qytetare Shqiptare në vitet 1930" (2002); artikuj periodikë për muzikën shqiptare dhe historinë e saj. Eno Koço ka botuar gjithashtu librin "Kënga

karakteristike Korçare” (Botimi I "Toena", 2003), që paraqet një pjesë të disertacionit të tij, librin "The Albanian Urban Lyric Song in the 1930s" (Scarecroë, Çikago).

Eno Koço u dekorua me titullin Artist i Merituar në vitin 1984. Pas stabilizimit të tij në Angli, paralelisht me orkestrat anglo-irlandeze, ai mban lidhje permanente me orkestrat dhe koret e Shqipërisë: dirigjon në Orkestrën Kombëtare të Tiranës, ka realizuar disa turne jashtë vendit dhe ka mbrojtur doktoraturën. Ai mban komunikime shkencore me universitetet e Europës, afirmon vlerat muzikore shqiptare, promovon muzikën e kompozitorëve britanikë në Tiranë, duke e afruar opinionin shqiptar me vlerat e larta të muzikës botërore.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Kryesia e saj i urojnë akademikut emeritus Gjovalin Shkurtaç: Gëzuar ditën e lindjes!



Akademia e Shkencave e Shqipërisë i përcjell urimet më të përzemërta për ditëlindjen akademikut emeritus Gjovalin Shkurtaç, studiues në fushën kërkimore të gjuhësisë. Ai shquhet për gjeografinë e pasur të kërkimeve e studimeve të tij gjuhësore që kanë objekt dialektologjinë, sociolinguistikën, etnografinë dhe ruajtjen e konsolidimin e gjuhës së njësuar letrare. Lindi në Bajzë të Malësisë së Madhe më 3 prill të vitit 1943.

Kreu shkollën e mesme në Shkodër në vitet 1958-1962. Studimet e larta i zhvilloi në Universitetin e Tiranës (1966) në degën e gjuhës shqipe e të letërsisë.

Në vitet 1967–1989 punoi në Institutin e Gjuhësisë e të Letërsisë, ku u mor kryesisht me dialektologji dhe ka dhënë mësim lëndën “Kultura e gjuhës në skenë dhe në ekran” në Akademinë e Arteve. Në vitet 1989-1990 ishte këshilltar i kulturës në Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Romë, si dhe përfaqësues i Shqipërisë në Organizatën Botërore të Bujqësisë (FAO) dhe Organizatës Botërore të Ushqimit (WFP).

Nga viti 1991 punoi pedagog në departamentin e gjuhës shqipe të Universitetit të Tiranës,

duke dhënë tri lëndë kryesore: Dialektologji, Sociolinguistikë dhe Onomastikë. Ka qenë përgjegjës i departamenti (2002-2007). Në vitet 2000-2002 ka qenë lektor i gjuhës shqipe në Universitetin e Kalabrisë. Në vitin 2011 është pranuar si akademik i asociuar në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë.

Fushat kryesore të veprimtarisë janë: dialektologjia, sociolinguistika e kultura e gjuhës, po edhe filologjia arbëreshe e gjuha e letërsisë artistike. Ka hartuar studime monografike për të folme të gegërishtes veriperëndimore (të qytetit të Lezhës, të Bregut të Matës; të Kastratit, të Hotit, të Kelmendit, të Rranxave të Mbishkodrës dhe për një numër të folmesh të arbëreshëve të Italisë).

Akad. emeritus Shkurtaj është bashkautor i "Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe" (ADGJSH), vepër madhore e gjuhësisë shqiptare, vëllimi I, Napoli (2007), vëllimi II, Napoli (2008) me bashkautor, dhe i tekstit "Dialektologjia" (1997) me bashkautor, me disa ribotime.

Është autor i librave "Ligjërimet arbëreshe": "Gjuha e bukës" dhe "Gjuha e zemrës"- Shqyrtime dialektologjike dhe sociolinguistike në ngulimet arbëreshe të Italisë (2006); "Dialektet e shqipes" - Tiparet e përbashkëta dhe dallimet dialektore, sipas hartave të ADGJSH-së (2012, 2016). Ai është autor kryesor i studimeve në fushën e sociolinguistikës shqiptare, hartues për herë të parë në Shqipëri i tekstit "Sociolinguistika" (1996, 1999), "Sociolinguistikë e shqipes, nga dialektologjia te etnografia e të folurit. "Etnografia e të folurit të shqipes" (2004), ndërsa në fushën e kulturës së gjuhës ka botuar librat: "Kultura e gjuhës në skenë dhe në ekran", "Kahe dhe dukuri të kulturës së gjuhës" (2003), "Kultura e gjuhës" (2006); "Shqipja e sotme" (Kulturë të shkruari dhe të foluri, baza të gramatikës së shqipes standarde) (2010).

Të tjera botime të akad. emeritus Gjovalin Shkurtaj janë: "Si të shkruajmë shqip" - Nga drejtshkrimi te shkrimet profesionale (2008, 2012, 2013); "Gjuha shqipe për të huajt dhe Shqiptarët jashtë Atdheut" (1996, 1999, 2001, 2014) dhe "Hyrje në metodikën e punës shkencore" (2004). Ai ka botuar gjithashtu librat "Onomastikë dhe etnolinguistikë" (2001) dhe "Onomastikë dhe etnolinguistikë", botim i dytë i rivështruar dhe i pasuruar (2015).

Ka shkruar shumë studime për gjuhën e letërsisë artistike dhe librat: "Ta duam dhe ta ruajmë gjuhën tonë të bukur" (1998). "Pesha e fjalës shqipe" - Studime të zgjedhura për gjuhën e letërsisë artistike (2009). Libri i tij më i ri është "Urgjenca gjuhësore" - Huazime të zëvendësueshme me fjalë shqipe - Fjalorth (2015) dhe ribotim i përmirësuar (2017); "Etnografi e të folurit të shqipes" (2018); "Ligjërimet arbëreshe" (2020). Ka botuar disa libra shkencorë për publikun e gjerë: "Shpirti i Arbërit rron" (1984); "Kadareja dhe fjala shqipe" (2004), me bashkautor; "Kundrime gjuhësore" (sociolinguistikë, etnografi e të folurit, kulturë gjuhe) (2007); "Anketimi dhe ekspeditat gjuhësore" (udhëzues metodik dhe pyetësor) (2007) me bashkautor.

Akademia e Shkencave dhe Kryesia e saj i urojnë akademikes Aurela Anastasi: Gëzuar ditën e lindjes!



Akademike Aurela Anastasi është anëtare e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, profesoreshë e të drejtës kushtetuese dhe aktiviste e shquar e shoqërisë civile. Lindi më 7 prill 1965 në Vlorë. Ajo ka dhënë kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e institucioneve dhe të së drejtës shqiptare, në raport me standardet më të përparuara të së drejtës ndërkombëtare.

Akad. Anastasi është autore e studimeve me karakter historik, duke aktualizuar dobishmërinë e tyre në lidhje me zbatimin në praktikë të legjislacionit të ri shqiptar dhe të jurisprudencës gjyqësore. Ajo ka dhënë një ndihmesë të veçantë edhe përmes përfaqësimit si avokate në raste gjyqësore strategjike për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si dhe përmes analizës së vendimeve gjyqësore.

Ka drejtuar dhe ka marrë pjesë në projekte studimore kombëtare dhe ndërkombëtare. Është një nga themelueset dhe hartueset e lëndëve “E drejta kushtetuese e krahasuar” dhe “Barazia gjinore dhe ligji”, si dhe e disa disiplinave mësimore që zhvillohen në

programet “Master” dhe “Doktoraturë”, si dhe bashkautore e teksteve mësimore.

Ka botuar artikuj studimorë në revista shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; ka realizuar referate e kumtesa në aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit; ka ligjëruar si pedagoge vizitore në disa universitete, brenda dhe jashtë vendit. Është anëtare e redaksive botuese në disa revista shkencore dhe njohëse e tri gjuhëve të huaja: anglisht, frëngjisht dhe italisht.

Akad. Anastasi është zgjedhur për dy mandate rresht përgjegjëse e Departamentit të së Drejtës Publike në Fakultetin e Drejtësisë në UT, ndërsa në periudha afatshkurtra është emëruar zëvendësdekane dhe dekane e këtij fakulteti. Ajo është pedagoge e jashtme dhe eksperte në trajnimin e vazhdueshëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve pranë Shkollës së Magjistraturës, si dhe të avokatëve pranë Shkollës Kombëtare të Avokatisë.

Është iniciatore dhe drejtuese e disa aktiviteteve shkencore për të rinjtë juristë dhe e krijimit të organizatave pro bono të studentëve të Fakultetit të Drejtësisë, me qëllim ofrimin e ndihmës ligjore falas për shtresat në nevojë.

Ka qenë anëtare në disa komisione dhe ka drejtuar grupe pune në kuadrin e reformave kushtetuese dhe ligjore kombëtare. Ka spikatur në inicimin, hartimin dhe lobimin e paketës së ligjeve për barazinë gjinore në shoqëri, për mbrojtjen nga diskriminimi dhe për mbrojtjen nga dhuna në familje. Ka qenë ndër hartueset e marrëveshjeve të komuniteteve fetare me Këshillin e Ministrave.

Nga viti 2004 e në vijim është zgjedhur në forumet drejtuese të Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe pedagoge pranë Shkollës Kombëtare të Avokatisë. Është anëtare e Shoqatës Ndërkombëtare të Konstitucionalistëve (nga viti 2014), si dhe anëtare e “Komisionit European për Demokraci nëpërmjet Ligjit” (Komisioni i Venecias) në emër të Shqipërisë (2016–2020).

**Akademia e Shkencave dhe Kryesia e saj i urojnë akademikut Shaban Sinani:
Gëzuar ditëlindjen!**



Akademik Shaban Sinani është studiues dhe historian i letërsisë, etnolog, eseist dhe publicist shqiptar.

Ka lindur më 16 prill 1958 në Ndërshen të Lurës. Në vitin 1983 përfundoi studimet për gjuhë-letërsi shqipe në Universitetin e Tiranës, duke u diplomuar nën udhëheqjen e prof. Shaban Demirajt me tezën “Ndajfoljet përemërore në gjuhën shqipe”.

Karrierën e nisi si gazetar i “Zërit të Popullit”, ndërsa më pas ka mbajtur funksione të rëndësishme si: Ndihmës i Kryetarit të Shtetit për çështjet kulturore (1985-1992); punonjës shkencor në Institutin e Kulturës Popullore (1992-1999); Drejtor i Përgjithshëm i Arkivave të Shqipërisë (1999-2005), si dhe studiues në Institutin e Gjuhësisë dhe Letërsisë (2005-2016). Gjatë viteve 2016 - 2024 shërbeu si sekretar shkencor në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë. Aktualisht ai është përgjegjës i sektorit për përgatitjen e veprës madhore “Enciklopedia shqiptare”.

Akad. Shaban Sinani, që nga viti 2019 mban titullin më të lartë shkencor "Akademik". Ai është autor dhe bashkautor i një korpusi të gjerë veprash shkencore në fushën e letërsisë, albanologjisë, etnologjisë dhe antropologjisë kulturore. Ka botuar mbi 30 libra monografikë e përmbledhje me studime, në shqip e në gjuhë të huaj, në fushën e etnologjisë e të folklorit të krahasuar; të historisë e shkrimeve dhe dorëshkrimeve; për raportet ndëretnike dhe ndërkulturore; studime letrare dhe historiografike.

Profesor i ftuar për të dhënë lëndët etnokulturë dhe trashëgimi kulturore; supervisor dhe drejtues shkencor për teza doktrate në disa universitete jashtë vendit. Bashkëdrejtues i projektit të rishtypjes fototipike të "Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia" (vol. I-II, Tiranë-Prishtinë, 2002); kryeredaktor i botimit shkencor të ilustruar "Kodikët e Shqipërisë" (2003); anëtar i redaksisë ndërkombëtare të ribotimit të "Illyricum Sacrum" (vol. I-IX, Zagreb-Prishtinë, 2005); drejtues shkencor i përgatitjes së katalogut "Ottoman Manuscripts in Albanian Archives" (2001) dhe i projektit ndërkombëtar "Të shkruash historinë me tolerancë" (konferencë dhe vepër shkencore e ilustruar, në tri gjuhë, 2005); përkujdesës i botimeve "Këngë popullore të Skraparit" (1998) dhe "Epikë popullore shqiptare në Maqedoni" (2001); përkujdesës dhe redaktor shkencor i botimit në shqip të poemës "Shah-Name" (1999) dhe i përmbledhjes "Tri drama të pabotuara" të D. Agollit (2016); redaktor dhe transkriptues i zërave për Shqipërinë në projektin INCOMKA (2003); ekspert shkencor për antroponimet në "Census Albania 2011"; përgatiti dhe realizoi regjistrimin e dy kodikëve më të vjetër të Shqipërisë, "Beratinus-1" dhe "Beratinus-2", në programin e UNESCO-s "Mémoire du Monde" (2005); hartoi dhe drejtoi programin ndërqeveritar "Modernizimi i arkivave kombëtare" (2000-2005); anëtar i Komisionit Kombëtar të UNESCO-s (2000-), anëtar i Komitetit Kombëtar të AIESEE-së (1999-), themelues i Komitetit Kombëtar të programit "Mémoire du Monde" (2004); merr pjesë në projektin e BE-së "How to Exorcise the Hate" (skënarist i katër filmave dokumentarë, 2011); hartues projektesh dhe përgatitës i veprimtarive shkencore (konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare dhe botime akademike) për shpëtimin e hebrenjve në Shqipëri (1990-2017); bashkëdrejtues i projektit shkencor "Eposi shqiptar në UNESCO" (i nderuar me çmimin "Europa Nostra", 2016).

Ka dhënë kontribut të rëndësishëm në projekte ndërkombëtare të UNESCO-s, përfshirë regjistrimin e kodikëve "Beratinus-1" dhe "Beratinus-2" në programin "Memory of the World", si dhe në projekte për modernizimin e arkivave shqiptare dhe promovimin e trashëgimisë kulturore shqiptare në nivel ndërkombëtar.

Nderime dhe mirënjohje të fituara: urdhri "Naim Frashëri", klasi II (1986); çmimi i dytë kombëtar vjetor i revistës "Hosteni" për novelë (1991); qytetar nderi i Beratit (2008); çmimi dhe kupa "Madonna e Argjenditë" për film dokumentar-shkencor si skënarist në Festivalin V Ndërkombëtar të Filmit në Bjelorusi (2009); çmimi kombëtar Faik Konica për studim monografik (2012); Mirënjohje e shtetit të Izraelit për studim monografik (2014); çmimi kombëtar "Kult" për studim monografik (2015); "Urdhri i Pavarësisë i Republikës së Kosovës" (2016); certifikatë e veteranit-luftëtar të UÇK-së (2016); çmimi vjetor i librit shkencor për studim monografik në konkursin e AIITC (2016); mirënjohjen e Qeverisë së Kosovës si kontribuues për pranimin e Arkivave të Kosovës në Këshillin Ndërkombëtar të Arkivave (2016).

In memoriam

Ngushëllim publik për ndarjen nga jeta të akademikut Rexhep Qosja



-Kryesia e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Kryesia e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, mesazh ngushëllimi për humbjen e akad. Rexhep Qosjes-

Ngushëllim publik

Sot, gjatë një aktiviteti të përbashkët të organizuar në Tiranë nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës mësuam lajmin e hidhur të ndarjes nga jeta të akademikut, studiuesit dhe shkrimtarit Rexhep Qosja, anëtar i ASHAK dhe anëtar nderi i ASHSH-së, një prej figurave më të shquara të mendimit shkencor, letrar dhe kombëtar shqiptar.

Akademik Rexhep Qosja përfaqësonte një personalitet të jashtëzakonshëm të kulturës mbarëshqiptare, studiues i përkushtuar, shkrimtar dhe intelektual me ndikim të gjerë në zhvillimet shkencore, letrare dhe shoqërore. Veprimtaria e tij shumëdimensionale u karakterizua nga një qasje kritike, e argumentuar dhe e mbështetur në parime të larta akademike, duke kontribuar në mënyrë të veçantë në konsolidimin e mendimit albanologjik dhe në afirmimin e identitetit kulturor e historik shqiptar.

Trashëgimia që la pas, përbën një vlerë të çmuar shkencore dhe letrare, e cila do të mbetet burim referimi dhe frymëzimi për studiuesit dhe brezat që vijnë. Përmes angazhimit të tij intelektual dhe publik, ai luajti rol të rëndësishëm në mbrojtjen e çështjes kombëtare dhe në ndërtimin e diskursit kritik në shoqërinë shqiptare.

Të dy akademitë tona shprehin mirënjohje dhe vlerësim të lartë për këtë kontribut të pashlyeshëm në zhvillimin e shkencës, kulturës dhe mendimit bashkëkohor shqiptar, si dhe për rolin e tij në forcimin e institucioneve akademike dhe të bashkëpunimit ndërakademik në hapësirën shqiptare.

Në këto momente zie, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë u shprehin ngushëllimet më të thella familjes Qosja, e njëherazi duke respektuar plotësisht dëshirën e tyre për privatësi dhe qetësi në këtë kohë dhimbjeje për ta dhe për ne.

Kujtimi, vepra dhe kontributi i akademik Rexhep Qosjes do të mbeten të përherëshme në fondin e kulturës dhe shkencës shqiptare dhe në ndërgjegjen kolektive të kombit tonë.

Ndahet nga jeta rapsodi lahutar Jonuz Delaj



Komisioni i Përhershëm i Arteve në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë dhe Instituti i Antropologjisë pranë saj, shprehin ngushëllimet më të thella për ndarjen nga jeta të lahutarit, bartësit të folklorit Jonuz Delaj.


Vijues i traditës së madhe të lahutarëve të Shqipërisë së Veriut dhe të Eposit të Kreshnikëve, veçanërisht i atyre të Malësisë së Madhe, për 60 vjet rresht Jonuzi dhe lahuta ishin simbiozë e pandarë. Ai ishte laureat i festivaleve folklorike kombëtare të Gjirokastrës, atyre vendore, pjesëmarrës në koncertet zyrtare për ngjarje e personalitete të rëndësishme të historisë sonë kombëtare në Shqipëri, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoni e Veriut dhe në diasporë.

Jonuz Delaj ishte pjesë aktive e grupit të lahutarëve që promovuan përgatitjet e dosjes së lahutës dhe të këndimit me lahutë në UNESCO, regjistrimi i së cilës i dha atij një krenari të ligjshme.

Me humbjen e Delaj, përfundoi udhëtimi tokësor, por vijon rruga e artit të këndimit me lahutë, për të cilën punoi gjithë jetën e tij, e për të cilën do të kujtohet me nderim sot e mot.

I paharruar rapsodi ynë Jonuz Delaj!

Kujtojmë në ditën e lindjes Aleksandër Moisiun, aktorin shqiptar me famë botërore



Aleksandër Moisiu lindi më 2 prill 1879, fëmijërinë e kaloi në Trieste, në Durrës dhe në Grac, Austri. Shkollën e mesme e kreu në vitin 1898 në Grac.

Veprimtarinë si aktor e filloi në vitin 1899, me nxitjen dhe mbështetjen e aktorit austriak Jozef Kainc (1858-1910). Në vitin 1903 debutoi me sukses në Teatrin Gjerman të Pragës dhe një vit më pas në teatrin "Volksbühne" (Skena popullore) të Berlinit. Në Berlin gëzoi mbështetjen dhe ndihmën e regjisorit të njohur Maks Rajnhard (1873-1943), i cili e pranoi në teatrin e tij. Këtu u shqua në rolin e Osvaldit nga pjesa "Fantazmat" të dramaturgut norvegjez Henrik Ibsen (1828-1906), si dhe në rolet e personazheve të Bernard Shout (1856-1950) dhe të Shekspirit (1564-1616).

Në vitin 1911, Moisiu shkoi me Ansamblin e Rajnhardit në një turne për interpretimin e rolit të Edipit në Shën Petërsburg, Rusi. I vlerësuar nga kritiku dhe dramaturgu Anatoli Lunaçarski (1875-1933), pas suksesit të korrur, u angazhua në shumë vende të Europës dhe në Amerikën Veriore. Ai luajti role të personazheve kryesore, duke filluar që nga tragjedia antike greke, deri te koha moderne, ku përfshiheshin dramaturgë gjermanë dhe austriakë.

Megjithatë, Aleksandër Moisiu përmendet më së shumti për rolet e dramaturgjisë klasike si Hamleti, Edipi, Jedermani, Fausti apo dhe Fedja në pjesën "Kufoma e gjallë" e

prozatorit, dramaturgut dhe publicistit rus Leon Tolstoj (1828-1910) e më gjerë.

Në historinë e artit skenik botëror, Moisiu u shqua sidomos për interpretimin e tij original, temperamentin e fuqishëm, thellimin filozofik, lirizmin dhe bukurinë poetike të personazheve. Ka lënë mbresa edhe për zërin e tij që kishte një tingëllim të veçantë.

Ikona e teatrit dhe dramaturgjisë botërore, Aleksandër Moisiu, u nda nga jeta më 23 mars 1935.

Përkujtojmë në ditën e lindjes juristin dhe historianin akademik Arben Puto



Akademik Arben Puto lindi më 6 prill 1924. Arsimin e mesëm e nisi në Liceun Kombëtar (francez) në Korçë dhe pas mbylljes së tij, e vijoi në liceun "Châteaubriant" në Romë. Gjatë Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare mori pjesë aktive në përpjekjet për çlirimin e vendit. Pas përfundimit të luftës, ai e përfundoi arsimin e mesëm në gjimnazin e Tiranës në vitin 1946 dhe më pas kreu studimet e larta në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Moskës, ku u diplomua në vitin 1951.

Karrierën profesionale e nisi në sektorin juridik të Ministrisë së Punëve të Jashtme (1951–1957). Më pas, për një periudhë të gjatë (1957–1990), ushtroi detyrën e pedagogut në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, ku ligjëroi të drejtën ndërkombëtare.

Pas vitit 1990, ai u përfshi aktivisht në proceset demokratike në vend, duke kryesuar Komitetin Shqiptar të Helsinkit që nga themelimi i tij dhe, me ndërprerje, deri në vitin 2000.

Për kontributet e tij të shquara, është nderuar me Çmimin e Republikës të shkallës së parë.

Veprimtaria e tij shkencore dhe akademike është e pasur dhe përfshin një numër të madh botimesh. Ndër më të rëndësishmet veçohen: "E drejta ndërkombëtare publike", vëll. I-II (1964, me ribotime); "Karta e Kombeve të Bashkuara; Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare" (1993); "Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut në përjasje me Kushtetutën e Shqipërisë" (2003); "Historia e Shqipërisë" (botuar në frëngjisht më 1974 dhe në anglisht më 1981, si dhe vëllimet III dhe IV në vitet 1983 dhe 1984); "Pavarësia shqiptare dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha 1912–1914" (1978, botim i zgjeruar në vitin 2012); "Demokracia e rrethuar" (1990, ribotuar në vitin 2010); "Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit", vëll. I-III (1984, 1987, 2001); "Nëpër analet

e diplomacisë angleze” (1976, botim i ripunuar në vitin 2001); “Historia diplomatike e çështjes shqiptare 1878-1926” (2003); “Shqipëria Politike 1912-1939” (2009); “Historia diplomatike e çështjes shqiptare 1878-1912” (2010); “Lufta italo-greke, diktatorë e kuislingë” (2011); “Shkurorëzimi i Mbretit Zog në mërgim” (2012); si dhe “Sfidat e të drejtave të njeriut për një shoqëri të lirë (kujtime 1990-2000)” (2015).

Akademik Arben Puto u nda nga jeta më 11 nëntor 2016, duke lënë pas një trashëgimi të çmuar në fushën e së drejtës, historisë dhe mendimit akademik shqiptar.

Përkujtojmë në ditën e tij të lindjes Hoxhë Hasan Tahsinin, një ndër personalitetet më të shquara të Rilindjes Kombëtare



Më 7 prill 1811 lindi matematikani, astronomi, psikologu dhe filozofi shqiptar Hoxhë Hasan Tahsini. Ai ishte rektori i parë i Universitetit të Stambollit dhe një nga themeluesit e Komitetit Qendror për Mbrojtjen e të Drejtave të Kombësisë Shqiptare. Tahsini njihet si një nga mendimtarët më të mëdhenj të Perandorisë Osmane në shekullin XIX.

I njohur edhe si Hasan Tahsin Uzer, ai ishte politikan me origjinë shqiptare. Lindi në fshatin Ninat, afër qytetit të Sarandës, në zonën e Konispolit. Mësimet e para i mori në Prevezë, Shkodër e Berat, ndërsa më pas i vijoi në Stamboll. Përveç gjuhës amtare, ai zotëronte edhe disa gjuhë të huaja, si turqisht, arabisht, persisht dhe frëngjisht, dhe ishte njohës i thellë dhe shtjellues i shkencave natyrore dhe shoqërore.

Kur ishte i ri, u caktua si mësues pranë shkollës osmane në Paris, ku ndoqi edhe studimet për matematikë dhe shkencë natyrore pranë Universitetit të Parisit. Kjo periudhë i hapi Hasan Tahsinit një faqe të re në jetën e tij, duke kaluar nga dijet fetare dhe filozofike tek shkencat moderne.

Përveç matematikës, ai studioi edhe fizikën, kiminë, mekanikën dhe gjeologjinë. Sidomos astronomia dhe kozmografia ishin fushat e tij të preferuara. Pas përfundimit të studimeve, u emërua imam në Ambasadën e Perandorisë Osmane në Paris, ku qëndroi rreth 16 vjet. Me kthimin në Stamboll, themeloi Universitetin Modern të Stambollit, ku dha mësim si pedagog i psikologjisë dhe u zgjodh rektori i parë i këtij universiteti.

Përveç themelimit dhe udhëheqjes së Universitetit të Stambollit, ai themeloi edhe "Xhemijet-i Ilmijje-i Arnavudijjê" (Shoqëria e Dijetarëve Shqiptarë). Së bashku me Sami

Frashërin, hartoi një alfabet të veçantë për gjuhën shqipe. Tahsini kontribuoi në Komitetin Qendror për Mbrojtjen e të Drejtave të Kombësisë Shqiptare.

Ai ishte ndër themeluesit e Lidhjes së Prizrenit (1878–1881). Vëllezërit Frashëri, Abdyl, Mehmeti, Naimi, Samiu si dhe atdhetarë të tjerë, si Jani Vreto, Kostandin Kristoforidhi dhe Koto Hoxhi, ishin jo vetëm nxënësit, por edhe bashkëpunëtorët kryesorë të tij.

Hasan Tahsini ishte një nga gazetarët e parë që u angazhua për të drejtat e grave dhe njohës i shkëlqyer i astronomisë, filozofisë, teologjisë, matematikës, fizikës, historisë, gjeografisë, bujqësisë dhe letërsisë.

Ai ka shkruar shumë vepra, kryesisht në gjuhën turke, në prozë dhe poezi. Ka botuar mbi 20 libra shkencorë, astronomikë, psikologjikë dhe pedagogjikë. Studimet e tij i botoi fillimisht në revistën shkencore të themeluar prej tij, “Mexhmual-i-Ulum”.

Disa nga veprat e tij më të njohura janë: “Historia e krijimit”, “Themeli i Gjithësisë”, “Psikologjia apo Dituria e Shpirtit”, “Të fshehtat e ajrit dhe ujit”, “Rruzullimi i përbotshëm”, “Pasqyra qiellore” etj.

Hasan Tahsini ndërroi jetë më 4 korrik 1881 në Stamboll, në moshën 69-vjeçare.

Kujtojmë në përvjetorin e ndarjes nga jeta matematikanin e shquar akademik Petraq Pilika



Akademiku Petraq Pilika, një nga figurat më të shquara të shkencës shqiptare, u nda nga jeta më 7 prill 2009. Ai ishte matematikan, profesor, akademik dhe mban titullin “Mësues i Popullit”.

Lindi në Korçë, ku përfundoi edhe Liceun Kombëtar Francez. Që në rini u përfshi aktivisht në Lëvizjen dhe Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Studimet e larta për matematikë i kreu në Universitetin “Lomonosov” të Moskës (1946–1951). Pas kthimit në Shqipëri, në vitin 1951 u emërua përgjegjës i katedrës së Matematikës dhe Fizikës në Institutin e Lartë Pedagogjik të Tiranës. Me themelimin e Universitetit të Tiranës, mori drejtimin e katedrës së Matematikës në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, të cilën e udhëhoqi për plot 31 vjet.


Akad. Pilika luajti një rol kyç në zhvillimin e kërkimit shkencor në matematikë në Shqipëri, duke e orientuar atë drejt fushave me perspektivë dhe duke ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e nivelit të mësimdhënies dhe të aplikimeve shkencore. Kontributet e tij më të rëndësishme janë në teorinë e funksioneve, me punime të botuara brenda dhe jashtë vendit.

Në vitet '70 ishte ndër figurat kryesore në hartimin e strategjisë së zhvillimit të matematikës në Shqipëri. Gjithashtu, ishte organizatori kryesor i dy konferencave kombëtare të matematikës (1984 dhe 1989) dhe përfaqësoi vendin në forume të rëndësishme ndërkombëtare, përfshirë kongreset botërore të matematikës në Nis (1970) dhe Helsinki (1978).

Akad. Pilika ishte një personalitet që la gjurmë të thella në arsimin dhe shkencën shqiptare. Kontributi i tij shtrihet gjithashtu në përgatitjen e brezave të rinj të matematicienëve, duke qenë një pedagog i përkushtuar dhe frymëzues, i cili formoi një shkollë të mirëfilltë shqiptare në këtë fushë. Nën drejtimin e tij, shumë studentë dhe studiues u orientuan drejt kërkimit shkencor dhe dhanë kontribute të vyer në zhvillimin e matematikës në vend.

Si anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, ai ishte pjesë aktive e jetës shkencore dhe institucionale, duke kontribuar në forcimin e rolit të shkencës në shoqëri dhe në konsolidimin e institucioneve akademike në vend. Veprimtaria e tij u vlerësua me tituj të lartë dhe mbetet një referencë e rëndësishme për komunitetin shkencor shqiptar. Në vlerësim të figurës dhe kontributit të tij të shquar, Akademia e Shkencave e Shqipërisë ka themeluar çmimin “Petraq Pilika”, që mban emrin e tij. Figura e akademikut Petraq Pilika mbetet një simbol i përkushtimit ndaj dijes, punës së palodhur dhe përgjegjësisë intelektuale, duke zënë një vend të nderuar në historinë e shkencës shqiptare.

**Përkujtojmë në përvjetorin e lindjes një nga figurat e Rilindjes Kombëtare,
Aleksandër Stavre Drenova**



Aleksandër Stavre Drenova lindi më 11 prill 1872 në Drenovë të Korçës. I mbetur jetim, mërgoi në Rumani më 1885. Ai u rikthye në atdhe disa herë gjatë viteve 1889, 1914 dhe 1937, për periudha të shkurtra. Kreu Akademinë Tregtare të Bukureshtit dhe më pas u regjistrua në Fakultetin e Shkencave Politike të universitetit të atjeshëm, të cilin nuk arriti ta përfundonte.

Asdreni u formua në një kohë kur lëvizja kombëtare shqiptare po konsolidohej në planin kulturor dhe politik. Veprimtaria e tij letrare dhe atdhetare u zhvillua kryesisht në mjediset e diasporës shqiptare në Bukuresht, një nga qendrat më të rëndësishme të organizimit dhe të mendimit rilindës.

Asdreni ishte një nga figurat më përfaqësuese të letërsisë shqiptare të periudhës së Rilindjes Kombëtare, i cili me poezinë e tij u dha zë aspiratave për liri, identitet dhe përparim shoqëror.

Krijimtaria poetike e tij përfaqëson një ndër dëshmitë më të rëndësishme të ndërgjegjesimit kombëtar shqiptar. Në përmbledhjen “Ëndrra e lotë”, si dhe në poezi të tjera, shprehen qartë idealet e kohës: dashuria për atdheun, thirrja për bashkim dhe përpjekja për emancipim kulturor e shoqëror. Poezia e tij karakterizohet nga një ndërthurje e ndjeshmërisë romantike me elemente të reflektimit realist.

Një nga kontributet më të rëndësishme të Asdrenit në trashëgiminë kulturore shqiptare është teksti i “Himni i Flamurit”, i cili mbetet simbol i unitetit dhe i vetëdijes kombëtare. Vargjet e tij vijojnë të jenë pjesë e identitetit të përbashkët të shqiptarëve dhe të shoqërojnë momentet më përfaqësuese të jetës publike.

Asdreni ka qenë veprimtar i shquar i kolonisë shqiptare të Rumanisë dhe sekretar i saj për një periudhë (1913–1925).

Në vitet 1922–1934 shërbeu, me disa ndërprerje, si sekretar i Konsullatës Shqiptare në Bukuresht. Ai mori pjesë në mbledhjen e Bukuresht-it të 5 nëntorit 1912, në të cilën u vendos të shpallej pavarësia e Shqipërisë. Poezia “Betimi mbi flamur” dhe vjersha të tjera, të muzikuara prej tij me frymëzim atdhetar, luajtën një rol të rëndësishëm në forcimin e ndërgjegjes kombëtare në prag dhe pas Shpalljes së Pavarësisë, si dhe në periudhën e konsolidimit të shtetit shqiptar.

I shqetësuar vazhdimisht për fatet e atdheut, ai trajtoi në periodikët e kohës “Albania”, “Drita”, “Shqipëria e Re” etj. probleme politike e shoqërore përmes një vargu artikujsh me orientim demokratik dhe frymë konstruktive.

Figura e Asdrenit zë një vend të veçantë në historinë e letërsisë shqipe dhe në kulturën kombëtare në tërësi. Ai përfaqëson tipin e intelektualit të angazhuar, i cili përmes fjalës artistike kontribuoi në formësimin e ndërgjegjes kombëtare dhe në afirmimin e vlerave të saj.

Asdreni vdiq në Bukuresht më 11 dhjetor 1947.

Kujtojmë në përvjetorin e ndarjes nga jeta shkrimtarin e shquar akademik Bedri Dedja



Bedri Dedja ishte shkrimtar, pedagog, studiues, akademik, si dhe një nga personalitetet më të rëndësishme të kulturës shqiptare në gjysmën e dytë të shekullit XX, i njohur veçanërisht për kontributin e tij në letërsinë për fëmijë dhe të rinj. Ai u nda nga jeta më 13 prill 2004.

Lindi në Korçë më 20 nëntor 1930. Shkollën fillore e ndoqi në Shkodër, ndërsa të mesmen e kreu në gjimnazin "16 Shtatori" të qytetit të Durrësit. Në vitin 1949 u dërgua me bursë shteti për studime të larta në Moskë, ku më 1953 mori diplomën e arsimit të lartë në dy degë paralele: psikologji-pedagogji dhe në letërsinë për fëmijë.

Ka qenë pedagog dhe dekan i Fakultetit të Historisë e të Filologjisë në Institutin e Lartë Pedagogjik (1954-1957), drejtor i Institutit të Lartë Pedagogjik 2-vjeçar të Tiranës (1957-1958), kryeredaktor i gazetës "Mësuesi", i revistave "Arsimi popullor" e "Fatosi"; nismëtar dhe drejtor i Institutit të Studimeve dhe Botimeve Shkollore (1965-1970), zëvendësministër i Arsimit dhe i Kulturës (1970-1973), sekretar shkencor i ASHSH (1973-1975) etj.

Është autor i botimeve shkencore pedagogjike e psikologjike: "Rrugët e perfeksionimit të sistemit të sotëm të edukatës familjare" (1966), "Shënime për historinë e mendimit

pedagogjik shqiptar" (1972), "Studime për problemin e metodave të dhënies së mësimit në shkollë" (1987), "Drejt enigmave të psikikës së njeriut" (1989), "Psikologjia sociale" (1990), "Sekreti i talentit" (1998), "Nëpër ravat e jetës" (2001) etj.; bashkautor në tekste të psikologjisë për shkollat e larta dhe për kursin pasuniversitar, në veprën "Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar" I (2004), në manualin shkencor "Didaktika" etj.

Ndër veprat kryesore si shkrimtar i letërsisë për fëmijë janë romanet "Kalamajtë e pallatit tim" (1972), "Met partizani" (1981), "Kacamisri rreth globit" (1993), "Një udhëtim i rrezikshëm" (1962), "Qyteti me tri kështjella" (2003), "Republika e një mijë e njëqind çudirave" (1997); poema "Shkolla e pyllit" (1967), vëllimet "Përralla njëmbëdhjetëkatëshe" (1996), "Kapiteni i shtrëngatës" (1970); si studiues ka botuar librat "Tradita e probleme të letërsisë shqipe për fëmijë" (1971), "Shkrime mbi letërsinë për fëmijë" (1978), "Letërsia për fëmijë" (1961) etj. Për këtë veprimtari ka marrë Urdhrin e Organizatës Ndërkombëtare të Librit për Fëmijë dhe të Rinj (Cyrih, 2000).

Ai ka qenë kryetar i Shoqatës Mbarëshqiptare të Psikologëve dhe anëtar i Asamblesë së Ligës Botërore të Shkencave Psikologjike. Në vëllimin e vitit 1999-2000 të Qendrës Ndërkombëtare të Biografive të Kembrixhit (IBC), në rubrikën "Who's Who", Bedri Dedja është cilësuar si shkrimtar dhe autor botëror, si një nga 2000 shkrimtarët më të shquar të shekullit XX dhe "Njeriu i Vitit 1999-2000".

Ai është vlerësuar me medaljen "Qytetar Nderi" i Beratit, laureat i "Çmimit të Republikës" dhe me urdhrin "Naim Frashëri". Me rastin e 70-vjetorit të lindjes, ai mori urdhrin "Mjeshtër i madh i punës".

Figura e tij mbetet një pikë referimi në kulturën shqiptare, si shembull i intelektualit të përkushtuar ndaj dijes, edukimit dhe formimit të brezave të ardhshëm. Një rrugë në Tiranë mban emrin e akademikut Bedri Dedja.

Përkujtojmë sot në ditën e lindjes poetin arbëresh Jul Variboba



Akademia e Shkencave e Shqipërisë përkujton sot në ditën e lindjes poetin arbëresh Jul Variboba (Giulio Variboba), figurë e rëndësishme në historinë e kulturës shqiptare dhe një ndër autorët më të hershëm të letërsisë shqipe.

Variboba lindi më 16 prill 1725 në katundin Mbuzat të Shën Gjergjit Arbëresh (San Giorgio Albanese) në Kalabri të Italisë, një nga vatrat më të rëndësishme të diasporës, ku u ruajtën me fanatizëm gjuha dhe traditat shqiptare. Mësimet e para i mori në kolegjin e San Benedetos në Ullano, ku u formua në një mjedis kulturor dhe fetar që ndikoi në zhvillimin e tij intelektual. Më pas ai shërbeu për disa kohë si prift në fshatin e tij të lindjes, duke qenë i angazhuar në jetën fetare dhe komunitare të arbëreshëve të Kalabrisë.

Variboba ishte prift i ritit bizantin dhe një intelektual i përkushtuar ndaj kulturës së popullit të tij. Ai jetoi në një kohë kur gjuha shqipe në diasporë përballej me sfida të shumta, por arriti ta shndërrojë atë në një mjet të fuqishëm shprehjeje artistike dhe fetare. Në vijim të jetës së tij, Jul Variboba u vendos në Romë, ku kaloi vitet e fundit të veprimtarisë së tij krijuese. Kryevepra e tij, “Gjella e Shën Mëris Virgjër”, botuar në Romë më 1762, përfaqëson një nga monumentet më të rëndësishme të letërsisë së vjetër shqipe. Me një strukturë poetike të pasur dhe një gjuhë të gjallë arbëreshe, kjo vepër i kushtohet jetës së Shën Mërisë dhe mbetet një dëshmi e çmuar e ndërthurjes së besimit me artin letrar.

Libri hapet me një letër hyrëse, përmes së cilës autori i drejtohet Shën Mërisë dhe shpjegon motivet e botimit të veprës, duke i dhënë një dimension personal dhe devotshmërinë gjithë krijimit. Vetë vepra “Gjella e Shën Mërisë Virgjër” përbëhet nga dy poema kryesore, “Gjella e Shën Mërisë” dhe “Gjella e Shën Bambinit”, ndërsa në pjesën përmbyllëse përfshihen edhe disa vjersha shpirtërore që pasurojnë përmbajtjen e saj fetare dhe letrare. Përmes kësaj krijimtarije, Variboba solli një gjuhë dhe stil të afërt me traditën gojore arbëreshe, duke e bërë veprën e tij të dallueshme dhe me vlerë të veçantë në historinë e letërsisë shqipe. Me këtë vepër, ai i dha letërsisë arbëreshe për herë të parë mbizotërimin e frymës artistike, duke u bërë pararendësi dhe paralajmëruesi i poezisë së madhe të Rilindjes.

Jul Variboba u nda nga jeta në vitin 1788 në Romë, duke lënë pas një trashëgimi të madhe kulturore dhe shpirtërore. Ai ishte një mbrojtës i palodhur i gjuhës shqipe dhe identitetit arbëresh. Vepra e tij mbetet një gur themeli në historinë e letërsisë sonë dhe një dëshmi e gjallë e qëndresës kulturore të shqiptarëve në diasporë.

Përkujtojmë në ditën e lindjes shkencëtarin e shquar, akademik Artan Boriçi



Në përvjetorin e lindjes së tij, akademikun Artan Boriçi e përkujtojmë si një prej figurave më të rëndësishme në fushën e fizikës teorike dhe llogaritëse, i cili, pavarësisht ndarjes së parakohshme nga jeta, dha një kontribut original dhe të paçmuar në kërkimin shkencor bashkëkohor.

Akad. Boriçi, i lindur më 19 prill 1965, gjatë karrierës së tij kontribuoi për më shumë se dy dekada në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, ku shërbeu fillimisht si pedagog, më pas si zëvendësdekan (2012) dhe si anëtar i këshillit shkencor. Që prej vitit 2012, ai drejtoi grupin e fizikës llogaritëse dhe të energjive të larta në Departamentin e Fizikës, duke udhëhequr gjithashtu dy tema doktorale në fizikën e grimcave elementare.

Formimi i tij akademik u konsolidua në një nga institucionet më prestigjioze evropiane, ku në vitin 1996 mbrojti gradën “doktor i shkencave matematike” në ETH Zürich, Zvicër. Më tej, në vitin 2010, ai mori titullin “profesor” në Universitetin e Tiranës.

Studimet e tij kanë shërbyer si referencë në kërkimet shkencore brenda dhe jashtë vendit, duke e pozicionuar atë në një hapësirë të rëndësishme të kërkimit ndërkombëtar. Akad. Boriçi është autor i një formulimi teorik të njohur në literaturën shkencore me emërtimin Boriçi-Krojc. Veprimtaria e tij kërkimore është zhvilluar në bashkëpunim me institucione të rëndësishme ndërkombëtare, përfshirë CERN, Institutin Paul Scherrer, ETH Zürich, Universitetin e Edinburgut, si dhe Qendrën e Llogaritjeve Intensive në Jülich, Gjermani. Ai ka bashkëpunuar gjithashtu me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë dhe me institucione shkencore evropiane të nivelit të lartë, përfshirë Akademinë Mbretërore të Shkencave të Suedisë, në kuadër të proceseve të propozimeve për çmimet Nobel në fizikë. Në fushën e fizikës teorike dhe llogaritëse, akad. Boriçi konsiderohet ndër studiuesit pionierë të metodologjive numerike në Lattice Quantum Chromodynamics (LQCD), duke hapur rrugë të reja në këtë drejtim kërkimor.

Puna e tij shkencore përfshin 64 artikuj të botuar, me 34 të indeksuar në SCOPUS, H-index 9 dhe mbi 531 citime (ResearchGate). Punimet e tij janë publikuar në revista të njohura ndërkombëtare si Physical Review D dhe Journal of Computational Physics, si dhe janë prezantuar në 49 konferenca shkencore, në 11 prej të cilave si referues i ftuar.

Në vitin 2020, ai u pranua anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, duke formalizuar një karrierë të gjatë dhe të suksesshme në zhvillimin e kërkimit shkencor në vend.

Akad. Boriçi u nda nga jeta në moshën 56-vjeçare, më 26 mars 2021.

Kujtojmë me nderim arkeologun dhe studiuesin e shquar Skënder Anamali



Skënder Anamali, themelues dhe studiues i shquar i arkeologjisë dhe i historisë antike të Shqipërisë, është ndarë nga jeta më 21 prill 1996. Ai ka lindur në Shkodër, ku kreu shkollën e mesme, dhe ndoqi studimet e larta në Fakultetin e Letërsisë dhe të Filozofisë në Universitetin e Padovës (Itali).

Më 1947 filloi punën si arkeolog në Institutin e Shkencave në Tiranë dhe, bashkë me H. Cekën, hapën muzeun e parë arkeologjik (1948).

Anamali ndërmori gërmime të pavarura në qytetin e Amantias, në Apoloni dhe në Durrës. Problemet historiko-arkeologjike që lidhen me kulturën e arbërve të hershëm u bënë objekt i kërkimeve dhe studimeve të tij deri në fund të jetës.

Gjatë kësaj periudhe realizoi gërmime sistematike në varrezën mesjetare të Krujës, në Koman, Bukël, Shurdhah, në bazilikën e Linit, në kalanë e Pogradecit, në kalanë e Stelushit, në bazilikën e Ballshit etj. Rezultatet shkencore të këtyre gërmimeve u pasqyruan në mbi 70 artikuj e studime, të botuara edhe jashtë vendit, ku ai përcakton përbërësit e kulturës arbërore dhe procesin e lindjes e të zhvillimit autokton të bartësve të saj.

Skënder Anamali është autor i monografisë për qytetin ilir të Amanties, bashkautor i vëllimit “Ilirët dhe Iliria tek autorët antikë” (1965), si dhe bashkautor i veprave “Historia e Shqipërisë” (1959) dhe “Historia e popullit shqiptar”, vëll. I (2002). Ai është gjithashtu i lidhur me botimin “Corpus des inscriptions latines d’Albanie” (Romë, 2009) dhe autor i vëllimit “Des Illyriens aux Albanais” (Tiranë, 2011).

Skënder Anamali ishte anëtar i “Shoqatës Ndërkombëtare për Epigrafi Greke dhe Latine”, me seli në Paris.

Historia e kërkimeve arkeologjike moderne për mesjetën e hershme shqiptare filloi, u rrit dhe u zhvillua për afro gjysmë shekulli nëpërmjet punës së palodhur të prof. Skënder Anamalit dhe arkeologëve të tjerë. Ishin vitet ’60 kur arkeologjia shqiptare e drejtoi vëmendjen nga kultura e antikitetit të vonë dhe e mesjetës së hershme. Ky orientim i ri i kërkimeve, i rëndësishëm për historinë dhe arkeologjinë e kësaj periudhe, iu besua prof. Skënder Anamalit.

Tezat kryesore të përcaktuara prej tij janë se kultura e varrezave të mesjetës së hershme të zbuluara në Shqipërinë e Veriut është një kulturë vendëse, e cila lulëzoi në shek. VII-VIII; se bartësit e kësaj kulture janë pasardhësit e ilirëve; se romakët nuk arritën të romanizojnë plotësisht popullsinë e kësaj treve dhe nuk ka prova arkeologjike për ndryshime etnike; si dhe se materialet arkeologjike, ashtu si ato gjuhësore, dëshmojnë autoktoninë e popullit shqiptar.

Skënder Anamali ka lënë një trashëgimi të larmishme me artikuj, referate dhe kumtesa për periudhën antike të vonë dhe mesjetën e hershme shqiptare, të botuara në revista shkencore brenda dhe jashtë vendit. Në aspektin historik, këto punime karakterizohen nga shfrytëzimi dhe interpretimi i të dhënave arkeologjike në funksion të ndriçimit të përkatësisë etnike dhe të vazhdimësisë së kulturës nga antikiteti i vonë në mesjetë, si dhe në trajtimin e problemit të gjenezës së arbërve.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë përkujton, në ditën e lindjes, albanologun dhe bibliografin Gjergj Pekmezi



Më 23 prill 1872 lindi në Tushemisht të Pogradecit Gjergj Pekmezi, i njohur si profesor i gjuhës shqipe, bibliograf dhe albanolog shqiptar. Në vendlindje kreu shkollën fillore; më tej vijoi shkollimin në Manastir dhe në Beograd. Në vitet 1894–1898 studioi dhe u diplomua në Universitetin e Vjenës për filozofi dhe gjuhësi (sllavistikë).


I ngarkuar nga Akademia e Shkencave e Austrisë, u dërgua disa herë në Shqipëri për të mbledhur materiale dialektore. Mbrojti doktoratën me një punim mbi tiparet dalluese themelore ndërmjet gegërishtes dhe toskërishtes. Me nismën e tij, më 1903, në Institutin Oriental të Vjenës u hap katedra e gjuhës shqipe. Shërbeu gjithashtu si konsull i Shqipërisë në Austri (1920–1924, 1926–1928).

Për dhjetë vjet (1928–1938) dha mësim gjuhën shqipe në Universitetin e Vjenës dhe u mor me mbledhjen e dokumenteve për historinë e Shqipërisë. Si bashkautor botoi “Bibliografi shqiptare” (1909), ndërsa në vitet 1913–1914 botoi disa libra mësimi dhe leximi për gjuhën shqipe, në bashkëpunim me Maksimilian Lambercin. Në vitin 1924 botoi të transkriptuar në alfabetin e sotëm “Bletën shqiptare” të Thimi Mitkos.

Vepra e tij kryesore është “Albanesische Grammatik” (1908) (“Gramatikë e gjuhës shqipe”), një ndër gramatikat më të plota të shqipes, me nivel të lartë teorik dhe njëkohësisht përshkruese e historike. Gjergj Pekmezi ka lënë në dorëshkrim monografinë “Tiparet dalluese më karakteristike të dialekteve kryesore të shqipes, gegërishtes dhe toskërishtes” (ruhet në arkivin e Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, ASA). Një paraqitje të përmbledhur të përmbajtjes së saj ka dhënë Mahir Domi në “Dialektologjia shqiptare” VI (1990).

Gjithashtu, ai ka mbledhur dhe dorëzuar 8177 faqe të daktilografuara me materiale dhe relacione të konsujve austro-hungarezë në Shkodër, Prizren, Janinë dhe Stamboll, të nxjerra nga arkivi i Ministrisë së Jashtme të Perandorisë Austro-Hungareze.

Përkujtojmë sot në ditën e lindjes filozofin dhe akademikun Zija Xholi



Akademia e Shkencave e Shqipërisë kujton në datën e tij të lindjes profesorin e filozofisë në Universitetin e Tiranës, akademik Zija Xholi.

Ai iindi më 25 prill 1923 në Korçë, ku kreu Liceun Kombëtar Francez. Mori pjesë në Lëvizjen Antifashiste Nacionalçlirimtare si ilegal dhe më pas u përfshi në Brigadën XX S. Në vitin 1952 Zija Xholi kreu studimet e larta për filozofi në Universitetin “Lomonosov” të Moskës dhe nisi punën si profesor i filozofisë në Institutin e Lartë Pedagogjik të Tiranës.

Prej vitit 1957 ai dha mësim në Universitetin e Tiranës në kurset e plota të filozofisë, të historisë së filozofisë botërore dhe të historisë së mendimit politik dhe filozofik shqiptar. Ai dha mësim në disa fakultete, duke përfshirë edhe degën e filozofisë që u hap në vitet '60.

Akad. Zija Xholi ka qenë dekan i Fakultetit të Shkencave Politike e Juridike (1974–1989). Në Universitetin e Prishtinës ka dhënë për disa vite leksione për mendimtarët e Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

Zija Xholi është bashkautor i teksteve universitare të filozofisë.

Në veprimtarinë shkencore i është kushtuar studimit të mendimit filozofik shqiptar. Ka botuar monografinë “Jeta dhe veprat e Sami Frashërit” (1978), si dhe ka shkruar studime për jetën dhe veprën e rilindësve Naum Veqilharxhi, Zef Jubani, Jani Vreto, Pashko Vasa, N. Frashëri, Sami Frashëri, Petro Luarasi, por edhe për autorët e parë të letërsisë shqipe, të përmbledhura në librat e tij “Mendimtarë të Rilindjes Kombëtare” (1987) dhe “Pesë mendimtarët më të vjetër të kulturës sonë kombëtare, si Marin Barleti, Gjon Buzuku, Pjetër Budi, Frang Bardhi, Pjetër Bogdani (2003) etj.

Akad.

Akad. Zija Xholi ka marrë Çmimin e Republikës të Shkallës së Parë.

Kujtojmë në datën e ndarjes nga jeta poetin dhe përkthyesin e njohur Robert Shvarc



Më 25 prill 2003 u nda nga jeta Robert Shvarc, përkthyes i njohur, poet dhe studiues. Shvarci lindi në Sarajevë më 10 dhjetor 1932, nga një baba hebre nga Austria dhe një nënë nga Elbasani. Ai e dashuronte dhe e lëvronte në mënyrë të përsosur gjuhën shqipe, të cilën nisi ta mësonte në moshën gjashtëvjeçare.

Shvarci përktheu disa nga veprat më të mëdha botërore në shqip, ndër të cilat mund të përmenden romanet e Remarkut, Gëtes, Fojtvangerit, Apicit, Travenit dhe Markezit. Atij i është dhënë nga Presidenti i Republikës titulli “Mjeshtër i Madh”. Ky titull iu akordua pak kohë pas marrjes së një tjetër vlerësimi, atij të “Qytetar Nderi” i Tiranës, dhënë me rastin e 70-vjetorit të lindjes.

Emri i Robert Shvarcit prej vitesh është shndërruar në simbol të gjuhës gjermane në Shqipëri. Një moment i rëndësishëm ishte viti 1995, kur ai u nderua nga ambasada gjermane në Tiranë me çmimin “Kryqi i Meritës Gjermane”. Duhet theksuar se Shvarci ishte ndër të parët përfaqësues të kulturës shqiptare që u vlerësua me këtë titull në fushën e përkthimit.

Pas këtyre vlerësimeve qëndron një veprimtari e pasur me një numër të madh librash të përkthyer nga gjuha gjermane në shqip dhe anasjelltas. Mjafton të hapësh kopertinat e shumë librave për të lexuar emrin e përkthyesit të tyre, Robert Shvarc.

Mes këtyre veprave, ndër më të spikaturat, mund të përmenden: “Tre shokë”, “Harku i Triumfit”, “Asgjë e re nga fronti i Perëndimit”, “Shkëndija e jetës” dhe “Obelisku i zi” nga Erih Maria Remark; “Çifutja e Toledos” dhe “Françesko Goja” nga Lion Fojtvanger; si dhe drama të Bertolt Brehtit: “Nëna Kurajë dhe fëmijët e saj”, “Kënga e një nëne gjermane”, “Ditët e Komunës”, “Arturo Ui”, “Pushkët e nënës Karrar”, “Opera për tre grosh” dhe “Baali”. Nga Heinrich Heine: “Gjermania, përrallë dimri”; nga Gëte dhe Shileri: poezi dhe balada.

Ndërsa mes autorëve shqiptarë që ai ka përkthyer në gjuhën gjermane janë: Ismail Kadare, Dritëro Agolli, Gaço Bushaka, Xhevahir Spahiu, Hatibi, Ahmeti, Beqiri, Qosja etj.

Kujtojmë sot, në ditën e lindjes, akademikun, filologun dhe historianin e letërsisë, Jorgo Bulo (1939–2015)




Akademia e Shkencave e Shqipërisë përkujton në këtë ditë një nga figurat më të shquara të studimeve letrare shqiptare, akademikun Jorgo Bulo, i cili do të mbetet gjatë në kujtesën e botës shkencore për kontributin e tij të vyer në fushën e albanologjisë.

Jorgo Bulo lindi në Sheper të Gjirokastrës. Kreu studimet e larta për gjuhë dhe letërsi shqipe në Universitetin e Tiranës. Ai mbajti titullin “Doktor i Shkencave Filologjike” dhe u ngjit në të gjitha shkallët e karrierës akademike, deri në anëtar i Akademisë së Shkencave (2003).

Gjatë veprimtarisë së tij pranë Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, mbajti disa detyra drejtuese, përfshirë drejtimin e institutit dhe redaktimin e revistës “Studime filologjike”. Fusha kryesore e kërkimit të tij ishte letërsia e Rilindjes Kombëtare, me studime të rëndësishme për figura si Naim Frashëri dhe Andon Zako Çajupi, si dhe për tipologjinë e zhanreve letrare, veçanërisht romanin dhe poezinë.

Ai ishte bashkautor dhe redaktor i veprave madhore si “Historia e letërsisë shqiptare” dhe “Historia e Popullit Shqiptar”, si dhe autor i një sërë monografish dhe studimesh të rëndësishme [shkencore.Me](#) mbi 100 artikuj dhe pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare, profesor Bulo la një trashëgimi të pasur shkencore, të karakterizuar nga rigoroziteti, qartësia dhe interpretimi i thellë estetiko-historik. Kontributi i tij është vlerësuar me çmime kombëtare, ndër të cilat “Penda e argjendtë” dhe “Faik Konica”.

Kujtojmë në datën e ndarjes nga jeta shkrimtarin dhe përkthyesin e shquar Skënder Luarasi



Më 27 prill 1982 u nda nga jeta Skënder Luarasi, shkrimtar, përkthyes dhe studiues i shquar i letrave shqipe. Skënder Luarasi lindi më 19 janar 1900 në Luaras të Kolonjës. Arsimin fillor e nisi në shkollën shqipe të Negovanit (1909-1911) nën kujdesin e të atit, Petro Nini Luarasit. Më pas studioi në Robert Kolegj, në Stamboll, Turqi (1912-1913). Shkoi në SHBA dhe kreu "Internacional Kolegj-Springfield Mass" (1916-1920). Dy vjet më vonë kreu gjimnazin klasik Fraishtadt në Austri (1922-1926) dhe u diplomua në Fakultetin e Filologjisë në Vjenë, Austri më 1930-n.

Duke ndjekur shembullin e të atit, ai ia kushtoi gjithë jetën e tij shërbimit ndaj çështjes kombëtare dhe kulturës shqiptare. Luarasi e ka nisur aktivitetin letrar që në moshën 17-vjeçare. Brezi përparimtar i viteve 1930 e dallon si arsimtar, publicist, gazetar, përkthyes,

dramaturg dhe si drejtues e bashkëpunëtor i disa organeve të shtypit përparimtar. Ishte pjesë e vullnetarëve shqiptarë në luftën antifashiste të Spanjës. Ai ka qenë editor-përgjegjës në revistat: Studenti ShBA, 1920, Djalëria, Austri, 1927-1928 dhe kryeredaktor i revistës Vullnetari i Lirisë Spanjë, 1937, organ i vullnetarëve shqiptarë në luftën antifashiste të Spanjës.

Pas çlirimit të vendit është, Skënder Luarasi ishte një nga nismëtarët e themelimit të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe qëndroi anëtar i kryesisë së saj deri në nëntor të vitit 1949, kur u përjashtua për disa vjet nga Lidhja për qëndrimin e tij antikonformist ndaj metodave e qëndrimeve jodemokratike që ndiqte Kryesisë e Lidhjes. Në vitet 1946-1950 ushtroi edhe detyrën e deputetit.

Deri në vitin 1992 veprimtaria e tij (monografi, publicistikë, drama, studime dhe kritikë letrare e historike) botohej pjesërisht (kryesisht përkthimet) dhe nuk analizohej nga pikëpamja shkencore. Përktheu mbi tridhjetë kryevepra të letërsisë botërore si "Fausti" nga Goethe, "Gëci i Berlihingenit" nga Goethe, "Fije bari" nga Whitman, "Mbreti Lir" nga Shakespeare.

Për veprimtarinë e tij të shquar patriotike- antifashiste-demokratike, edukative e letrare është nderuar me urdhrat e lartë: Urdhëri i Flamurit (1960) dhe Nderi i Kombit (1996).